REVISTË PËR AKTUALITET, KULTURË, ARSIM, ETIKË

PAQJA



Viti IV . Nr. 29 . 19 prill - 19 maj 2009. Organ i shoqatës kulturore "Zëri Ynë" Çmimi 0.50€

Nën ombrellën e sigurt

Rruga e Shqipërisë për në Nato

Treni famëkeq që na përkujtonte holokaustin

Fetarësia e Barack Obamës model edhe për liderët shqiptar


Intervistë me analistin Milazim Krasniqi



EDHE PA OKB-NË KOSOVA FUNKSIONALE


MREKULLITË E KUR'ANIT

SUKSESI I GARANTUAR
SUKSESI NJERËZOR
Toleranca



FILOZOFIA JONË
Islami


JETA DHE VDEKJA
E MIRA DHE E KEQJA

SHPRESA RILIND

Flamur Maloku
Shtresimet e tekstit

Blerim HALILI
Çasti bën Çudira

SYHEJL HAVOLLI
LITAR LOTËSH

Fitorja është imja

Nexhat Ibrahimi
Aspekte të marrëdhënieve Islamo-kristiane në Mesjetë

Milazim KRASNIQI
E vërteta e Islamit ndër shqiptarë

Milazim KRASNIQI
NË ÇFARË KOSOVE DO TË JETOJMË

TË TJERËT për ISLAMIN
Ajni Sinani

ISLAMI I KEQKUPTUAR DHE FATKEQËSIA BOTËRORE
Dr. Milazim Krasniqi

Kronologji e Historisë Islame

Zëri Ynë
SHOQATA KULTURORE

PËRMBAJTJA











Lajme 2
Muhamed J. Kajolli: Nën ombrellën e sigurt 3
Intervistë me Milazim Krasniqin 4-5
Florije Ademi: Serbët refuzojnë shtetin e Kosovës, por jo buxhetin e tij 6-7
Fatos Shala: Azilkërkues vetëm nga Shqipëria dhe Bosnja 7
Sabri Halili: Rrezet radioaktive kërcënojnë Kosovën.. 8-9
Avni Avdiu: Bojkoti, izolimi apo integrimi?!.... 9-10
Arben Muhameti: Rruga e Shqipërisë për në NATO 11-12
Nazmi Maliqi: Nga po udhëton Maqedonia? 13-14
Mevlude Zejnullahu: Demonstratat e vitit 1981 i paraprinë kryengritjes së UÇK-së 15
Ekrem Avdullahu: Treni famëkeq që na përkujtonte holokaustin 16-18
Ajni Sinani: A po ndryshon qëndrimi i Amerikës ndaj botës islame? 18-19
Demir Reshiti: Reflektime ndërkombëtare për Kosovën 20-21
Muhamed J. Kajolli: Omeri–prijësi i besimtarëve. 22-23
Emine A. Vezaj: Fetarësia e Barack Obamës – model edhe për liderët shqiptar 24-25
Driton Morina: Lajmi – ndikimi, interpretimi dhe keqinterpretimi i tij 26
Dardan Hoti: Presim apo bëjmë? 26-27
Halil Asllani: Kopjimi – mani e shumë studentëve të UP-së 27
Mimoza Sinani: Kur'ani si letërsi sublime 28-29
Flamur Maloku: Esencat diskurseve 30-31
Esat Vatovci: Lajme nga kultura 31
Fitim Veliu: Rrjeti i kuptimit 32
Poezi 33
Artan N. Bejta: Hipertensioni – vrasës i heshtur...34-35
Osman D. Gashi: 20 këshilla për të mbajtur dietë..36-37
Ylber Qorri: KF "Paqja Studentore", pjesë e Futsall ligës rajonale të Prishtinës 37
Alban Bilalli: Përfaqësuesja ideale e Kosovës në futboll 38-39
Fjalëkryqi 40



REVISTË MUJORE PËR AKTUALITET, KULTURË, ARSIM, ETIKË
Viti IV / Nr. 29
19 prill - 19 maj 2009
Botues
Zëri Ynë
O.J.Q. "Zëri Ynë"

Drejtor
Muhamed Jusufi - KAJOLLI
kajolli5@hotmail.com

Redaktor përgjegjës
Demir RESHITI
demireshiti@hotmail.com

Redaktor i kulturës
Flamur MALOKU
flamurmaloku@hotmail.com

Redaktor teknik/Grafika
Osman D. GASHI
osmangashi@msn.com

Redaktore gjuhësore
Mimoza SINANI

e-mail:
revistapaqja@gmail.com
revistapaqja@hotmail.com
http://www.zeri-yne.org

Adresa:
Rr. Xhavit Mitrovica, nr. 14, përballë teatrit Dodona, Prishtinë, Kosovë

Njoftojmë bashkëpunëtorët se do të merren në konsiderim për botim vetëm ato shkrime që arrijnë në redaksi deri me datën 8 të muajit!

Uashington - Bruksel

24 shkurt 2009



Shqipëria zyrtarisht në NATO

Shqipëria dhe Kroacia zyrtarisht më 1prill u anëtarësuan në NATO, duke e çuar në 28 numrin e vendeve anëtare të Aleancës. Lajmi u konfirmua pasi ambasadorët e të dyja vendeve në SHBA i dorëzuan "instrumentet e anëtarësimit" gjatë një ceremonie në Departamentin Amerikan të Shtetit. Ky veprim ishte përmbyllje e një procesi të gjatë njëvjeçar, gjatë të cilit 26 vendet anëtare të NATO-s ratifikuan hyrjen e Shqipërisë dhe Kroacisë në Aleancë.

Më 3 prill, flamuri shqiptar është valëvitur për herë të parë me 27 flamujt e vendeve anëtare të NATO-s. Në ceremoninë e zhvilluar në selinë e Aleancës së Atlantikut Verior në Bruksel kanë marrë pjesë kryeministri Sali Berisha dhe ministri i Jashtëm Lulzim Basha.

Në orën 09.43 minuta, nën tingujt e himnit shqiptar, në prani të gjithë ambasadorëve të NATO-s dhe sekretarit të përgjithshëm Jap de Hop Scheffer, dy oficerë ushtarakë kanë ngritur flamurin shqiptar, simbol se shteti shqiptar iu bashkua 27 vendeve të NATO-s, 60 vjet pas formimit të saj.

Romë

24 shkurt 2009

Tërmet i fuqishëm në Itali, 289 të vdekur



289 persona kanë humbur jetën nga një tërmet i fuqishëm që e ka goditur pjesën qendrore të Italisë. Tërmeti, prej 5,8 ballësh i shkallës Rihter ka shkaktuar dëme të mëdha në rajonin e Abruzzos. Si pasojë e tërmetit janë rrezuar qindra ndërtesa, përfshirë edhe një konvikt studentesh në qendër të qytetit historik L'Aquila.

Në mesin e të vdekurve kanë qenë edhe pesë shqiptarë, katër prej tyre shtetas të Maqedonisë: Refik Asani (44), Valbona Osmani (13), Alejna Ajrubi (11) dhe Nurie Abdia (41), si dhe një nga Shqipëria, Elsajed Boshti (4 vjeçar).

Kryeministri Berluskoni ka shpallur gjendjen e jashtëzakonshme, duke e cilësuar këtë si tragjedinë më të rëndë të mijëvjeçarit.

Nju Jork

13 mars 2009



Deri më 2012, bota do të ketë 7 miliardë njerëz

Popullata botërore, në vitin 2012, do të arrijë deri në shtatë miliardë njerëz, ndërsa në vitin 2050 popullata botërore do të arrijë në nëntë miliardë. Numri i banorëve do të shtohet më së shumti në vendet në zhvillim, në Azi dhe në Afrikë - ka bërë të ditur Organizata e Kombeve të Bashkuara.

Drejtoresha e seksionit të OKB-së për popullatë, Hanija Zllotnik, ka deklaruar se nuk ka dallime të mëdha midis këtyre parashikimeve dhe vlerësimeve të organizatës botërore të vitit 2006.



Nën ombrellën e sigurt



Muhamed J. KAJOLLI

Shqiptarët si një popull i vogël nuk mund të kenë pretendime të mëdha, por kur ata janë në një bashki më të madhe, ata mund të tregohen se janë shumë të zellshëm, parimorë dhe efektivë. Shqiptarët në përgjithësi janë konstruktivë dhe preokupohen për të ndihmuar parimet e drejta. Misioni i ushtrisë shqiptare në Bosnje dhe Hercegovinë, Irak dhe Afganistan dëshmon për cilësitë e lartpërmendura. E gjithë ajo çka duan shqiptarët është arritja e qetësisë në rajone.

Këto cilësi jo se janë dëshmuar tani, por këto janë të ngulitura që prej shumë shekujsh në historinë tonë. Sa herë është kërkuar që ne të japim kontributin në botë, nuk kemi kundërshtuar. Ashtu sikurse sot shkenca ka arritur të analizojë psikologjinë e një njeriu, kështu duhet të analizohet edhe psikologjia gjenetike e një populli në tërësi.

Shqiptarët ishin ata që luftuan së bashku me grekët. Homeri tregon për heroizmin e Akilit i cili ishte me prejardhje nga malësia e Gostivarit. Sigurisht që ky hero nuk ka qenë i vetëm në beteja të shumta. Gjithashtu Aleksandri i Madh i cili luftoi përkrah maqedonasve nën flamurin helen. Motoja tij për botën ishte: i ashpër ndaj pushtetarëve tiran, i butë dhe solidar me popujt e shtypur. Më pas, ndër ne, ishte edhe Skënderbeu ai i cili u orvat të bënte një aleancë të krishtere kundër turqve muslimanë, por më pas shqiptarët e kuptuan se religjioni i ri duhej llogaritur. Për të vazhduar edhe më tutje në histori, garnizone të shumta shqiptare ishin shpërndarë nëpër botë për të luftuar përkrah muslimanëve. Shqiptarët u quajtën arnaut (‘na vjen turp të kthehemi pa korrur sukses’), për shkak të heroizmit të tyre që kishin treguar në betejë kundër rusëve në shekullin e XVIII-të. Në shekullin e XIX-të shqiptarët krenohen me politikën e Mehmet Ali pashës, 1805-1848, i cili vendosi rendin në Egjipt dhe reformoi mbarë Lindjen e Mesme dhe Sudanin.

Shqiptarët në shekullin e XX-të, nuk luftuan përkrah ushtrisë serbe, kundër sllovenëve, kroatëve dhe boshnjakëve, gjatë periudhës së shpërbërjes së ish Jugosllavisë, përkundrazi ata i ndihmuan këta të fundit kundër ushtrisë pushtuese serbe. Të gjitha këto tregojnë se shqiptarët janë popull të cilët e duan paqen dhe harmoninë njerëzore. Nuk janë popull grindavec dhe shkatërrimtar.

Një popull si ky, nuk ka se si të mos bëhej pjesë e një aleance politiko-ushtarake e deklaruar për qëllimet e saj humane, e cila do të kontribuojë për paqen dhe do të ruajë stabilitetin në botë. Kjo aleancë doli si rezultat i ndryshimit të politikës botërore. Bota, para lindjes së kësaj aleance, udhëhiqej nga disa qendra politike, ndërsa me përfundimin e Luftës së Dytë Botërore dhe me paraqitjen e SHBA-së në arenën politike globale, qendrat më të vogla se ajo u radhitën nën ombrellën e saj. Bota për një gjysmë shekulli u drejtua nga dy qendra politiko-ushtarake. Pas rënie së murit të Berlinit, Pakti i Varshavës u shpërbë, ndërsa Aleanca Veri Atlantike mbeti ashtu siç ishte. E ndodhur përpara këtij realiteti, kjo nuk e pa të arsyeshme të shpërbëhet, edhe pse nuk rrezikohej më nga rivali tij i mëhershëm. Kjo aleancë vendosi të qëndrojë edhe më tutje si një trup, por tani jo si aleancë për të mbrojtur ose sulmuar, por si një aleancë e cila do të ndikojë në ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në tërë planetin Tokë.

Me këtë politikë, ajo arriti që disa prej ish shteteve të bllokut të saj rival para 1989-ës, t’i anëtarësojë me vetë dëshirë. Kjo aleancë nuk duket të jetë e bazuar në parimet fetare e as kombëtare. E gjithë çka ajo paraqet është siguria dhe stabiliteti i popujve. Por, në këtë aleancë janë popujt që në përbërjen e tyre religjioze i përkasin feve të mëdha monoteiste, feve të dala nga i Dërguari All-llahut të Lartëmadhëruar Ibrahimi a.s. Krijuesi botës dhe njerëzimit i këshillon besimtarët monoteistë të bisedojnë mes vete me butësi dhe qetësi maksimale.

Hapi finalizues që mori kryeministri shqiptar dr. Sali Berisha është për t’u përshëndetur. Ai e kuptoi saktë ndjenjën dhe psikologjinë e popullit të vet, kështu që kërkoi dhe punoi për anëtarësimin e popullit të tij në NATO. Ëndrra e dikurshme tani u bë realitet.


Urojmë që edhe popujt e tjerë muslimanë të ndjekin rrugën e Turqisë dhe Shqipërisë dhe të anëtarësohen në këtë aleancë monoteiste. Që kështu të bëhen besimtarë të cilët do të thërrasin të tjerët për vepra të mira dhe të ndalojnë të keqen kudo që do të shfaqet në botë. ■

Intervistë me analistin Milazim Krasniqi

Edhe pa OKB-në, Kosova fu

- Është treguar një qëndrueshmëri institucionale;
- Vizita e liderëve të vendit në SHBA do të ketë reflektime pozitive për qëndrueshmërinë institucionale për stabilitetin e Kosovës;
- Është e pakuptueshme mosnjohja e pavarësisë së Kosovës nga Arabia Saudite dhe shtetet e tjera arabe;
- Opozita e dobët dhe shumë e përçarë;
- Qeveria e Kosovës duhet ta ketë prioritet luftimin e varfërisë.

Intervistoi: Bujar ISMA



"Rruga drejt OKB-së është shumë e gjatë, Kosova mund të funksionojë si shtet stabil, demokratik edhe pa qenë në OKB" - ka thënë në intervistën ekskluzive për revistën PAQJA, analisti politik Milazim Krasniqi. Në këtë intervistë, z. Krasniqi flet edhe për të arriturat e qeverisë, (mos) njohjen e pavarësisë së Kosovës nga ana e vendeve arabe, rolin e opozitës, gjendjen sociale në Kosovë, etj.

Është treguar një qëndrueshmëri institucionale

PAQJA: ***Si i komentoni të arriturat e deritanishme të qeverisë së Kosovës?***

Krasniqi: Qeveria e Kosovës, për një vit pune, ka paraqitur një raport i cili dëshmon për një vëllim të madh të punëve me të cilat ajo ka mbyllur vitin e vet të punës. Bindja ime është që në sektorë të ndryshëm ka pasur shkallë të ndryshme të realizimit të punëve. Janë disa sfera, disa ministri në të cilat ka pasur shumë punë dhe suksese, siç është ministria e transporteve, ministria e brendshme, por ka pasur edhe ministri të cilat problemet e grumbulluara edhe nga periudha e kaluar nuk kanë arritur që t'iu japin rrugëzgjidhje, veçmas kam parasysh këtu ministrinë e shëndetësisë, ministrinë e kthimit, ministrinë e çështjeve sociale dhe ministrinë e kulturës, të cilat nuk kanë pasur sukses në realizimin e politikave të miratuara. Sidoqoftë ka qenë një vit i suksesshëm për Kosovën në rend të parë, normalisht edhe për qeverinë, sepse brenda këtij viti është treguar një qëndrueshmëri institucionale. Ka pasur njohje nga mbi 50 shtete për pavarësinë e Kosovës. Thjesht, ky vit ka qenë i suksesshëm për Kosovën dhe për qeverinë e saj.

PAQJA: ***Sa i ka realizuar qeveria premtimet e dhëna më parë?***

Krasniqi: Po të shikohet programi me të cilin është startuar, vërehet se ai është një program shumë ambicioz dhe brenda një viti një program i tillë nuk mund të realizohet, por disa pjesë të këtij programi janë realizuar. Ndërkaq po të shikohet programi elektoral i PDK-së dhe LDK-së normalisht që ai nuk ka mundur të realizohet, sepse zakonisht planet dhe programet elektorale janë shumë ambicioze dhe shumë herë jo realiste, por disa pjesë të atij programi, që është prezantuar si program i koalicionit qeverisës, janë realizuar. Pa asnjë dyshim kanë mbetur edhe shumë gjëra pa u realizuar, sepse është fjala vetëm për një vit qeverisje.

Vizita e liderëve të vendit në SHBA do të ketë reflektime pozitive për qëndrueshmërinë institucionale dhe për stabilitetin e Kosovës

PAQJA: ***Si e vlerësoni vizitën e presidentit Sejdiu dhe kryeministrit Thaçi në SHBA?***

Krasniqi: Pa dyshim që ka qenë një vizitë shumë e suksesshme për vetë faktin që janë takuar me nënpresidentin Bajden dhe me sekretaren Klinton. Po ashtu është parë edhe përkrahja që zyrtarët e administratës amerikane e kanë shprehur qartë për Kosovën. Gjithashtu ky takim është shenjë e mirë e vazhdimit të kontinuitetit të miqësisë dhe partneriteti ndërmjet SHBA-së dhe Kosovës. Kështu që kjo vizitë me siguri do të ketë reflektime pozitive për qëndrueshmërinë institucionale, për stabilitetin e Kosovës dhe për proceset demokratike në vendin tonë.

nksionale

PAQJA: ***A mendoni që kjo vizitë do të ndikojë në njohje të reja?***

Krasniqi: Besoj që po, sepse së paku edhe nga fjalët e presidentit Sejdiu është lënë të nënkuptohet që do të ketë njohje të reja dhe këtë ai e ka bërë edhe në kontekstin e vizitës në SHBA.

Është e pakuptueshme mosnjohja e pavarësisë së Kosovës nga Arabia Saudite dhe shtetet e tjera arabe

PAQJA: ***Si e vlerësoni mosnjohjen e Kosovës nga shtetet arabe?***

Krasniqi: Është një problem i koklavitur. Sidomos është e patjetërsueshme dhe e pakuptueshme mosnjohja nga ana e shteteve arabe. Këtu do të veçoja paqartësinë e qëndrimit të Egjiptit, i cili është i lidhur me botën arabe e që me shqiptarët ka një lidhshmëri të përbashkët, sepse siç dihet themeluesit e Egjiptit modern kanë qenë shqiptarët. Nga pikëpamja historike ata kanë pasur një borxh që ta njohin pavarësinë e Kosovës. Po ashtu është e pakuptueshme mosnjohja nga Arabia Saudite, që po ashtu është një shtet që ka pasur një prezencë humanitare në Kosovë për shumë vite dhe e njeh mirë problemin e Kosovës. Janë shumë faktorë që ndikojnë. Ndër ta është edhe fakti se vetë bota arabe është një botë myslimane që është mjaft e përçarë mes vete. Sikundër dihet Liga Arabe, konferencat islamike dhe organizata të ndryshme nuk mbërrijnë t'i harmonizojnë politikat e tyre as për çështjet siç është Palestina apo Iraku, e lëre më Kosova. Në anën tjetër, një pjesë e këtyre shteteve arabe dhe myslimane janë aleatë të Rusisë, kanë aleanca të ndryshme ekonomike e ushtarake me Rusinë dhe janë nën presionin rus që të mos e pranojnë Kosovën si shtet i pavarur. Ka disa prej këtyre shteteve që kanë qeveri autoritare, diktatoriale si puna e Libisë, Sudanit dhe ndonjë shtet që thjesht nuk ka ndjenjë për vlerat demokratike dhe për të drejtën e popullit. Me një fjalë, është një situatë konfuze e qeverisë arabe ndaj Kosovës. Megjithatë, disa prej shteteve të rëndësishme siç janë: Turqia, Emiratet e Bashkuara dhe Malajzia e kanë pranuar Kosovën, kështu që mendoj që në të ardhmen pritet që ndoshta do ta njohin edhe shtete të tjera.

PAQJA: ***Cila është rruga më e shkurtër drejt anëtarësimit në OKB?***

Krasniqi: Unë besoj që rruga drejt OKB-së është shumë e gjatë dhe nuk besoj që Kosova do të pranohet në OKB brenda një kohe të shkurtër, sepse problemet në rrugën e anëtarësimit në OKB janë të mëdha. Mendoj që Kosova mund të funksionojë si shtet stabil, demokratik edhe pa qenë në OKB. Prioritet për Kosovën është që të jetë anëtare e BE-së, të anëtarësohet në organizatat monetare ndërkombëtare, në të ardhmen të jetë eventualisht nën ombrellën e NATO-s, ndërsa anëtarësimi në OKB besoj që do të bëhet për një kohë më të gjatë.

PAQJA: ***Si e komentoni qëndrimin e serbëve ndaj EULEX-it?***

Krasniqi: Serbët kanë qëndrim bllokues ndaj EULEX-it, kanë qëndrim minues ndaj pavarësisë së Kosovës dhe besoj që kjo do të vazhdojë edhe për një kohë, derisa Serbia të mos e ndryshojë politikën e vet ndaj Kosovës, sepse serbët e Kosovës janë nën influencën e Beogradit, derisa Beogradi nuk e ndryshon qëndrimin. Beogradi nuk do ta ndryshojë qëndrimin ndaj Kosovës derisa Bashkimi Evropian nuk do ta ndryshojë qëndrimin ndaj Beogradit, pra derisa nuk do t'i bëjë më shumë presion që të heqë dorë nga këto politika destabilizuese.

Opozita e dobët dhe shumë e përçarë...

PAQJA: ***Çfarë roli ka opozita në Kosovë?***

Krasniqi: Opozita në Kosovë luan rolin si çdo opozitë në botë, pra kritikon qeverinë, por kjo kritikë nuk shoqërohet me propozime alternative, me amendamente, me ligje, që i paraqet opozita e përgjegjshme dhe konstruktive. Megjithatë, në Kosovë, opozita është e dobët dhe është shumë e përçarë, kështu që roli i saj nuk është shumë i madh në kuvendin e Kosovës.

PAQJA: ***Opozita ka propozuar zgjedhjet...***

Krasniqi: Po, opozita ka propozuar zgjedhjet, por ato i përcakton presidenti i vendit sipas kushtetutës, kështu që vendimi i presidentit për mbajtjen e zgjedhjeve për vitin 2011 është vendim kushtetues dhe është i konfirmuar edhe nga përfaqësuesi civil ndërkombëtar. Është konfirmuar që tash për tash nuk do të ketë zgjedhje, por edhe nëse do të mbaheshin mendoj që partitë opozitare AAK-ja, LDD-ja, që i kërkojnë këto zgjedhje, nuk do të mund të fitonin më shumë se sa kanë fituar në zgjedhjet e kaluara.

Qeveria e Kosovës duhet ta ketë prioritet luftimin e varfërisë

PAQJA: ***Si e vlerësoni gjendjen sociale në Kosovë?***

Krasniqi: Gjendja sociale në Kosovë është jashtëzakonisht e rëndë për një pjesë të popullsisë. Papunësia dhe varfëria janë në nivele të larta, kështu që mendoj që qeveria e Kosovës duhet ta vendosë si prioritet luftimin e varfërisë, sepse një pjesë e popullsisë është e rrezikuar nga varfëria. Këtu, pa dyshim, hyjnë edhe pensionistët dhe të papunët, sepse jetojmë në një botë ku rritja e çmimeve është evidente, ndërsa numri i të ardhurave është i paktë, kështu që varfëria është problem serioz në Kosovë. ■



Aktuale nga Mitrovica

Serbët refuzojnë shtetin e Kosovës, por jo buxhetin e tij

Derisa institucionet qendrore kërkojnë çdo ditë largimin e UNMIK-ut, duke konsideruar se ka përfunduar misioni i tij, Komuna e Mitrovicës, në planin e saj të hartuar në afatin trevjeçar 2009-2011, parasheh buxhet edhe për administratën e UNMIK-ut në veri



Florije ADEMI

Nga 10.198.678 euro sa është grandi qeveritar për vitin 2009, për komunën e Mitrovicës, 2.724.868 i shkojnë administratës së UNMIK-ut në veri.

Këto mjete dërgohen për pagat e mbi 600 punëtorëve serbë që punojnë në kuadër të kësaj administrate, të cilët për punën e tyre nuk i japin llogari askujt.

Ndonëse shërbimet duhet të kryhen për të gjithë qytetarët e asaj pjese të qytetit, shqiptarët thonë se asnjëherë nuk ia kanë pa hairin kësaj administrate, ashtu siç deklarojnë edhe disa serbë.

"Deri më tani ne nuk ua kemi pa hairin aspak administratës së UNMIK-ut në veri, të gjitha shërbimet tona i kryejmë në jug të qyteti" thotë Adem Mripa, përfaqësues i "Lagjes së boshnjakëve".

Edhe Milloshi, nga komuniteti serb thotë se administrata e UNMIK-ut në veri funksionon shumë dobët. "Unë për vete as që kam shkuar ndonjëherë për të marrë ndonjë dokumentacion në këtë administratë, por e di që funksionon shumë dobët" - thotë ai.

Disa bashkëkombës të tij, që nuk dëshirojnë t'u përmendet emri në gazetë, thonë se kjo administratë është atje sa për sy e faqe, sepse serbët çdo dokument që u nevojitet e nxjerrin në komunën paralele që funksionon atje.

Nga kjo del se përfituesit e buxhetit të Kosovës, janë vetëm "punëtorët" serbë të administratës së UNMIK-ut që marrin paga pa u lodhur fare, ndonëse nuk e njohin shtetin e Kosovës dhe të cilët, në kontaktet me qytetarët, thonë se paguhen nga administrata e UNMIK-ut e jo nga Qeveria e Kosovës.

Idrizi: Kjo nuk e ndihmon integrimin...

Sidoqoftë, ndarja e buxhetit të Kosovës për këtë grup serbësh që nuk e njohin shtetin e Kosovës, një vit pas marrjes së këtij statusi, nuk tingëllon aspak në rregull për shoqërinë civile.

Valdete Idrizi, drejtoreshë e OJQ-së, CBM, thotë se për vetë faktin që procesi nuk është transparent, se nuk mund të vërtetohen se ku janë ata njerëz dhe çka punojnë që marrin paga nga buxheti i Kosovës, kjo gjë nuk është në rregull.



Ajo shprehet se nëse investohet në këtë mënyrë për një numër të madh njerëzish, pa kërkuar llogari nga ta, atëherë nuk shkohet nga integrimi por nga paralizimi i këtyre njerëzve.

Si qytetare ajo do që t'i shohë kontratat e punës së këtyre punëtorëve.

"Vitet e fundit, në shumë raste, zyrtarët e UNMIK-u nuk kanë treguar performancat e tyre se janë të interesuar për integrim, por të kundërtën. Prandaj tani kemi një situatë dyfish më të vështirë, sepse muret e ndarjes janë më të forta se disa vite me parë, si rezultat i mosefikasitetit të punës së tyre" - thekson Idrizi.

"Misioni i UNMIK-ut në Kosovë ka qenë i suksesshëm, mirëpo është koha që të përmbyllet kjo histori e suksesshme dhe ne i falënderojmë të gjithë njerëzit që kanë punuar në Kosovë gjatë kësaj kohe, pavarësisht nga cili vend kanë ardhur, sepse kanë bërë investime të mëdha dhe paralelisht është koha që të kemi një mbështetje në lëvizjen energjike e të fuqishme nga ana e EULEX-it në Kosovë" - pati deklaruar kryetari i Republikës së Kosovës, Fatmir Sejdiu gjatë një vizite në Mitrovicë, të realizuar më 24 mars të këtij viti.

Derisa institucionet qendrore kërkojnë çdo ditë largimin e UNMIK-ut, duke konsideruar se ka përfunduar misioni i tij, Komuna e Mitrovicës, në planin e saj të hartuar në afatin trevjeçar 2009-2011, parasheh buxhet edhe për administratën e UNMIK-ut në veri.

Sa i përket kësaj, Idrizi thotë se institucionet qendrore ndryshe flasin e ndryshe veprojnë, mirëpo edhe komuna e ka pjesën e vet të gabimit që planifikon buxhet për UNMIK-un edhe në të ardhmen.

"Në emër të asaj që shpeshherë e përmendin se Mitrovica është problem i Kosovës, bëhen edhe parregullsi të shumta, ku as komuna nuk ka justifikim" - thotë ajo. Përveç të tjerash, me pjesën e ndarë nga buxheti i komunës së Mitrovicës, në drejtorinë e arsimit të kësaj komune, mësojmë se paguhen edhe dhjetëra mësimdhënës serbë që i takojnë komunës së Skenderajt dhe asaj të Vushtrrisë.

Shala: Në buxhetin e planifikuar për tri vitet e ardhshme përfshihet edhe administrata e UNMIK-ut

Një zyrtar i administratës së UNMIK-ut në Mitrovicë, në anonimitet thotë se misionin e UNMIK-ut nuk e kanë caktuar institucionet e Kosovës dhe as nuk mund t'ia ndërpresin. Sipas tij, UNMIK-u është e vetmja lidhje ndërmjet institucioneve të Kosovës dhe veriut të saj dhe në qoftë se ky mision përfundon tani, atëherë Kosova do të shkëputë çdo lidhje me këtë pjesë. Ai thotë se një numër i banorëve serbë në veri, kryejnë shërbime në këtë administratë, punëtorët e së cilës, konfirmon ai, marrin paga të dyfishta, nga Qeveria e Kosovës dhe ajo e Serbisë.

Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Bajram Rexhepi, i kontaktuar përmes zyrës për informim, nuk dëshiron të prononcohet për çështjen e buxhetit nga aspekti politik, duke na sugjeruar t'i drejtohemi Drejtorisë së Financave.

Drejtori i financave, Gani Shala, tregon shifrat e buxhetit për administratën komunale në jug dhe atë në veri, duke pranuar se në buxhetin e planifikuar për tri vitet e ardhshme përfshihet edhe administrata e UNMIK-ut.

"Derisa nuk ndahet komuna, ne planifikojmë buxhet edhe për atë pjesë, por në momentin që atje do të themelohet një komunë tjetër, që parashihet edhe me planin e Ahtisarit, atëherë atyre u shkon buxheti direkt nga qeveria dhe ne s'kemi të bëjmë asgjë me ta" – thotë Shala.

Ndaj çdo pyetjeje tjetër në lidhje me korrektësinë apo jo korrektësinë e ndarjes së buxhetit, ai ndihet jo kompetent për të dhënë përgjigje, duke thënë se kjo është çështje politike dhe nuk është detyrë e tij të merret me të.

Përfshirja e administratës së UNMIK-ut në planifikimin buxhetor për periudhën trevjeçare ka shqetësuar edhe ekipin monitorues të punës së Kuvendit Komunal të Mitrovicës, të përbërë nga disa organizata joqeveritare, të cilat me rastin e prezantimit të raportit të tyre mbi monitorimin, që u bë me 8 prill të këtij viti, i rekomanduan Qeverisë së Kosovës dhe KK të Mitrovicës të definojë qartë rolin dhe përgjegjësitë e instrumenteve ndërkombëtare për Mitrovicën dhe të largojë ndarjen buxhetore për UNMIK-un. ■

Azilkërkues vetëm nga Shqipëria dhe Bosnja

Çdo shtetas i huaj mund të kërkojë azil në Republikën e Kosovës nëse i plotëson kushtet për kërkesën e azilit, në bazë të legjislacionit në fuqi

Fatos SHALA

Çdo shtetas i huaj mund të kërkojë azil në Republikën e Kosovës nëse i plotëson kushtet e kërkesës së azilit dhe të Konventave Ndërkombëtare, përkatësisht Protokollit të Gjenevës të vitit 1951. Në Republikën e Kosovës janë vetëm 28 raste që kanë kërkuar azil. Që nga viti 1999 janë 23 raste, ndërsa që nga shpallja e pavarësisë së vendit ka pasur 5 raste te azilkërkuesve. Azilkërkimi në Kosovë është i miratuar me ligj.

Gjysma e këtyre që e kanë fituar të drejtën e azilit, janë azilkërkues politikë, ndërsa gjysma tjetër ekonomikë.

Kompetencat për azil në Kosovë ende i ka UNHCR-ja dhe procedurat për përcaktimin e statusit të azilkërkuesve i kryen kjo organizatë në bashkëpunim me Departamentin për Kufij, Azil dhe Migracion në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Që nga shpallja e pavarësisë 5 raste të azilkërkuesve

Këshilltari politik pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, Fisnik Rexhepi, ka thënë se nuk ka shumë kërkesa për azil në Kosovë. Ai ka shtuar se shkaku pse janë kaq pak nuk dihet, por ka lënë të kuptohet se Kosova ka vetëm një vit që është bërë e pavarur.

"Që nga shpallja e pavarësisë së vendit kemi pasur 5 raste të azilkërkuesve, kurse nga viti 1999 kanë qenë 23 raste, prej tyre 2 raste kanë qenë nga Shqipëria, ndërsa një rast është nga Bosnja" - ka thënë Rexhepi, duke shtuar se çdo shtetas i huaj mund të kërkojë azil nëse i përmbahet kushteve të parapara me ligj. "Çdo shtetas i huaj mund të kërkojë azil në Republikën e Kosovës nëse i plotëson kushtet për kërkesën e azilit, në bazë të legjislacionit në fuqi" – është shprehur Rexhepi.

Ndihma për azilkërkuesit

Azilkërkuesi mund të kërkojë azil në gjuhën të cilën ai ose ajo e kupton dhe nga ai/ajo nuk kërkohet të kërkojë azil në ndonjërën nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës. Azilkërkuesi do të informohet për procedurën për përcaktimin dhe njohjen e azilit, për të drejtat dhe detyrimet e tij/saj në procedurën e tillë, si dhe për të drejtën që të kontaktojë Komisionarin e Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë – UNHCR-në, dhe ndonjë Organizatë Joqeveritare - OJQ, të cilat ju ofrojnë ndihmë azilkërkuesve. Azilkërkuesi e ka të drejtë të zgjedhë një përfaqësues ligjor, i cili do ta ndihmojë dhe përfaqësojë atë gjatë procedurës për përcaktimin e azilit, me shpenzimet e azilkërkuesit. Përfaqësuesi ligjor i azilkërkuesit, si dhe përfaqësuesi i Zyrës së UNHCR-së, kanë të drejtë të kontaktojnë azilkërkuesin në çdo kohë dhe në secilën fazë të procedurës për përcaktimin e azilit. Azilkërkuesi ka të drejtë të flasë me përfaqësuesin e vet ligjor ose përfaqësuesin e UNHCR-së në çdo kohë, si dhe të jetë i informuar për këtë të drejtë. ■

Ligji dhe mënyra e azilkërkimit

Një i huaj mund të kërkojë azil në Kosovë në bazë të Ligjit Nr. 03/L-66, si dhe në bazë të procedurave dhe standardeve për trajtimin e azilkërkuesve, në pajtim me dispozitat dhe parimet e përcaktuara në instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të cilat janë direkt të zbatueshme në Republikën e Kosovës, si dhe të Konventave Ndërkombëtare, përkatësisht Protokollit të Gjenevës të vitit 1951.

Rrezet radioaktive kërcënojnë Kosovën

Kosova po kontaminohet për ditë e më shumë me rreze jonizuese-radioaktive që shqisat e njeriut nuk mund t'i shohin. Sipas atyre pak ekspertëve që ka Kosova në lëmin e radioaktivitetit, rrezatimet e këtilla do të kenë pasoja në ardhmërinë e këtij vendi dhe këtij populli



Sabri HALILI

Problemi i kontaminimit të ambientit, sidomos me rrezatimet jonizuese-radioaktive në Kosovë, me sa duket është një temë tabu, për të cilën vetëm gazetarët apo qytetarët e zakonshëm shprehin herë pas here ndonjë shqetësim. Por çfarë dobie ka nga kjo kur ky shqetësim nuk prek asnjë ndjenjë të pushtetarëve, gjegjësisht të kompetentëve për mbrojtjen e ambientit dhe të shëndetit në Kosovë. Ata nuk duken askund, nuk dëgjohen asnjëherë dhe nuk shihen të ndërmarrin ndonjë veprim konkret për përmirësimin e gjendjes shumë alarmante për ambientin e Kosovës. Ata heshtin për të krijuar në opinion publik një situatë thuajse nuk ka ndodhur e as nuk po ndodh diçka në këtë fushë.

Ekspertët e kësaj fushe, ata të paktë që janë aktualisht në Kosovë, herë pas here dërgojnë sinjale alarmi për ata që i shohin, i ndiejnë dhe i dëgjojnë sinjalet e tilla. Ata sinjalizojnë për rrezikun nga e kaluara dhe nga e tashmja, sidomos nga rrezatimet jonizuese-radioaktive që e kanë kontaminuar ajrin dhe tokën e Kosovës.

Ditë më parë, edhe në media u dhanë lajme konkrete, mjaft shqetësuese për numrin e madh të objekteve radioaktive në komunën e Prizrenit, duke filluar prej rrufepritësve radioaktivë e deri te antenat e ndryshme satelitore, që u shërbejnë individëve dhe grupeve të caktuara të interesit.

IMP: Këto rrezatime shkaktojnë edhe dëmtime gjenetike, që barten deri në 30 breza

Edhe pse nuk kemi ndonjë ekspertizë në këtë lëmi, disa ekspertë nga Instituti i Mjekësisë së Punës (IMP), kanë paralajmëruar disa institucione komunale, por edhe Ministrinë e Ambientit dhe të Planifikimit Hapësinor, për prezencën tepër të madhe të këtyre materieve jonizuese në tërë Kosovën, për të cilat thanë se janë më të rrezikshme se çdo ndotës tjetër fizik, biologjik apo kimik. Sipas këtij instituti dhe atyre pak ekspertëve që ka Kosova në këtë lëmi, këto rrezatime radioaktive do të kenë pasoja në ardhmërinë e këtij vendi dhe këtij populli. Këto rrezatime, sipas këtij instituti, shkaktojnë edhe dëmtime gjenetike që barten tek pasardhësit, madje edhe deri në 30 breza. Por, në mungesë të matësve të radioaktivitetit, gjegjësisht rrezatimeve jonizuese, për shkak të mungesës së ekspertëve të mjaftueshëm për këtë lëmi, edhe nuk ka matje të saktë për shkallën e radioaktivitetit në Kosovë. Më relevant në këtë moment është fakti se ky lloj rrezatimi është i pranishëm në Kosovë dhe se edhe sasia shumë e vogël është tepër e rrezikshme, sepse pasojat e këtij rrezatimi paraqiten shumë më vonë.

Askush deri tashti nuk ka konstatuar, në mënyrë kompetente, se cilat substanca, apo objekte, e përmbajnë këtë radioaktivitet. Instituti i Mjekësisë së Punës pohon se këto burime kryesisht janë nga rrufepritësit radioaktivë dhe nga antenat satelitore, gjegjësisht kobalti, europiumi dhe americiumi, të cilat bëjnë pjesë në grupin e elementeve më radioaktive. Megjithatë, është e qartë se ende nuk është dhënë përgjigje e qartë për pjesët e tjera të Kosovës, ku edhe në të kaluarën ka pasur objekte dhe elemente të tilla radioaktive. Madje nuk është dhënë përgjigje e duhur se sa është shkalla e radioaktivitetit edhe e mbeturinave të ndryshme nga lufta e fundit, kur dihet se pjesët e tjera të Kosovës, si Drenica, Dukagjini, Llapi e Mitrovica kanë qenë pjesët më të militarizuara dhe më të atakuara nga këto elemente. Dhe kur dihet fakti se nuk kemi as vende të përshtatshme për deponimin e këtyre materieve, rreziku është edhe më i lartë.



Aparatet rëntgenologjike – burime shumë të dyshimta të rrezatimeve

Edhe nga e kaluara jo e largët dihet se ka pasur burime të shumta të rrezatimeve radioaktive. Kryesisht kanë qenë rrufepritësit radioaktivë dhe qindra aparate të fotografimit röntgenologjik nëpër spitale dhe nëpër shtëpitë e shëndetit.

Të parët ishin të vendosur kryesisht në objektet më të frekuentuara me njerëz, gjegjësisht të rinj, pikërisht në kohën kur në shumë pjesë të ish-Jugosllavisë kishin urdhëruar heqjen e tyre, për shkak të rrezikut, gjegjësisht për pasojat. Mbaj mend se vetëm në Prishtinë kanë qenë të vendosur së paku 3 rrufepritës radioaktivë. Dy prej tyre kanë qenë të vendosur në Qendrën e Studentëve, ndërsa një tjetër në konviktin e Shkollës Normale. Në komunat e tjera kanë qenë të vendosura edhe në fabrika, por edhe objekte të tjera shumë të frekuentuara, sidomos me të rinj. Kjo nuk kërkon koment, apo jo!?

Burime shumë të dyshimta të këtyre rrezatimeve kanë qenë edhe aparatet röntgenologjike.

Nëpër spitale dhe nëpër shtëpitë e shëndetit kanë qenë të instaluara aparate fotografimi röntgenologjik, të cilët kanë qenë me paravan të dobët dhe me efekte të mëdha në kontaminimin e ambientit për rreth. Edhe në atë kohë nuk ka pasur as aparate për matjen e radioaktivitetit në Kosovë, por as ekspertë të duhur për ekzaminimin e këtyre rrezatimeve. Të vetmit ekspertë dhe e vetmja ekspertizë është bërë nga një institut i specializuar nga Beogradi, të cilët edhe i kanë instaluar të gjithë rrufepritësit radioaktivë në Kosovë.

Institucionet duhet të kërkojnë zgjidhje të menjëhershme

Duke i pasur parasysh këto fakte, gjegjësisht duke parë dhe dëgjuar alarmin e rrezikut nga kjo gjendje e krijuar me dekada, e cila tashmë është në fazën kulminante, institucionet e Kosovës, presidenca, qeveria, e para së gjithash deputetët e Kuvendit të Kosovës duhet ta ngrenë këtë çështje në nivelin që meriton dhe të kërkojnë zgjidhje të menjëhershme. Zgjidhja më e mirë do të ishte identifikimi i të gjitha këtyre burimeve, sigurimi i mjeteve financiare për të siguruar ekspertizë dhe, në fund, për të siguruar një lokacion për deponimin e këtyre materieve, nga ku nuk do të ishte e mundur përhapja e rrezatimeve në ambientet jetësore, qoftë të njerëzve apo të kafshëve.

Ky alarm, para së gjithash, duhet të jetë një ndërgjegje e vrarë edhe për të ashtuquajturit ambientalistë të Kosovës, gjegjësisht Partinë e të Gjelbërve të Kosovës, të cilëve mbi të gjitha u intereson vetëm stoli pushtetar, sepse deri tashti nuk kanë realizuar asgjë nga programi i tyre ambientalist.

Mu për këtë, tani u mbetet vetëm gazetarëve, qytetarëve dhe atyre pak ekspertëve, të flasin për këto gjëra me aq rrezikshmëri. Ndoshta, nganjëherë, në mënyrë jokompetente, joprofesionale, por për kompetentët duhet të mjaftojnë qoftë edhe indicet për një problem të tillë, për t'u zgjuar nga agonia shumëvjeçare, sa nuk është bërë tepër vonë. ■

Korrespodencë nga Shkupi

Bojkoti, izolimi apo integrimi?!...



Avni AVDIU

Raundi i dytë i zgjedhjeve komunale dhe presidenciale në Maqedoni dëshmoi lodhjen e elektoratit me politikën në përgjithësi, e në veçanti stërlodhjen e elektoratit shqiptar. Dy kandidatët maqedonas Ivanov dhe Fërçkovski, gjatë fushatës dhe debateve të tyre, nuk ofruan asgjë për shqiptarët, kështu që shqiptarët nuk kishin as arsyen më të vogël që të votonin për ta. Si Gligorovi, Trajkovski dhe Cërvenkovski ishin presidentët që u zgjodhën edhe me votën e shqiptarëve, bile vota e shqiptarëve ishte përcaktuese. Po as njëri e as tjetri nuk bën as ndonjë hap sado të vogël, qoftë edhe simbolik, për ta kthyer këtë nder. Përkundrazi, ata nuk i shfrytëzuan as ingjerencat e tyre kushtetuese për të shlyer padrejtësinë e gjyqeve të montuara, kështu që akoma pa pikë faji burgjeve të Maqedonisë dergjen dhjetëra shqiptarë, duke vuajtur dënimet për veprat që kurrë nuk i kanë bërë. Ish-presidentët nuk e panë të arsyeshme të amnistonin një shqiptar, edhe pse kanë amnistuar dhjetëra maqedonas mbi supet e të cilëve kanë qenë të ngarkuara krimet më të rënda. Mu për këtë dhe arsye të tjera të shumta, përgjigjja më e mirë e shqiptarëve ndaj zgjedhjeve presidenciale ishte injorimi. Megjithatë, ndonëse injorimi i shqiptarëve ndodhi në masën më të madhe, prapëseprapë një pjesë fare e vogël e manipuluar, ishte decisive për të përcaktuar presidentin e ardhshëm të vendit.

Shqiptarët e Maqedonisë treguan pjekuri të madhe politike

Pra, edhe si herët të tjera, edhe kësaj radhe shqiptarët zgjodhën presidentin e vendit, ndonëse ende shumë gjëra kanë ngelur pezull, madje edhe në ndërgjegjen e ish-presidentëve. Pa mbi 17 mijë votat e pavlefshme dhe rreth 8 mijë votat e vlefshme të elektoratit shqiptar nuk do të arrihej censusi (ndonëse censusi prej 40 % mbetet i rrezikshëm) për të zgjedhur presidentin. Përkundër thirrjes publike të Bashkimit Demokratik për Integrim që shqiptarët të votojnë kandidatin e VMRO-së, zgjedhjet për president u bojkotuan në masë të madhe.

Jehona e votuesve në Maqedoninë Lindore ishte mbi 70 %. Dalja kaq e madhe e maqedonasve tregon gatishmërinë e tyre që zgjedhjet presidenciale të mos dështonin. Mirëpo shqiptarët dolën fare pak, ata përgjithësisht i bojkotuan zgjedhjet presidenciale…dhe kjo është shenjë bukur e mirë se ata kanë filluar të kthjellen. Me këtë, shqiptarët e Maqedonisë treguan pjekuri të madhe politike, duke ua bërë me dije partive të tyre politike se koha e direktivave e diktateve partiake veç ka perënduar qëmoti. Shqiptarët treguan se përgjithësisht dinë të votojnë edhe sipas vlerësimeve të tyre, e jo sipas udhëzimeve të liderëve politikë. Treguan se nuk duan t'i japin më përkrahje të verbër asnjë kandidati për president shteti, pa marrë prej tyre garanci për zgjidhjen e çështjeve të hapura shqiptare. Me këtë, elektorati po i dërgon sinjale të qarta partisë në pushtet se nuk është i kënaqur me koalicionimin kukull dhe se nuk e mbështet politikën



të cilën po e zhvillon kjo parti me partnerin qeveritar.

Bojkoti është numërues i përbashkët i dëshpërimit e i pakënaqësisë ndaj burokracive partiake shqiptare, që votën e popullit e shfrytëzojnë vetëm për pasurimin dhe mirëqenien e tyre individuale e klanore. Shqiptarët i thanë JO politikës së ndërtimit të kishave mbi themele të xhamive, i thanë JO politikës diskriminuese të natalitetit dhe i thanë JO politikës degraduese të VMRO-së ndaj tyre. Do të ishte shumë më mirë të mos kishte fare vota të shqiptarëve për president, sepse atëherë me siguri se do të faktorizoheshin shumë çështje të shqiptarëve. Tashmë kur VMRO-DPMN-ja ka pothuajse pushtet monarkik absolut, me qeveri, president, e pushtet të vetin edhe në shumë komuna të Maqedonisë, gjithashtu pritet që injorimi ndaj shqiptarëve të jetë edhe më i thellë.

Kjo politikë izoluese që e ka konservuar interesin shtetëror në ruajtjen e fanatizmit nacionalist është e huaj për shqiptarët. Prandaj shqiptarët nuk mund të mbeten peng i krizës së identitetit etnik maqedonas, dilemës dhe ambiguitetit të tyre antik e sllav. Partitë politike maqedonase përmes përplasjeve të tyre (VMRO-DPMNE dhe LSDM) u marrin kohë shqiptarëve, duke improvizuar zënka reciproke. Shqiptarët duhet të kenë strategjinë e tyre se çfarë duhet të bëjnë më tutje e jo të merren me atë se çfarë kanë ndërmend të bëjnë maqedonasit. Shqiptarët nuk e kanë pozitën të presin mëshirë, por drejtësi. Në momentet kur Shqipëria u bë anëtare e Nato-s dhe Kosova e pavarur po hapëron drejt konsolidimit shtetëror, shqiptarët e Maqedonisë duhet ta kuptojnë se çfarë janë tani, e çfarë mund të jenë nesër. Ata ashtu siç ditën të rezonojnë për këto zgjedhje, duhet të kuptojnë njëherë e përgjithnjë lojën e partive të tanishme politike shqiptare. Partitë shqiptare kur vijnë në pushtet flasin ndryshe, në opozitë revoltohen. Prandaj shqiptarët në Maqedoni në krahasim me atë se çfarë kanë mundur të fitojnë, përkundër disa të drejtave të arritura, janë humbës të mëdhenj. Gruevski dhe partia e tij VMRO-DPMNE arriti t'i përçante shqiptarët dhe mbi këtë bazë, dhe mbi bazën e kokëfortësisë nacionaliste ndaj kontestit me Greqinë, arriti të fitojë besueshmëri të madhe te maqedonasit. Me shqiptarët pushteti maqedonas përdor logjikën e dikurshme jugosllave, që i mbante disa shqiptarë të ndershëm veçse për dekor, që i shërbenin për interesa shtetërore të politikës së jashtme.

Rikthimi dinjitoz i Rufi Osmanit në skenën politike

Këto zgjedhje kishin rëndësi për faktin e paraqitjes së sërishme të Rufi Osmanit në politikë. Fitorja e tij bindëse në Gostivar me 6205 vota më tepër se rivali i tij politik nga radhët e BDI-së, është sinjali më i mirë i shqiptarëve që ua dërgojnë partive të tyre politike, por edhe Gruevskit dhe VMRO-së. Tentimet e koalicionit VMRO-BDI për të gjunjëzuar atë në Gostivar, janë veprime të ulëta të partisë shqiptare në pushtet, e cila kërkon votën e maqedonasve për ta mposhtur një kandidat shqiptar, të dëshmuar intelektualisht, politikisht dhe kombëtarisht. Rufi Osmani vetë mundi BDI-në dhe PDSH-në dhe kjo, e parë në një analizë më të thellë, tregon se populli i voton këto parti sepse nuk ka opsion dhe alternativë më të mirë. Prandaj këto zgjedhje të këqija, për shqiptarët patën edhe anë të mira: u dëshmua se shqiptarët nuk janë dele për t'u grahë partitë nga të duan interesat e tyre të ngushta, se përgjithësisht u bojkotuan zgjedhjet presidenciale dhe me këtë, në të ardhmen, kandidatëve të tjerë mund t'u kërkohen kushtëzime nëse duan votat shqiptare dhe mund të kërkohet edhe nënpresidenti shqiptar dhe, po ashtu, anë tjetër pozitive e këtyre zgjedhjeve është dalja e sërishme e Rufi Osmanit në skenën politike në Maqedoni. Zaten kjo mund të ishte gjëja më e mirë që do të mund të ndodhte në përgjigje ndaj politikës së inskenuar dhe të instrumentalizuar të VMRO-DPMNE-së, e cila i nxit ithtarët e saj të dalin në sheshin qendror të Shkupit dhe t'u drejtohen studentëve të Fakultetit të Arkitekturës, të cilët nën moton 'Mos e dhunoni qytetin', dolën në protestë të qetë kundër ndërtimit të kishës në sheshin qendror të Shkupit me klithmat: 'shiptari', duke e konsideruar këtë ofendim. Nëse mund të ketë fjalë ofenduese për maqedonasit, ajo do të duhej të ishte 'grci', e jo 'shiptari'. Megjithatë kjo tregon dhe dëshmon mentalitetin e maqedonasve dhe disponimin e tyre antishqiptar. Së këtejmi, ishte e nevojshme dhe e domosdoshme kjo përgjigje e elektoratit shqiptar për t'u treguar maqedonasve se ne s'lejojmë të jemi edhe të ofenduar, edhe të shfrytëzuar. ■

Rruga e Shqipërisë për në NATO

Hyrja e Shqipërisë në NATO, padyshim është një ngjarje historike për shqiptarët, sepse shënon fundin e një rruge të gjatë të një kombi me një histori të dhimbshme për mbijetesë, i dëmtuar nga shumë luftëra, ndarje të territorit dhe i kërcënuar vazhdimisht deri në zhdukje, sidomos gjatë shekullit të fundit



Arben MUHAMETI

Në mëngjesin e hershëm të datës 1 prill, Shqipëria u bë anëtare e organizatës më të fuqishme ushtarake në botë. Në ceremoninë e zhvilluar në Departamentin e Shtetit, ambasadori i Shqipërisë ia dorëzoi sipas procedurave standarde instrumentet e anëtarësimit nënsekretarit amerikan të shtetit, Xhejms Stainberg, duke plotësuar kështu procesin e anëtarësimit, proces ky i filluar në vitin 1992. Padyshim kjo ngjarje është historike për shqiptarët, sepse shënon fundin e një rruge të gjatë të një kombi me një histori të dhimbshme për mbijetesë, i dëmtuar nga shumë luftëra, ndarje të territorit dhe i kërcënuar vazhdimisht deri në zhdukje, sidomos gjatë shekullit të fundit.

Kështu, Shqipëria po shndërrohet nga një vend që kishte nevojë për siguri permanente në një vend që prodhon siguri. Mbështetja e shqiptarëve për anëtarësim ishte e fuqishme në 96 për qind, një kuotë e paparë kjo në vendet e tjera. Ajo, në fakt, u rrit jashtë mase pas ndërhyrjes së aleancës për të ndalur gjenocidin serb në Kosovë, në vitin 1999.

Më 3 dhe 4 prill, shqiptarët përjetuan një ëndërr, kur vendi i tyre mori pjesë si anëtare me të drejta të plota të Aleancës në takimin e nivelit të lartë zhvilluar në Francë dhe Gjermani. Dhe kur flamuri shqiptar u rreshtua përkrah atyre të vendeve të tjera euroatlantike, u hodh një hap i madh drejt sigurisë dhe integrimit, një hap që më të drejtë i bën krenar të gjithë shqiptarët.

Një historik i shkurtër i NATO-s

NATO është organizata më e madhe ushtarake politike në botë. Ajo u krijua si pasojë e ngjarjeve politike që e çuan krizën botërore në pikën më kritike. Ishte një frikë e arsyeshme ndaj zgjerimit dhe militarizimit të vazhdueshëm të Bashkimit Sovjetik. Nënshkrimi i Traktatit të Brukselit, në mars të vitit 1949, shënoi vendosmërinë e pesë shteteve të Evropës Perëndimore: Belgjikës, Francës, Holandës, Luksemburgut dhe Anglisë që të zhvillonin një sistem të përbashket mbrojtjeje dhe t'i forconin lidhjet midis tyre, në mënyrë që t'u rezistonin kërcënimeve ideologjike, politike dhe ushtarake që vinin nga blloku sovjetik. Pas zgjerimit të mëtejshëm, deri në 12 shtete, përfshirë edhe Shtetet e Bashkuara te Amerikës, në Uashington u nënshkrua Traktati i Uashingtonit (prill 1949), i cili krijoi një sistem të përbashkët sigurie të bazuar në partneritetin midis këtyre shteteve. Data e nënshkrimit të Traktatit të Uashingtonit është edhe data zyrtare, legale e krijimit të Organizatës së Atlantikut të Veriut, NATO-s. Kështu, bota ishte ndarë në dy pjesë, ku rivaliteti dhe gara e armatimeve midis dy blloqeve politike dhe ushtarake: Traktatit të Varshavës dhe NATO-s e futi atë në Luftën e Ftohtë, më të madhe dhe më të kushtueshme që njeh historia. Nga ky rivalitet i ashpër dhe i kushtueshëm u gjunjëzua dhe u shpërbë Bashkimi Sovjetik dhe natyrisht Traktati i Varshavës. Në këto zhvillime të reja strategjike, liderët e vendeve anëtare të NATO-s (Bruksel 1994) vendosën hapjen e dyerve të aleancës për pranimin e anëtarëve të rinj nga Evropa Lindore. Misioni i NATO-s ngeli vazhdimi i një aleance politike dhe ushtarake për mbrojtjen dhe sigurimin e të gjitha vendeve anëtare të saj dhe ruajtjen e paqes në hapësirat euroatlantike.

Në samitin që u zhvillua në Madrid, në vitin 1997, NATO ftoi për herë të parë për anëtarësim nga Evropa Lindore ish-anëtarët e Traktatit të Varshavës, Poloninë, Hungarinë dhe Republikën Çeke, të cilat në samitin e vitit 1999 edhe u pranuan në Aleancë. Në këtë samit u përshëndet puna e bërë nga 9 vendet e tjera pretendente të Evropës Lindore, ndër to edhe e Shqipërisë, por asnjërës prej tyre nuk iu dha kalendari i mundshëm i anëtarësimit. Atyre vetëm iu dha plani i veprimit të anëtarësimit. Ky plan përmbante veprimtaritë që nevojiteshin të bëheshin për të arritur në standardet që sqarohen për anëtarësim në pesë fushat e mëposhtme: reformat politike dhe ekonomike, reformat në politikat e mbrojtjes dhe konceptet ushtarake, burimet financiare të mbrojtjes, temat e sigurisë, reformat në drejtësi. Vendet aspirante organizuan programet e përgaditjes vjetore kombëtare sipas planit të veprimit të anëtarësimit. Në planin e veprimit të anëtarësimit ngelën prapa vetëm Shqipëria dhe Maqedonia. Shtetet e tjera iu bashkuan aleancës në prill 2004. Në këtë situatë, në Samitin e Stambollit të vitit 2004 u vendos vazhdimi i mëtejshëm i planit të veprimit për anëtarësim i Shqipërisë. Në Samitin e Bukureshtit të vitit 2008, Shqipëria mori ftesën e anëtarësimit për në NATO. Vlerësimi ishte individual, Kroacia i kishte plotësuar të gjitha kushtet, Shqipërisë iu vunë përpara dy kushte: reforma zgjedhore dhe reforma në drejtësi.

Hapat e Shqipërisë drejt NATO-s

Shqipëria kërkoi zyrtarisht anëtarësimin në NATO në vitin 1992. Që në fillim të viteve 90, me protestat e studentëve dhe lindjen e partive politike, nisi të artikulohej ideja e integrimit të vendit në NATO dhe në Bashkimin Evropian. Shqipëria, në fakt, ishte i pari vend ish-komunist i dalë nga një sistem totalitar i cili kërkoi të anëtarësohej në Aleancën Veriatlantike. Pak kohe pas zgjedhjeve të para pluraliste, Tirana zyrtare u bashkua me Këshillin e Bashkëpunimit të Traktatit të Atlantikut të Veriut.

Pas një veprimtarie tejet të ngjeshur diplomatike, në vitin 1994, Shqipëria nënshkroi Programin e Partneritetit për Paqen të NATO-s. Në vitin 1996, me gjithë situatën aspak të mirë politike, pasi që u krijua një imazh jo i mirë me manipulimin e zgjedhjeve të përgjithshme nga pushteti i atëhershëm që udhëhiqej nga e djathta, Shqipëria arriti të

dërgonte misionin e parë paqëruajtes në Bosnjë, nën siglën e NATO-s.

Ndërkaq lufta në Kosove do të ishte një tjetër pikë kulminante në marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe NATO-s. Në vitin 1998, shteti shqiptar vendosi të vinte në dispozicion të NATO-s të gjitha hapësirat ajrore, detare dhe tokësore. Ndërkohë që, një vit më vonë, NATO vendosi një bazë logjistike në Tiranë për të mbështetur operacionet aleate në Kosovë.

Pas këtij bashkëpunimi dhe garancive të ofruara nga Tirana zyrtare, filloi të ndryshonte për të mirë qëndrimi i krerëve të Aleancës dhe vendeve anëtare në lidhje me Shqipërinë. Në fund të vitit 2000, zv. sekretari i përgjithshëm i Aleancës, Sergio Balanzino do të deklaronte: "Shqipëria është një vend besnik ndaj NATO-s. Ajo zë një vend strategjik në Ballkan dhe për shumë arsye ne e kemi ndihmuar atë në drejtim të reformimit të forcave të armatosura dhe përmirësimit të strukturave të tyre". Në vitin 2003, Shqipëria dërgoi një trupë ushtarake në Afganistan, nën siglën e NATO-s dhe një vit më vonë do të nënshkruante, së bashku me Kroacinë dhe Maqedoninë, "Kartën e Adriatikut", një bashkëpunim rajonal me qëllim kryesor hyrjen në NATO, bashkëpunim ky që u tregua shumë efikas.

Radhitja kohore e rrugës së Shqipërisë për në NATO mund të përmblidhet shkurtimisht në këto data:

Në vitin 1992, Shqipëria bashkohet me Këshillin e Bashkëpunimit të Atlantikut të Veriut.

Në vitin 1994, bashkohet në programin e partneritetit për paqen.

Në vitin 1996 -Forcat Shqiptare bashkohen me ato të Aleancës në Bosnje e Hercegovinë.

Në vitin 1999, NATO vendos një bazë logjistike në Tiranë për të mbështetur operacionet aleate në Kosovë

Në vitin 2000, Shqipëria organizon manovrat "Adventure Express" në prill dhe "Cooperative Dragon" në qershor.

Në vitin 2001-Shqipëria organizon fazën fillestare të manovrave të PFP-së "Adventure Express 01".

Në vitin 2002-Ngrihet "NATO HQ TIRANA" për të ndihmuar Shqipërinë në zbatimin e reformave të aftësive të saj ushtarake si dhe për të kontribuar në komandën dhe kontrollin e KFOR-it.

Në vitin 2003 - Forcat Shqiptare dislokohen në mbështetje të Forcës së Ndihmës për Sigurinë të Nato-s në Afganistan (ISAF).

Në vitin 2005 - Shqipëria bashkohet me konceptin e aftësive operacionale. Po në këtë vit, një ekip i kombinuar mjekësor i tre vendeve të MAP-it bashkohet me forcat e drejtuara nga NATO, në Afganistan, në muajin gusht. Ndërkohë që Shqipëria organizon manovrat e PFP-së "Cooperative Engagement 05" në shtator.

Në vitin 2007 - Shqipëria organizon takimin e Grupit Këshillimor të Politikës Euroatlantike EAPC në maj. Gjithashtu organizon manovrat "Cooperative Longboe 07" dhe "Cooperative Lancer 07".

Cilat ishin avantazhet e Shqipërisë për anëtarësim dhe përfitimet nga anëtarësimi?

Shqipëria është ndoshta vendi i vetëm në Ballkanin Përendimor pa konflikte apo tensione etnike. Është



vendi ku harmonia fetare ka eliminuar çdo mundësi për grindje dhe konflikte fetare. Opinioni publik dhe klasa politike shqiptare, në tërësinë e saj, nuk sundohet nga qëndrime nacionaliste. Klasa politike shqiptare e ka vlerësuar integrimin si zgjidhjen më të mirë dhe të plotë me unanimitet. Shqipëria i është bashkuar kërkesave të institucioneve ndërkombëtare që të aplikojnë standardet evropiane në fushën e demokracisë, ekonomisë dhe sigurisë. Shqipëria ka qenë kontribuuese direkte për paqen dhe harmoninë në rajon, pjesëtare aktive në të gjitha iniciativat rajonale për bashkëpunim ekonomik, gjithashtu pjesëtare aktive në disa misione të rëndësishme paqeruajtëse, si Afganistan, Irak, Bosnjë e Hercegovinë, duke treguar angazhim real. Duhet theksuar se klima politike ishte parakusht esencial i cilësisë dhe i rezultateve të reformave të rëndësishme. Në këtë proces integrimi, presioni pozitiv për cilësinë e reformave dhe respektimin e standardeve evropiane u rrit.

Në rastin e anëtarësimit në NATO, elementi kohë mori një vlerë të jashtëzakonshme. Ai u realizua shumë vonë. Po të realizohej së paku në vitin 1997 do të mund të kishte një rezultat tjetër lufta e Kosovës dhe, natyrisht, do të evitohej shkatërrimi i shtetit shqiptar në ngjarjet e njohura të vitit 1997.

Integrimi në NATO ka shumë përfitime afatgjata. Ai do të nxisë stabilitetin politik dhe ekonomik, do të rrisë sigurinë për vendin dhe rajonin, do të tërheqë më shumë investime të huaja dhe do t'i japë një vlerë shumë më të rëndësishme pozicionit gjeografik të vendit.

Pse kur u festua në Tiranë, u hesht në Kosovë?

Derisa e gjithë Shqipëria ishte në festë, në Kosovë u krijua një heshtje absurde. Askush nuk mund të thotë me saktësi se pse u mbajt një qëndrim shumë indiferent ndaj një hapi të madh për të gjithë shqiptarët. Anëtarësimi në NATO i shtetit amë, përveç të tjerash dhe para së gjithash do të thotë më shumë siguri për Kosovën, bile shprehur në terma më të thjeshtë Kosova bëhet e paprekshme ndaj çfarëdo kërcënimi dhe agresioni të huaj. Heshtja e Prishtinës zyrtare me siguri lidhet me tendencat e shprehura dhe të imponuara qysh moti të faktorit ndërkombëtar për të krijuar një identitet të ri, një komb të ri të ashtuquajturin "Komb Kosovar", i cili normalisht do të duhej të distancohej nga historia e përbashkët shqiptare, nga kultura, gjuha dhe, në këtë rast, edhe nga çfarëdo suksesi apo dështimi eventual i shtetit amë. Por një gjë duhet theksuar me forcë: kishte heshtje zyrtare, por kishte një atmosferë krejtësisht tjetër në çdo familje këtu në Kosovë. Populli i Kosovës më shumë se kushdo tjetër e di çdo të thotë NATO, çdo të thotë siguri. Prandaj gëzimi i tyre ishte i natyrshëm. Tendencat për të imponuar çfarëdo vije sjelljeje që do të ishte në kundërshtim me vullnetin e qytetarëve të Kosovës, patjetër do të përbuzen dhe kundërshtohen. ■

Rrugëtimi populist i mediumeve dhe i VMRO–DPMNE –së dhe demokracia pa konkurrencë

Nga po udhëton Maqedonia?

Fituan forcat politike që nuk do të ndërrojnë emrin e Republikës së Maqedonisë – A do të thotë se këto force nuk e dëshirojnë këtë shtet në NATO?



Nazmi MALIQI


Në rrethanat e zhvillimit të mendimit të lirë në Republikën e Maqedonisë, duke u bazuar në të drejtën e qytetarëve, mediat duhet të kultivojnë vlera që të arsyetojnë epitetin e pushtetit të katërt. Nëse i kemi parasysh rezultatet zgjedhore të raundit të dytë, 5 prill 2009, Koalicioni i VMRO – DPMNE, fitoi edhe postin e kryetarit të shtetit. Është me rëndësi fakti se tani, kur një forcë partiake ka pushtetin absolut, (presidentin, shumicën parlamentare dhe pushtetin lokal) rritja e fuqisë mediatike është me rëndësi të posaçme, në vendosjen e agjendës politike, që të jetë bartës i kontrollit të pushtetit, duke krijuar opinion publik, për një mirëqenie më të mirë sociale dhe për interesin strategjik të Republikës së Maqedonisë për inkuadrim në NATO dhe BE.

Në vazhdim do ta veçoja mendimin e Herman Budzislawski-t, në librin e tij "Gazetaria socialiste" (Leipzig, 1966), në të cilin vërehet një segment, ku ndër të tjera thuhet se: mjafton të ndjekësh vijën e partisë, për të qenë i sigurt se je objektiv. Për gazetarinë mandej shton se "Kundërshtarit i jepet fjala vetëm në qoftë se kjo fjalë na shërben ne". Parashtrohet një dilemë se: a është realiteti servilitet edhe për shumicën e mediave në Maqedoni? Nëse do të dilte një konkludim për vërtetimin e vlerësimeve të tilla, atëherë serviliteti medial është kanceronom dhe bashkëshkatërrues i vlerave të demokracisë.

Do të ishte irelevante që të qortoheshin qytetarët se si kanë votuar, ose si është dashur të votohet. Por megjithatë e vlen të bëhet një analizë faktografike: sa ishte administrata zgjedhore e partizuar, si ishte raporti i votuesve mes atyre që votuan me dëshirë dhe atyre që ishin të kushtëzuar të votojnë për kandidatët VMRO – DPMNE me ruajtjen e vendit të punës, pse në disa vendvotime, në vendbanimet shqiptare, u përsërit votimi grupor familjar, etj. Mediat duhet të plotësojnë boshllëkun demokratik zgjedhor me vizion politik të qartë për të ardhmen e Maqedonisë duke i demaskuar, apo duke i margjinalizuar politikat populiste partiake dhe qeveritare. Në rrethanat e konfiguracionit politik, të krijuara pas zgjedhjeve presidenciale dhe lokale, duke e kontrolluar pushtetin absolut për zbardhjen e informacioneve, duke i zbuluar pikat e dobëta që i krijon koalicioni qeveritar, duke e deshifruar moton e prononcimit zyrtar të shtabit të VMRO- DPMNE-së se fituan forcat që nuk do ta ndryshojnë emrin e Maqedonisë, mediat duhet të dekodifikojnë politikën populiste qeveritare, që në këto zgjedhje krijoi një ambient politik, apo një demokraci pa konkurrencë, apo me konkurrencë të dobët.

Çdo prononcim mediatik, me agjendë të qartë politike, do të ofronte ekuilibrimin e nevojshëm për ndjenjat kombëtare për identitetin maqedonas, standardet e ndërvarësisë në krijimin e raporteve të integrimeve regjionale, kompromiset e raportit bilateral Maqedoni – Greqi për ndryshimin e emrit, interesin politik, ekonomik dhe të sigurisë etj, me aktivitet të qartë, me porosi mediale, duke i promovuar vlerat e përbashkëta që posedojnë qytetarët e Maqedonisë: shqiptarët dhe maqedonasit dhe të tjerët. Mediat, nëse kanë në redaksitë e tyre potencial kadrovik me guxim intelektual, do të kodifikonin edhe të drejtën absolute për marrëdhëniet ndërkombëtare, edhe me rastin e bisedimeve Greqi - Maqedoni, që pa të drejtë VMRO – DPMNE- së ia kanë deleguar, apo ia kanë dhuruar, BDI dhe partitë e tjera politike shqiptare.

Në këtë kontekst, më duhet të bazohem në dy hulumtuesit e lëmit të komunikimit, Michael Kunczik dhe Astrid Zipfel, të cilët shprehen "për rolin e ndikimit të gazetarëve objektivë", për ata që nënkuptojnë ndershmëri dhe ekuilibër në veprimtarinë e tyre. Ndikimi i mediave me objektivitetin e krijimit të agjendës politike për ardhmërinë euroatlantike të Maqedonisë mund të ndodhë me publikimin e informacione pa emocione, me një gazetari hulumtuese, me informim konkret se çka humbet nga identiteti maqedonas, për shembull nëse Maqedonia do të quhej "Maqedonia Veriore". Mënyra ndikuese e të shprehurit objektiv gazetaresk do të krijonte edhe besueshmëri në krijimin e





opinionit publik, dhe do të demaskonte apo ndoshta edhe t'i vërtetonte qëllimet e VMRO –DPMNE-së dhe përkrahësit e tyre, për arsyet ose mos arsyet për zvarritjen e bisedimeve në lidhje me emrin, që tani për tani është një ndër kushtet kryesore që Maqedonia të anëtarësohet në BE dhe NATO. Vazhdon te krijohet një demagogji informuese, mungon kodi etik i informimit të drejtë, kur nuk sqarohet fakti se pa ndryshimin e emrit të Maqedonisë, shteti nuk do jetë pjesë e NATO-s dhe e BE-së.

Në zgjedhjet presidenciale dhe në zgjedhjet lokale të 22 marsit dhe 5 prillit 2009, megjithatë, sikur ndodhi një kombinim i paarsyeshëm në promovimin apo në shpalosjen e platformave zgjedhore të partive politike, të cilat ishin më ndikuese. I gjithë interesimi ishte i koncentruar në kandidatët për kryetar shteti. Për faktin se mediat nuk arritën t'i vinin në sfidë platformat zgjedhore për sqarimin e problemit të korrupsionit, për ashpërsinë e problemit që ka të bëjë me krimin e organizuar, për ngarkesën psikike të problemit - marrëdhëniet me Greqinë dhe perspektivën euroatlantike të Maqedonisë, rëndësinë nacionale të problemit - zbutjen e varfërisë, pse akoma ka probleme me zbatimin e ligjeve që kanë buruar nga marrëveshja kornizë e Ohrit etj, platformat zgjedhore presidenciale ishin shumë të vobekta. Mund të konkludohet se kishte edhe deficit medial, për të krijuar kode etike publike mediale (edhe pse zakonisht kodeve iu mungojnë sanksionet konkrete) të përgjegjësisë, për ato parti politike që me platformat e tyre zgjedhore paraqiten me premtime të rrejshme. Në këto zgjedhje mund të hetohej edhe një paradoks, pasi kishte raste që për kompetencat e kryetarit të shtetit, në disa mediume, të flitnin edhe bartësit e listave për këshilltar komune.

Shqiptarët në këto zgjedhje krijuan një kolorit partiak më të begatshëm

Ndoshta edhe pa të drejtë i vihet si barrë medieve që të luajnë rolin e funksionit kontrollues të pozitës, por duhet të kemi parasysh faktin se në mungesë të kulturës politike, opozita nuk mund t'i shfrytëzojë të drejtat përkatëse parlamentare. Thuajse në të gjitha shtetet ballkanike, partitë pozitare, tentojnë ta mbështesin opozitën për muri, duke i krijuar hile me rregullore administrative, duke i lënë hapësirë të pamjaftueshme veprimi të ushtrimit të kontrollit dhe presionit politik. Është një fakt i pamohueshëm se fuqia e dobët politike e partive opozitare, vetvetiu nënkupton edhe ligështinë e partisë pozitare.

Megjithatë, do të kisha veçuar faktin se në këto zgjedhje mund të veçohet diçka e veçantë në elektoratin shqiptar. U krijua një ambient tjetër në kultivimin e vlerave të demokracisë, kur ishte fjala për kandidatin për kryetar shteti, z. Imer Selmanin. Ai i mori edhe votat e anëtarëve të partive kundërshtare. Dallimi me mbi 70 mijë vota nga pasuesi i tij z. Agron Buxhaku, apo me mbi 100 mijë më shumë se zonja Mirushe Hoxha, kandidate e PDSH-së, flet për krijimin e një kulture të re politike brenda votuesve shqiptarë. Votimi selektiv, të votuarit për personin për garë presidenciale dukee margjinalizuar partinë, këtë me siguri duhej ta vërenin mediumet, që të promovonin si diçka specifike, që ka kuptimin e avancimit të prononcimit të lirë të qytetarëve, duke iu shmangur diktateve partiake. Në këto zgjedhje ndodhi edhe një sihariq demokratik. Përkundër maqedonasve (që ia dhanë pushtetin absolut VMRO – DPMNE-së), shqiptarët në këto zgjedhje krijuan një kolorit partiak më të begatshëm me kryetarë dhe këshilltarë komunash. Me siguri mbetet që t'i sendërtojnë projektet e premtimeve të tyre parazgjedhore, për të krijuar autoritet dhe fuqi politike konkurruese.

Kaptinë e veçantë e këtyre zgjedhjeve ishte marrëveshja votuese e partnerëve të koalicionit qeveritar VMRO –DPMNE dhe BDI, për përkrahjen e kandidatëve të tyre në disa komuna, që ishte edhe porosia më e zymtë zgjedhore partiake. Sipas kësaj marrëveshjeje, BDI kërkoi përkrahjen e VMRO – DPMNE-së apo të votuesve maqedonas për të fituar z. Rufi Osmani në Gostivar dhe z. Sadi Bexheti në Tetovë, për kundërvlerë BDI t'i thërriste votuesit shqiptarë për të votuar kandidatin për president shteti, z. Gjorgji Ivanov-in (pa kurrfarë oferte konkrete për shqiptarët). Kjo marrëveshje e një koncepti komunist (hasi në veshë të shurdhët për votuesit shqiptar), mbeti e pa dekodifikuar nga mediat – mbeti heshtje qyqare mediale.

Ndoshta qeveria e Maqedonisë do të pranojë lëvdata për organizimin e zgjedhjeve presidenciale dhe zgjedhjeve lokale, por me siguri hendikepet për zhvillimet e mëtutjeshme politike dhe ekonomike do të mbeten nëse kryeministri z. Nikolla Gruevski vazhdon projektin e rrugëtimit populist – nacionalist që krijoi një demokraci pa konkurrencë brenda maqedonase. Për fund, vlen të shënohet fakti se mandatin presidencial, në ditën e parë pas shpalljes të rezultateve të votimeve presidenciale, z. Gjorgji Ivanov e filloi me përkulje ceremoniale në Kishën Ortodokse në Shkup dhe me urimin e Presidentit të Federatës Ruse z. Medvedev. Megjithatë ekzistojnë vlerësime shumë bindëse: përkundër këtyre ceremonive të VMRO – DPMNE-së, nuk zbehet aspak pamja gjigante e Ambasadës së SHBA-së në Shkup, si logjistikë diplomatike dhe e sigurisë regjionale dhe e Bondstilit në Kosovë. ■

Në 20 vjetorin e rënies heroike të Ismet Krasniqit

Demonstratat e vitit 1989 i paraprinë kryengritjes së UÇK-së

Në vendin e rënies së Ismetit, pikërisht te Xhamia e Llapit në Prishtinë, u zbulua pllaka përkujtimore e këtij dëshmori, si dhe u mbajt një akademi përkujtimore



Mevlude ZEJNULLAHU

Njëra ndër karakteristikat kryesore që i identifikon popujt e mbarë botës pa dyshim që është historia. Çdo etapë e historisë se popullit shqiptar ka shënuar mbi fletët e saj emra të mëdhenj trimash, të cilët i kanë dalë zot tokës së tyre. Pas shumë shekujsh sakrifice, të cilat historia i ruan me xhelozi, arritëm të jemi të lirë dhe t`i identifikohemi botës si shtetas të një vendi të pavarur.

Mëngjesi i ditës së 27 marsit të vitit 2009 nuk agoi i njëjtë për familjen Krasniqi, por i ktheu ata 20 vite prapa. Të heshtur të gjithë rrinin në mendime dhe shikimi i tyre hidhej nga muri, ku përveç fotografive të dëshmorit të kombit Ismet Krasniqi nuk shihej asgjë tjetër. Bashkëshortja e Ismetit, së bashku me dy djemtë e saj e po ashtu në praninë e familjarëve të tjerë e të shoqëruar nga shumë shokë, miq e qytetarë të ardhur nga shumë vende të Kosovës u nisën për në vendin e rënies së tij, pikërisht te Xhamia e Llapit në Prishtinë, ku u zbulua pllaka përkujtimore e këtij dëshmori.

Akademia përkujtimore në lokalet e shkollës fillore "Asim Vokshi", u hap pas këndimit të himnit kombëtar, duke u pasuar pastaj me një minutë heshtje për të gjithë dëshmorët e kombit.

"Përpara shokë deri në fitore!"

Për të nderuar dëshmorët, në akademinë e organizuar kishin ardhur Adem Demaçi, lideri i Lëvizjes 'Vetëvendosja' Albin Kurti, familjarë të dëshmorëve, luftëtarë dhe veteranë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Një kumtesë për dëshmorin e kombit Ismet Krasniqin, e mbajti veterani i UÇK-së Fazli Maloku, i cili përshkroi në detaje aktivitetin dhe veprimtarinë patriotike të këtij dëshmori për të cilin tha se ishte i organizuar dhe në shërbim të ribashkimit kombëtar qysh në fund të viteve '70-ta: "Kur më 27 mars 1989, Kosovës iu zu fryma nga dhuna, gjenocidi, populli i saj vendosi ta sfidonte armikun me demonstrata, duke treguar kështu hapur pakënaqësinë që pushtuesi serb po ushtronte mbi popullin tonë. Në krye të këtyre demonstratave ishte edhe Ismeti. Ai i printe masës së popullit, bashkë edhe me shumë shokë të tjerë, ndërsa përpara iu dilnin kordonë të tërë policësh, të tronditur nga vendosmëria e demonstruesve. Tymi lotsjellës dhe plumbat i kishin lodhur demonstruesit, por ata nuk u dorëzuan. Tërë Kosovës iu zu fryma nga tymi lotsjellës. Prishtina ishte mbushur me tym. Krismat shqyenin qiellin, tytat mbillnin vdekje, ndërsa rrugët u skuqën nga gjaku i rinisë shqiptare. Aty ishte Shukrije Obertinca, Sedat Xhafolli, Vetim Shala, Mustaf Veseli dhe shumë të tjerë. Që të gjithë krah për krah. Që të gjithë përkrah Ismetit. Kudo njerëzit ishin rreshtuar përkrah njëri-tjetrit dhe marshonin. Që të gjithë kërkonin liri për popullin shqiptar. Të tilla demonstrata kishte edhe në Pejë, në Gjakovë, në Prizren, Ferizaj, Podujevë, Deçan, Mitrovicë. Rrugët e tërë Kosovës laheshin me gjak. Një armatë e tërë përballë një populli duarthatë. Në Prishtinë, Ismeti qëndroi përballë policëve të armatosur deri në fyt dhe duke e ngritur grushtin iu bëri thirrje shokëve me zë të fortë: "Përpara shokë deri në fitore!" - dhe e hodhi hapin, mirëpo u ndalua. Nuk eci më tutje sepse ra i korrur nga plumbat e pushtuesit serb".



Pra, kështu Ismet Krasniqi ka rënë për liri për të mos vdekur kurrë dhe si i tillë do të kujtohet çdo herë dhe gjithmonë do të ketë vend të rëndësishëm në armatën e të rënëve për lirinë e Kosovës.

Në vazhdimin e akademisë për dëshmorin e kombit, Ismet Krasniqin, folën edhe Adem Demaçi dhe Albin Kurti, të cilët theksuan se këto demonstrata ishin vazhdimësi e përpjekjeve dhe e kryengritjeve të pandërprera të popullit tonë për liri, pavarësi dhe ribashkim kombëtar. Ata, po ashtu, theksuan se demonstratat e vitit 1989 ishin ndër më të përgjakshmet në Kosovë dhe se ato i paraprinë kryengritjes së madhe të armatosur që shpërtheu me luftën çlirimtare të UÇK-së, të udhëhequr nga kryekomandanti legjendar Adem Jashari.

Pas mbarimit të akademisë përkujtimore, familjarët e dëshmorit Ismet Krasniqi, përshëndetën dhe falënderuan të gjithë pjesëmarrësit dhe u kthyen në shtëpi me një krenari të madhe, por me halle të përditshmërisë: si të sigurojnë ekzistencën për jetë, si të ballafaqohen me vështirësitë ekonomike e sociale. Ata ende i mban shpresa se në të ardhmen amaneti i dëshmorëve të rënë do të realizohet plotësisht.

Duke mos harruar që falë gjakut të dëshmorëve të kombit ne jetojmë dhe gëzojmë këto ditë, shpresojmë se në të ardhmen do të punohet më shumë që amaneti i tyre të shkojë në vend. ■

Në dhjetëvjetorin e eksodit shqiptar

Treni famëkeq që na përkuj



Ekrem AVDULLAHU

1 PRILL 1999

Ishte ditë e enjte. Dielli kishte zbuluar fytyrën e tij dhe rrezet e atij mëngjesi prilli e kishin ngrohur paksa motin në krahasim me ditët e mëparshme. Karvanët e njerëzve nga të gjitha lagjet e Prishtinës dhe jashtë saj, vërshonin si lumenj drejt qendrës, caku i të cilëve ishte stacioni i trenit. Ecnin të qetë, të lodhur, të rraskapitur, pa zhurmë, me panik dhe të shqetësuar. Kjo pamje i ngjante një ceremonie mortore. Në fytyrat e tyre vërehej hutimi, frika, tmerri dhe dhimbja shpirtërore. Këta lumenj njerëzish të përvuajtur, të dëbuar nga shtëpitë e tyre me dhunë, të rrahur e të plaçkitur ecnin në rrugët e Prishtinës me gjithë ato gjësende dhe rroba që kishin mundur t'i merrnin dhe t'i bartnin në krahët e tyre. Disa bartnin në shpinë pleq dhe të sëmurë që nuk mund të lëviznin. Disa i bartnin me batanije, e disa me karroca.

Anash qëndronin forcat policore dhe ushtarake serbe, në mënyrë që të "kujdeseshin" që njerëzit të mos dilnin nga kolona. Kjo pamje të kujtonte holokaustin e shekullit të kaluar.

Qyteti i Prishtinës i ngjante një gërmadhe fantazmash. Dyqanet e shqiptarëve ishin thyer e plaçkitur, disa, madje, vazhdonin të plaçkiteshin nga serbët dhe romët edhe në kohën kur ne po ecnim nëpër rrugët e qytetit. Na shikonin me ironi dhe plot urrejtje, gjë të cilën e bënim edhe ne, por pa u vërejtur. Policët që qëndronin anash kolonës, aty-këtu ndalnin ndonjë të ri që u binte në sy, kurse ne ecnim të heshtur pa ditur se ç'fat do të përjetonin ata, e ç'fat do të na priste ne...

Unë me disa studentë të tjerë ecnim në mesin e asaj turme dhe përpiqeshim të mos u binim në sy paramilitarëve serbë. Disa nga ne merrnin në duar fëmijë të dikujt afër, për të krijuar kështu imazhin e një prindi, meqë prindërit që ishin me gra e fëmijë, ishin paksa më të kursyer nga egërsia serbe.

Pas nja gjysmë ore rrugë, arritëm te stacioni i trenit. Jo se donim të shkonim atje, por për aty edhe ishin krijuar korridoret dhe s'kishim nga t'ia mbanim tjetërkah. Kishte ca vende ku edhe mund t'i shmangeshe kolonës, por pasojat mund të ishin vdekjeprurëse. Të gjithë ne që ishim në kolonë ndiqnim "këshillat" e paramilitarëve dhe ecnim pa kundërshtuar.

Kur arritëm te stacioni, pamë shumë njerëz që ishin grumbulluar aty. Disa, madje, e kishin kaluar aty natën duke pritur trenin. Thuhej se treni qarkullonte vetëm dy herë në ditë. Një grua shtatzënë kishte lindur atë natë aty. Dy policë serbë, me uniforma të thjeshta që dukeshin më pak të frikshme, qëndronin aty në mes turmës së njerëzve dhe 'mbanin' rendin. Flisnin me shqiptarët dhe gjoja ndanin dhembjen e gjithë atij tmerri me ta. Por, ç'e do, ata ishin policë serbë dhe se për ne ajo sjellje e butë nuk do të thoshte asgjë. Ne ishim shqiptarë dhe për ta ishim pre...



Disa fëmijë që, pa dashje, ishin ndarë nga prindërit e tyre, qanin pa ndërprerje dhe kërkonin prindërit. Disa ishin vetëm me nënat e tyre, ashtu siç kishin ardhur nga zonat rurale, ku kishte luftime dhe ishin strehuar në Prishtinë. Ata vuanin më tepër sepse, mbase nuk kishin një prijës, ishin më të hutuar dhe ndiheshin më të pambrojtur. Askush nuk dinte se sa do të qëndronim aty dhe se ku do të na çonin. Në mes të asaj turme njerëzish të panumërt shpërndaheshin fjalët se do të na çonin drejt kufirit me Maqedoninë dhe Shqipërinë.

Ora shënonte aty rreth 11 dhe moti filloi të ngrohej edhe më. Disa që e kishin kaluar natën zgjuar dhe të rraskapitur aty, iu shmangën paksa turmës dhe flinin në lëndinat pranë hekurudhës, duke iu ekspozuar rrezeve të diellit.

Nuk kaloi shumë kohë dhe u dëgjua sirena, e më pas edhe zhurma e trenit. Të gjithë njerëzit, që thuajse deri në atë kohë ishin në një letargji të thellë, u ngritën dhe iu afruan vendit ku pritej të ndalonte treni. Filloi të krijohej një pështjellim, zhurmë, zëra që thërrisnin njëri-tjetrin, lëvizje të shpeshta dhe të pakontrolluara. Secili kërkonte të vetët. Disa fëmijë që nuk i gjenin të afërmit, qanin, lemeriseshin. Disa njerëz të tjerë që ishin pranë tyre, mundoheshin t'i qetësonin dhe t'i bindnin se do t'i gjenin.

Kështu, aty u krijua një dramë e vërtetë, një tmerr që nuk e kisha parë e as lexuar në ndonjë libër.

Një popull i tërë po dëbohej, po zhdukej, po asgjësohej!!!

Nuk vonoi shumë dhe, pas asaj sirene dhe zhurme, u duk edhe treni. Pamja e zezë e trenit ngjallte vetëm zi. Të gjithë vraponin drejt tij. Disa madje iu varën dhe hipën në të ende pa u ndalur mirë. Të gjithë vraponin për të hipur dhe askush s'donte të ishte i fundit. Njerëzit filluan të shtyheshin dhe të hynin me dhunë. Ishte e qartë se treni nuk do t'i zinte të gjithë, andaj askush nuk donte që

...tonte holokaustin

ta kalonte natën në stacion – i druheshin ndonjë masakre, siç kishte ndodhur në pjesë tjera të Kosovës.

Disa që nuk arrinin t'i afroheshin dyerve hyrëse, filluan të ngjiteshin dhe të hynin nëpër dritare. O Zot! Ç'tragjedi?!

Ne studentët, që ishim të vetëm, pa familje, e kishim më të lehtë të përbiroheshim dhe të hynim në tren.

Kur hyra në tren, pash një dramë tjetër... njerëzit shtyheshin, fjaloseshin, ofendonin, madje edhe sulmonin njëri-tjetrin, për vetëm një qëllim – që të siguronin një vend në tren. Pas nja 1 ore treni u stërmbush dhe nuk zinte më. Disa, madje, qëndronin edhe në shkallët e trenit jashtë të varur pas njëri-tjetrit.

Treni u nis bashkë me zhurmën dhe sirenën e tij histerike dhe pjesa tjetër e njerëzve mbeti në stacion, për të pritur trenin e radhës. Drama e vërtetë e trenit famëkeq nuk mbaroi me kaq. Ajo tani po trokiste...

* * *

Unë dhe disa studentë të tjerë që vendosëm të mos ndaheshim gjatë rrugëtimit tonë, e që mezi u futëm në tren, qëndronim në këmbë në korridor. Disa që kishin arritur të futeshin më herët nga dritaret, i kishin zënë dhomat dhe qëndronin në hyrje të tyre duke mos lënë askënd të futej në to. Dikush qëndronte ulur, dikush në këmbë, e njëri madje kishte hipur lart në vendin e bagazheve. Me një fjalë, çdo centimetër hapësirë ishte e mbushur me njerëz. Mezi merrnim frymë.

Disave që kishin fëmijë, gra e të sëmurë, disa shpirtmirë u jepnin përparësi dhe i fusnin në dhomat e trenit.

Unë isha pranë një dritareje dhe vështroja natyrën jashtë, vështroja se si po largohesha nga Prishtina, se si po largohesha nga Kosova. Në kokë më silleshin lloj-lloj mendimesh e trillimesh. Kujtoja familjen, kujtoja të afërmit, për të cilët nuk dija se ku janë dhe nëse ishin gjallë apo jo, kujtoja të dashurën, me të cilën ishim fejuar dy javë më parë, e që nuk arrita ta kem pranë ato ditë të vështira. Po ikja nga Kosova i vetëm me të vetmen pasuri - rrobat në trup, dhe me të vetmen dëshirë e shpresë – që të kthehesha përsëri në Kosovë.

Nganjëherë në kokë më silleshin kujtime të tjera optimiste. Në çastet më të këqija të jetës, kujtoja gjërat më të bukura. Vetëm ashtu mund t'i shmangesha një kapitullimi mendor.

Rrugës për në Fushë Kosovë, e që nuk zgjati më shumë se 20 minuta, pranë hekurudhës pash një njeri të vrarë e të djegur. Në krah kishte një pushkë. Sigurisht atë trup e kishin lënë serbët pranë hekurudhës, me qëllim që të ngjallnin tmerrin ndër shqiptarët.

Arritëm në stacionin hekurudhor në Fushë Kosovë. Edhe aty kishte njerëz duke pritur për të ikur nga Kosova. Çdo pëllëmbë aty ishte e militarizuar. Kishte policë, ushtarë, paramilitarë e civilë serbë të armatosur. Lart mbi disa anekse të kulmeve ishin pozicionuar snajperët, që si objektiv të tyre kishin çdo lëvizje të dyshimtë. Koha sa vinte e nxehej dhe ne që ishim në tren sa vinim e ngulfateshim nga ajri i tendosur dhe i nxehtë aty brenda. Disa policë dhanë urdhër që askush të mos dilte nga treni. Ndenjëm ashtu për nja gjysmë ore dhe mezi prisnim të nisej treni. Durimi i njerëzve brenda kishte arritur në kulm dhe njerëzit filluan të ndiheshin sa të frikësuar, aq edhe dobësuar nga temperaturat e larta. Pas pak minutash u dha urdhër që të gjithë që ishim në atë vagon, të dilnim jashtë, ngase sipas kujdestarëve të hekurudhave (ata të gjithë ishin serbë) ai vagon kishte një defekt dhe se nuk mund të vazhdonte udhëtimi.

Për një çast të gjithë u stepëm dhe askush nuk fliste asgjë. Menduam se ky është një inskenim dhe se, sapo të shkonte treni me vagonët tjerë, mbi ne do të bëhej masakër. Në mesin e njerëzve filluan pëshpërimat se vdekjen tashmë e kishim të sigurt. Ishte një skenar i përgatitur. Dolëm të gjithë nga treni si me përtesë dhe qëndronim aty mbi plate. Derisa kujdestarët e hekurudhave bënë zëvendësimin e vagonit, ne, me frikë deri në palcë, merrnim



frymë më lirshëm sesa ata që mbetën brenda në vagonët e tjerë. Gra e burra familjarë përpiqeshin që ne të rinjve të na fusnin brenda turmës, në mënyrë që të mos vëreheshim e të mos u binim në sy paramilitarëve serbë. Ata (serbët) qëndronin shumë pranë turmës, por nuk merrnin ndonjë hap radikal e as ndonjë sulm mbi popullatën. Si duket, kënaqeshin me pamjet tona trishtuese dhe se ikja jonë nga Kosova u mjaftonte atyre që të ndiheshin mirë dhe të ngopur.

Dikush në turmë tha se brenda në stacion po punonte një market, porse askush nga ne nuk mund të merrte guxim dhe të shkonte atje për të blerë diçka. Nuk dinim se ç'na priste brenda. Mirëpo, më vonë pamë disa gra që dilnin me gjësende të blera dhe vinin drejt turmës.

Unë, pa i llogaritur pasojat, vendosa të shkoj. I grumbullova disa dinarë nga të gjithë shokët dhe u nisa me një grua drejt marketit. Aty brenda punonin disa punëtore dhe kur arritëm ne, thuajse i tërë marketi ishte boshatisur nga blerësit. Arrita të blej disa jogurtë dhe asgjë më shumë. Mjaftuan që ta shuanim etjen. Dikush më shumë e dikush më pak, u këndellëm paksa.

Aty qëndruam nja 2 orë. Punët në zëvendësimin e vagonit zvarriteshin me qëllim. Pas zëvendësimit na dhanë urdhër që të hipnim në vagon, i cili nuk ishte si ai i pari me dhoma, por vagon shinobusi. Njerëzit filluan të hipnin po me atë nxitim që kishin hipur dy orë më parë në Prishtinë. Ishte vërtet një tmerr.

Treni u nis, ndërsa civilët serbë na "përshëndesnin" me dorë duke na "uruar" udhëtim të mbarë. Në tren bëhej gjithnjë e më vapë dhe filloi të na zihej fryma. Një gruaje shtatzënë, nga asfiksia, i ra të fikët, derisa të tjerët përpiqeshin me një shishe ujë t'ia kthenin vetëdijen.

Për dallim nga vagoni i mëparshëm, ky kishte disa dritare të vogla dhe të ngushta lart për ajrosje, prandaj ndihej shumë mungesa e oksigjenit. Treni ecte shumë ngadalë dhe deri në kufi me Maqedoninë bëmë thuajse tri orë. Kur treni ndaloi në zonën neutrale, të gjithë zbritëm ngadalë dhe aty pashë se gjatë rrugës kishin vdekur shumë pleq e të sëmurë që gjendeshin në vagonët e tjerë. Sigurisht nga vapa, ndrydhja dhe asfiksia. ■

A po ndryshon qëndri



Ajni SINANI

"Shtetet e Bashkuara dhe Evropa duhet t'i qasen muslimanëve si miq, fqinj dhe partnerë në luftën kundër padrejtësive, intolerancës e dhunës, duke ndërtuar marrëdhënie të bazuara në respektin dhe interesat e ndërsjella. Çuarja përpara e anëtarësimit të Turqisë në BE do të ishte një sinjal i rëndësishëm për angazhimin tuaj dhe do të siguronim se Turqia është plotësisht e lidhur me Evropën". Përmes këtyre fjalëve që presidenti amerikan Barack Obama tha gjatë samitit SHBA-BE, në Pragë, ai mbështeti anëtarësimin e Turqisë në BE dhe shprehu vizionin e tij se si duhet të ndërtohen raportet mes botës islame dhe asaj perëndimore. Parisi e Berlini janë shprehur kundër qëndrimit të Obamas rreth Turqisë. Presidenti i Francës Nicolas Sarkozy ka thënë se shtetet e BE-së janë ato që duhet të vendosin se cilat vende duhet të pranohen e cilat jo në BE. Ai është shprehur se gjithnjë ka qenë dhe është kundër hyrjes së Turqisë në BE. Turqia është vend i madh - ka thënë ai - aleat i Evropës dhe SHBA-së, por ajo duhet të mbetet vetëm një partner i privilegjuar. Gjermania dhe Franca i kanë ofruar Turqisë privilegje të caktuara, në këmbim të heqjes dorë nga ana e saj për anëtarësimin në BE, gjë që është refuzuar nga pala turke.

Turqia disa herë ka tërhequr vërejtjen se nëse BE nuk e pranon atë për shkak të të qenit të saj shtet musliman atëherë BE-ja mund të shndërrohej në një klub shtetesh të krishtera, gjë të cilën evropianët e kanë mohuar disa herë dhe që bie ndesh me vetë frymën e BE-së. Ndryshimi fetar mes Turqisë dhe vendeve evropiane nuk duhet të shkojë deri aty sa të bëhet pengesë për anëtarësimin e saj. Sepse edhe pse brenda BE-së ka diversitet fetar, gjuhësor dhe kulturor, ai ia ka dalë të formojë një shoqëri kompakte, sikurse është shprehur më herët ministri i jashtëm i Turqisë, Ali Babaxhan.

Prandaj, anëtarësimi i Turqisë në BE nuk do ta rrezikonte Unionin Evropian, përkundrazi do ta begatonte dhe do t'i mundësonte atij që të ishte përfaqësues i vërtetë në arenën ndërkombëtare. Me këtë Turqia do të shndërrohej në një urë lidhëse mes perëndimit dhe botës islame. Refuzimin e anëtarësimit të Turqisë nga disa vendeve evropiane, analistët turq dhe arabë e interpretojnë si një racizëm kulturor dhe jogatishmëri të një pjese të evropianëve për të pasur në gjirin e saj një shtet të madh me popullsi muslimane.

Kjo vlerësohet se do të ishte kundër idealeve të Mustafa Qemalit, themeluesit të Turqisë moderne, i cili u mundua të formonte një shtet alla evropiançe, që do ta kishte vendin e tij në Evropë. Në anën tjetër, është i madh numri i muslimanëve në botën arabe dhe më gjerë që kërkojnë që Turqia t'i kthehet botës

mi i Amerikës ndaj botës islame?

islame. Nëse Turqia do të hynte në BE do të ishte nga shtetet më të fuqishme të saj, por edhe nëse i kthehet botës islame ajo do të ishte lider i saj.

Në rastin e parë do të normalizoheshin raportet mes muslimanëve dhe të krishterëve dhe muslimanët në Evropë do të ndiheshin më komod. Kurse në rastin e dytë Evropa do të shihej si një si bllok i shteteve të krishtera dhe përball saj do të formohej blloku i shteteve muslimane që do të çonte në ndarjen e botës sipas linjave fetare.

Turqia një aleat kyç

Presidenti Barack Obama, pas arritjes së tij të parë në një vend me shumicë muslimane, ka deklaruar në parlamentin e Turqisë se Shtetet e Bashkuara nuk ka qenë dhe nuk janë në luftë me Islamin dhe se partneriteti i Amerikës me botën islame është i domosdoshëm në luftën kundër terrorizmit: "Shtetet e Bashkuara nuk janë dhe nuk do të jenë kurrë në luftë me fenë islame. Në fakt, partneriteti ynë me botën muslimane është kritik, jo vetëm për t'iu kundërvënë ideologjive që mbjellin dhunë dhe që kundërshtohen nga njerëzit e të gjitha besimeve fetare, por gjithashtu për të shtuar shanset për të gjithë."

Ai, gjithashtu, ka thënë se Amerika dëshiron një angazhim më të gjerë me muslimanët, duke u mbështetur në interesat dhe respektin e përbashkët. Presidenti Obama më herët kishte lavdëruar Turqinë si një aleat kyç dhe si pjesë e rëndësishme e Evropës. Këtë vizion ai e konfirmoi pas arritjes së tij në Turqi, duke bërë thirrje për të ndihmuar në ngritjen e urave mes botës muslimane dhe asaj perëndimore: "Ky është një vend që, siç është thënë shpesh, ndodhet në kryqëzimin mes Lindjes dhe Perëndimit. Është një vend që mbart një trashëgimi jashtëzakonisht të pasur, por që gjithashtu përfaqëson një përzierje traditash të lashta me një shtet që respekton demokracinë dhe sundimin e ligjit dhe përpiqet për një ekonomi moderne. Është një anëtar i NATO-s dhe gjithashtu është një vend me shumicë muslimane dhe, si rezultat, ka njohuri për të gjitha sfidat strategjike rajonale me të cilat përballemi."

Pas takimit me homologun turk, Abdullah Gul, Obama theksoi rëndësinë strategjike të Turqisë jo vetëm për SHBA-në, por për tërë botën: "Është ky një vend, që shpesh ka shërbyer si urë në rrugët midis Lindjes dhe Perëndimit. Një vend me vlera të jashtëzakonshme kulturore. Një vend, që përfaqëson traditë të shkëlqyeshme të shtetit modern, që respekton demokracinë, sundimin e ligjit dhe që synon përparimin modern ekonomik."

Në ditën e dytë dhe të fundit të vizitës së tij në Turqi, gjatë një fjalimi përpara studentëve në Stamboll, Obama ka deklaruar angazhimin e tij për një kapitull të ri në marrëdhëniet mes SHBA-ve dhe botës muslimane. Ai ka thënë se zgjedhja e tij e ka rritur besimin e amerikanëve se ndryshimet janë të mundshme dhe se kjo është një mundësi e re për të përmirësuar imazhin e SHBA-ve në botë. "Mendoj se njerëzit, ka thënë ai, u nxitën të zgjidhnin dikë si unë, që ka jetuar një pjesë të kohës përtej oqeanit, që ka muslimanë në familjen e tij, pasi besojnë se mund të ndërtoj ura me pjesët e tjera të botës."

Obama është takuar me liderë fetarë dhe bashkë me kryeministrin turk, Rexhep Taip Erdogan, kanë vizituar Xhaminë Aja Sofia dhe Xhaminë e Kaltër. Në Xhaminë e Kaltër, myftiu i Stambollit, duke i folur për xhaminë, i kishte treguar emrat e katër halifëve që janë të varur në muret e saj. Kur i kishte përmendur emrin e h. Husejnit, nipit të Muhammedit a.s., ai kishte buzëqeshur.

Imazhi i Amerikës është dëmtuar në sytë e muslimanëve për shkak të politikës agresive të neokonservatorëve ndaj Irakut dhe Afganistanit. Ndërrimi i politikës amerikane ndaj botës islame, përveç fjalëve, ka nevojë edhe për vepra konkrete. Një tregues i fuqishëm në këtë drejtim do të ishte që SHBA-ja të tregohet e vendosur, sikurse shpreson bota islame, dhe të bëjë presion mbi Izraelin që ta pranojë shtetin e Palestinës në kufijtë para luftës së vitit 1967. ■



Reflektime ndërkombëtare për Kosovën

Ban Ki Moon: UNMIK-u tashmë shihet si një

Demir RESHITI

Republika e Palaut, që shtrihet në pjesën perëndimore të Oqeanit Paqësor, është vendi i 56-të që njeh pavarësinë e Kosovës. Gjatë muajit mars, Kosova ka qenë temë diskutimi edhe në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, i cili ka debatuar mbi raportin e rregullt tremujor të Sekretarit të Përgjithshëm Ban Ki Moon lidhur me zhvillimet në Kosovë. Ban Ki Moon, në raportin e tij, ka konstatuar se UNMIK-u, pas afro dhjetë vjetësh, tashmë shihet si një mision pengesë dhe i padëshirueshëm për shqiptarët dhe institucionet e pavarura të Kosovës. Në emër të institucioneve shtetërore të Kosovës ka folur ministri i Jashtëm, Skënder Hyseni, ndërsa në emër të UNMIK-ut, përfaqësuesi special, Lamberto Zannier. Një vlerësim të përbashkët për progresin e arritur në Kosovë kanë dhënë edhe Franca, Austria dhe Anglia. Raportin e progresit të Kosovës e kanë përkrahur edhe Kroacia, Uganda, Meksika dhe vende të tjera...

Në vazhdim po paraqesim një kronologji të ngjarjeve dhe deklaratave më të rëndësishme lidhur me Kosovën, gjatë muajit mars 2009.

(1 mars) Një shesh në Stamboll pagëzohet me emrin e Adem Jasharit

Stamboll - Një shesh i komunës Bajram Pasha në Stamboll do të mbajë emrin e komandantit legjendar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) Adem Jashari. Në përurimin i këtij sheshi, që është bërë me një ceremoni solemne, ka marrë pjesë ministri i Punëve të Brendshme Zenun Pajaziti, si dhe zyrtarë të lartë të Stambollit.



Jamie Shea


(3 mars) Shea: NATO diskuton mundësinë e reduktimit të trupave në Kosovë

Bruksel - Shtete anëtare të NATO-s do nisin gjatë këtij viti debatin për mundësinë e zvogëlimit të dukshëm të trupave në Kosovë, ka paralajmëruar drejtori për politikë i NATO-s, Jamie Shea, në një seminar të mbajtur në Bruksel, ku ka thënë se NATO-ja ka nevojë për trupa shtesë në Afganistan dhe se në një moment duhet të diskutohet për tërheqjen e trupave nga Kosova.

(4 mars) Scheffer reagon ndaj spekulimeve për reduktimin e trupave të KFOR-it në Kosovë

Bruksel - "Dua të jem i qartë, ata që spekulojnë për reduktimet e mundshme të KFOR-it, përfshirë këtu edhe njerëzit me uniformë, nuk flasin në emër të NATO-s" - është shprehur Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jaap de Hoop Scheffer, në një komunikatë të posaçme për shtyp.


Beograd - Presidenti i UEFA-s, Michel Platini, gjatë vizitës që ka bërë në Beograd, ka përsëritur qëndrimin se Kosova mund të pranohet në UEFA pasi të bëhet anëtare e OKB-së.



Hilary Clinton

(7 mars) Clinton shpreh mbështetjen për Kosovën

Gjenevë - Sekretarja amerikane e shtetit, Hilary Clinton, ka zhvilluar në Gjenevë takimin e saj të parë me homologun rus Sergej Lavrov, me ç'rast të dyja palët kanë rikonfirmuar qëndrimet e njohura për Kosovën. Agjencitë njoftojnë se, pas takimit, Hilary Clinton në konferencë për media ka uruar përvjetorin e pavarësisë së Kosovës. Ndërkaq, Lavrov, sërish ka folur për "rrezikun" që vjen nga pavarësia e Kosovës.



Palau

(9 mars) Republika e Palaut njohu shtetin e Kosovës

Uashington – Presidenti i Republikës së Palaut, Johanson Toribiong, nëpërmjet një letre ka njoftuar Ambasadën e Republikës së Kosovës në Uashington se ky vend ka njohur Kosovën si shtet të pavarur dhe sovran. Republika e Palaut shtrihet në pjesën perëndimore të Oqeanit Paqësor, me kryeqytet Malekeok-un dhe është vendi i 56-të që njeh pavarësinë e Kosovës.

(10 mars) Biden: Në Kosovë ka ende punë për t'u bërë

Bruksel -Nënkryetari amerikan Joseph Biden ka tërhequr vërejtjen tek evropianët se Kosova është çështje e papërfunduar. "Ende ka punë për t'u bërë në Kosovë, sepse angazhimet nuk kanë përfunduar. Është para së gjithash përgjegjësi e Bashkimit Evropian dhe komunitetit evropian që të përmbushë premtimet që i kemi bërë së bashku" – ka thënë Biden.

(11 mars) Clinton inkurajon shtetet që ta njohin pavarësinë e Kosovës

Uashington - Sekretarja amerikane e Shtetit, Hilary Clinton , inkurajon shtetet që ende nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës që ta bëjnë këtë. Në një mesazh që i ka dërguar ministrit të Punëve të Jashtme të Maldiveve, Ahmed Shaheed, Clinton ka thënë se me këtë vendim, Maldivet i kanë kontribuar jo vetëm stabilitetit dhe të ardhmes së Kosovës, por edhe gjithë rajonit.

(17 mars) Bugajski: EULEX-i të marrë përgjegjësitë sipas planit Ahtisaari

Uashington – Drejtori i qendrës për studime strategjike e ndërkombëtare në

mision pengesë

Uashington, Janush Bugajski, në një intervistë për Radio Kosovën ka thënë se UNMIK-u duhet të largohet përfundimisht nga Kosova dhe EULEX-i duhet të marrë përgjegjësitë sipas planit Ahtisari.

(18 mars) Gjenerali Mc Coll rikonfirmon përkrahjen e NATO-s për FSK-në

Vushtrri – Zëvendëskomandanti i NATO-s për Evropë, Gjenerali Mc Coll, gjatë një vizite që ka bërë në Qendrën e Trajnimit të SHPK-së në Vushtrri, ka thënë se NATO-ja do t'i shtojë aktivitetet rreth sigurimit të fondeve shtesë për Fondin e Mirëbesimit të NATO-s për ngritjen e FSK-së.



Carme Chacon

(19 mars) Chacon: Spanja do t'i tërheqë ushtarët e vet nga përbërja e KFOR-it

Madrid – Ministrja e spanjolle e Mbrojtjes, Carme Chacon, ka komunikuar vendimin e qeverisë së saj për tërheqjen e 632 ushtarëve spanjollë nga KFOR-i. Ndaj këtij hapi të Spanjës ka reaguar Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jap de Hop Schefer, i cili është shprehur kundër reduktimit të trupave të KFOR-it në Kosovë.

Nju Jork - Në raportin e tij më të ri për zhvillimet në Kosovë, që përfshin periudhën nga nëntori i vjetëm deri në fillim të marsit të sivjetmë, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, Ban Ki Moon, thotë se "autoritetet e Kosovës kanë vazhduar të veprojnë mbi bazë të Kushtetutës së Kosovës" duke mos përfillur më tej pushtetin tashmë të tejkaluar të UNMIK-ut, i cili në Kosovën e pavarur, që e kanë njohur 56 shtete, është jorelevant.

(20 mars) Fried: Pavarësia e Kosovës është një fakt i kryer

Uashington - Zv/sekretari amerikan i shtetit për çështje evropiane, Daniel Fried, në një intervistë për agjencinë ruse Interfaks ka deklaruar se pavarësia e Kosovës është një fakt i kryer dhe i ka bërë thirrje Rusisë që bashkë me SHBA-të të ndihmojnë në forcimin e pushtetit demokratik që synojnë liderët e Kosovës. Fried ka theksuar se është për keqardhje që Rusia nuk e ka njohur pavarësinë e Kosovës.



OKB

(23 mars) KS i OKB debatoi mbi gjendjen e sigurisë në Kosovë

Nju Jork - Këshilli i Sigurimit i OKB-së ka debatuar në Nju Jork mbi raportin e rregullt tremujor të Sekretarit të Përgjithshëm Ban Ki Moon lidhur me zhvillimet në Kosovë. Ban Ki Moon në raportin e tij ka konstatuar se UNMIK-u, pas afro dhjetë vjetësh, tashmë shihet si një mision pengesë dhe i padëshirueshëm për shqiptarët dhe institucionet e pavarura të Kosovës.

Në emër të institucioneve shtetërore të Kosovës ka folur ministri i Jashtëm, Skënder Hyseni, ndërsa në emër të UNMIK-ut, përfaqësuesi special, Lamberto Zannier. Ministri Hyseni, duke përshkruar progresin e arritur në Kosovë, e ka akuzuar Serbinë për bashkëpunim me strukturat kriminale dhe ilegale në veri. Një vlerësim të përbashkët për progresin e arritur në Kosovë kanë dhënë edhe Franca, Austria dhe Anglia. Raportin e progresit të Kosovës e kanë përkrahur edhe Kroacia, Uganda, Meksika dhe vende të tjera.

(25 mars) Craddock: SHBA-të të përkushtuara në rirreshtimin e sigurisë në Kosovë

Uashington - Shtetet e Bashkuara janë të përkushtuara për konsolidimin e pavarësisë së Kosovës dhe do t'i vazhdojnë përpjekjet e tilla diplomatike dhe politike - ka thënë kryekomandanti i forcave të NATO-s për Evropë, gjenerali Ben Craddock, gjatë një debati para komitetit për forcat e armatosura në kongresin amerikan. Ai ka konstatuar se Kosova edhe më tej është burim paqëndrueshmërie në rajonin e gjerë të Ballkanit. "Pala amerikane është e përkushtuar në një afat të gjatë në ofrimin jo vetëm të ndihmës së sigurisë, por edhe të asaj konkrete në rirreshtimin e sektorit të sigurisë në Kosovë" – ka thënë Craddock, duke shtuar se komanda e forcave ta bashkuara amerikane dhe NATO do t'i vazhdojnë programet për integrimin euroatlantik të Ballkanit Perëndimor.



BE

(26 mars) Rehn: Kosova nuk do të mbetet "vrimë e zezë" në rajon dhe Evropë

Bruksel - Bashkimi Evropian do të gjejë mundësi praktike dhe pragmatike për të mos lejuar që Kosova të mbetet si një 'vrimë e zezë' në rajon dhe në Evropë – ka deklaruar në Bruksel Komisioneri për Zgjerim i BE-së, Olli Rehn.


(27 mars) Arabia Saudite njeh pasaportat e Republikës së Kosovës

Prishtinë - Oda Kosovaro-Arabe për Miqësi dhe Bashkëpunim Ekonomik ka njoftuar qytetarët e Republikës së Kosovës, të cilët dëshirojnë të udhëtojnë në Mbretërinë e Arabisë Saudite, se tani e tutje këtë mund ta bëjnë me pasaportat e Republikës së Kosovës.

(28 mars) Gjermania nuk ka në plan tërheqjen e trupave nga Kosova

Prizren - Gjermania nuk ka në plan tërheqjen e trupave të saj nga Kosova, për dallim nga Spanja e cila edhe zyrtarisht ka paralajmëruar tërheqjen graduale të ushtarëve të saj që shërbejnë në kuadër të KFOR-it në Kosovë. "Qeveria gjermane nuk do të ndërmarrë një hap të tillë" – ka thënë për RTK-në, Erhald Fyger – komandant i Task-forcës Shumëkombëshe të Jugut në Prizren. ■

Histori Islame (29)



Muhamed J. KAJOLLI

Omeri – prijës

"Ka pasur njerëz para jush të cilët frymëzoheshin pa qenë të dërguar nga Zoti. Nëse sot ka të tillë, ai do të ishte Omeri" – **Muhammedi s.a.v.s.**

Nuk ka dyshim se Ebu Bekri ishte personi më i përshtatshëm për të zëvendësuar të dërguarin e All-llahut të Lartëmadhëruar. Sikurse historianët, ashtu edhe analistët kanë vërejtur se qëndrimet e Ebu Bekrit dhe vendosmëria e tij iu mundësoi muslimanëve të ngadhënjejnë, si në fushën ushtarake ashtu edhe në lëmenjtë e tjerë. Ai jo se ishte njeri i veçantë, por ai ishte një besimtar i palëkundur që ndiqte strategjinë e Pejgamberit s.a.v.s. dhe çdo thënie të tij që e kishte dëgjuar vetë. Kur shfaqej ndonjë problem, ai do ta shqyrtonte me shokët e tij, por fjala përfundimtare për të ishte ajo që ishte praktikuar nga më i dashuri i tij. E veçanta e tij ishte se ai ishte një besimtar i palëkundur. Në një rast, Muhammedi s.a.v.s. e kishte krahasuar imanin e tij me imanin e të gjithë besimtarëve të pranishëm aty.

Në momentin kur ai u zgjodh kalif, thamë se fiset filluan të protestonin dhe të kundërshtonin parimet e Kur'anit, me fjalë të tjera u ngritën kundër shtetit të ri të sapoformuar. Për shkak se po fillonin trazira, ai u këshillua nga shokët e tij më të afërt që ta ndalonte ushtrinë e Usame bin Zejd-it, të caktuar nga Muhammedi s.a.v.s. dhe të jepte urdhër që ajo të mos shkonte në veri për t'u hakmarrë ndaj bizantinëve. Qëllimi tyre ishte që ajo ushtri të mbetej brenda territorit të shtetit të ri. Ata kishin nevojë imediate për atë ushtri, sepse prej saj varej shumë stabilizimi i vendit. Edhe pas shumë orvatjeve të tyre, ai këmbënguli që ajo ushtri të vazhdonte rrugëtimin e vet deri në destinacionin ku kishte kërkuar Muhammedi s.a.v.s. Ai iu thoshte: "kurrë nuk do ta thyeja urdhrin e Muhammedit s.a.v.s.", prandaj kot e keni që përpiqeni të më thyeni. Ushtria e Usames vazhdoi marshimin sipas urdhrave që kishte marrë nga Muhammedi s.a.v.s.

Ky vendim doli të ishte më i mençur, sepse paraqitja e ushtrisë së Usames në veri, sinjalizoi për stabilitet dhe qëndrueshmëri të shtetit të ri musliman në sytë e dy perandorive. Kjo tregoi gjithashtu se rreziku i shtetit nuk vinte nga brenda, edhe pse ai nuk i neglizhoi këshillat e shokëve të tij. Ai, siç theksuam më herët, kishte shpërndarë ushtrinë e tij të mbetur në disa sosh, për të shuar kryengritjet deri në stabilizimin e vendit.

Ebu Bekri r.a. ishte shumë i respektuar dhe fjala e tij dëgjohej shumë. Kur nuhati vdekjen e tij, filloi t'i pyeste shokët e tij se ç'mendim kishin për Omerin. Shumica ishin për vendimin e tij, por kishte prej tyre që thoshin se ai ishte shumë i ashpër dhe frikësoheshin për të ardhmen e shtetit. Të këtij mendimi, pos disa të tjerëve, ishin edhe Alia dhe Zubejri (All-llahu qoftë i kënaqur me ta), ndërsa përgjigja e tij ishte: "Vërtet, ai ishte ashpër në praninë e Muhammedit s.a.v.s. dhe timen, por, mendoj se kur të jetë në pozitë si vendimmarrës do t'i ndryshojë qëndrimet dhe do të zbutet". Historia e vërtetoi se edhe ky mendim i tij ishte i saktë në vlerësim.

Pas konsultimit të tij të gjatë prej pesëmbëdhjetë ditësh, ai thirri Osmanin r.a. dhe i tha shkruaj: Bismil-Lahir-Rahmanir-Rahim, Dekreti i Ebu Bekrit të birit të Kuhafes për muslimanët, dhe pastaj... në atë moment i ra të fikët. Ndërsa Osmani r.a. e vazhdoi shkrimin dhe e plotësoi mendimin e tij. Në atë moment Osmani kishte menduar se Ebu Bekri vdiq. Në vazhdim, Osmani r.a. shkruajti: "...dhe pastaj, unë e lë si zëvendësin tim për ju Omerin, birin e Khatabit. Nuk gjeta më të mirë midis jush." Pasi u zgjua nga alivanosja, kërkoi nga Osmani t'ia lexonte se ku kishte mbetur me shkrimin. Kur ai, ia lexoi të tërën, falënderoi All-llahun e Lartëmadhëruar për saktësisë dhe drejtësinë e Osmanit. (Taberiu: 3/266)

Namazin e xhenazes së Ebu Bekrit e fali Omeri r.a. Atë e varrosën pranë Muhammedit s.a.v.s., por më poshtë si radhitje. Koka e tij u vendos tek beli Muhammedit s.a.v.s. Varrimi ndodhi më 23. xhumadel ahir. 13 h. ose (14 gusht 634).

Dilema rreth emërtimit

Muslimanët po ndërtonin shtet, një shtet plotësisht të ndryshëm për nga struktura e shteteve mbretërore ose perandorake që ishin përreth tyre. Sa herë që përballeshin me një praktikë të re, ata duhej të konsultoheshin mes vete dhe të vendosnin më të mirën e mundshme për ta. Nuk ka dyshim se çdo diskutim e bazonin në Kur'an dhe në praktikën e Muhammedit s.a.v.s. Prandaj, kur Ebu Bekri r.a. u zgjodh si drejtues i muslimanëve, ai u quajt Kalifi i Pejgamberit – pra, trashëgimtari ose zëvendësi i Muhammedit s.a.v.s. Pas vdekjes së Ebu Bekrit, u diskutua se si do ta quanin Omerin r.a. Për muslimanët kjo ishte një gjë e re. "Ta thërrasim kalifi i kalifit të Muhammedit s.a.v.s." - propozoi njëri prej të pranishmëve. Jo! - i thanë, sepse si do të thërritej i treti dhe i katërti e kështu me radhë...Atëherë, të gjithë të pranishmit u pajtuan me mendimin e ri të propozuar nga njëri prej tyre: "Ne jemi besimtarë, ndërsa Omeri është prijësi i besimtarëve, prandaj le ta quajmë -Emirul Muëminin, prijësi i besimtarëve."

Disa prej cilësive të Omerit r.a.

Hasani r.a. citon fjalët e Omerit r.a. në fjalimin e tij të parë si kalif i muslimanëve: Unë jam vënë në sprovë me ju, siç jeni vënë edhe ju në sprovë me mua. Jam caktuar t'iu drejtoj pas shokut tim. Kështu, kushdo që do të jetë i pranishëm, ne do t'i bëjmë ballë vetë, e nëse mungon, do ta lëmë në dorë të të fortëve e të besueshmëve. Kushdo që sillet mirë do t'ia shtojmë të mirat, e kushdo që të sillet keq, do ta ndëshkojmë. All-llahu i Lartëmadhëruar na faltë"...Ndërsa Sheddadi shtoi: Omeri tha edhe këtë: "O All-llah, unë jam i vrazhdë ndaj më zbut, jam i dobët ndaj më forco, jam dorështrënguar ndaj më bëj dorëlirë".

Omeri konsultohej dhe këshillohej shumë me shokët e tij më besnikë, si: Osmanin, Alinë, Ubejd bin Xherrahun,

si besimtarëve

Zubejrin etj... (Zoti qoftë i kënaqur me ta). Ai i pranonte gabimet e tij, kur përballej me argumente të fuqishme. Ishte shumë i vendosur që administratorët e shtetit të paraqiteshin sa më modestë dhe të ishin sa më afër popullit. Nuk lejonte në asnjë mënyrë që dikush nga administratorët e tij të shfrytëzonte paratë e shtetit për mirëqenien e tij personale. Tregohen shumë raste shkarkimi. Ai do ta shkarkonte nga posti çdo administrator që abuzonte vetëm pak me pushtetin e tij.

Ishte shumë i ashpër ndaj padrejtësive, qofshin ata edhe më të afërmit e tij. Kishte ekzekutuar djalin e tij me tetëdhjetë shkopinj, pastaj, kishte kërkuar që një çifut nga Egjipti ta merrte hakun e vet kundrejt një padrejtësie që i ishte shkaktuar nga djali i mëkëmbësit musliman në Egjipt. Personi (jomusliman) i cili kishte vendosur ta vriste Omerin, para se ta bënte atë, kishte shkuar tek ai për të kërkuar drejtësi. Ai e siguroi atë se do të përmirësohej zotëria i tij, ndërsa ai të nesërmen e plagosi me thikë të helmuar, për shkak të së cilës ai, pas dy ditësh, edhe vdiq. Omeri r.a. ishte shumë i kujdesshëm ndaj dhuratave të mbretërve. Ai nuk i përvetësonte ato për vete, por i konsideronte ato si pronë e shtetit.

Kronologjia e çlirimeve të Shamit (Lindjes së Mesme) në kohën e Ebu Bekrit dhe Omerit r.a.

Pas shumë leximeve dhe konsultimeve me libra të historisë islame, me shumë keqardhje them se kemi një problem serioz rreth datave dhe viteve në shumë ngjarje të rëndësishme të historisë sonë islame.

Kronologjia e ngjarjeve për çlirimin e Shamit:

Nr.	Ngjarja	Viti hixhri	Viti gregorian
01.	Përcaktimi i katër komandantëve	4 Rabiu Thani 12	18 qershor 633
02.	Dalja e Jezid ibn Sufjanit me ushtrinë e tij për në Damask	24 Rexheb 12	4 tetor 633
03.	Çlirimi i Dumetul Xhendel nga Halid Ibn Velidi	24 Rexheb 12	4 tetor 633
04.	Marshimi i Sherhebil bin Hasanit me ushtrinë e tij për në Jordani	27 Rexheb 12	7 tetor 633
05.	Marshimi i Ubejd ibn Xherahut për në Humus	7 Shaban 12	17 tetor 633
06.	Qëndrimi i Halin bin Saidit në Timaë, ose shuarja e trazirës në Timaë	14 Shaban 12	24 tetor 633
07.	Marshimi i ushtrisë së Amër ibn Asit për në Palestinë: Beteja në Urbe-Palestinë Beteja në Dathin-Palestinë	24 Dhul hixhe 13 3 Muharrem 13	1 mars 634 10 mars 634
08.	Marshimi i Halid Ibn Velidit nga Hire të Eufratit për në Sham	8 Sefer 13	14 prill 634
09.	Halidi çliron Basran në Sham (afër Jermukut pak kilometra)	25 Rebiul Evel 13	30 qershor 634
10.	Beteja – Exhnadin	27 Xhemadil Ula 13	30 korrik 634
11.	Beteja-Merxhu al Safar (Deri në këtë betejë Ebu Bekri ishte gjallë)	16 Xhemadul Ahar 13	18 gusht 634
12.	Ushtria bizantine takohet me atë të muslimanëve në Fahl dhe Bisan. Muslimanët ngadhënjejnë dhe kthehen në Hisar Dhemn	28 Dhul Kaade 13	13 janar 365
13.	Pas një rrethimi të gjatë dorëzohet Damasku	14 Rexheb 14	3 shtator 635
14.	Dorëzimi i Bealbek-ut rreth datës	25 Rebiul Evel 14	6 maj 636
15.	Çlirimi i Humusit	21 Rebiul ahar	1 qershor 15
16.	Beteja e Jermukut 1	5 Rexheb 16	12 gusht 636
17.	Dorëzimi i Kudsit (Jerusalemit)	Rebiul Ahar 16	maj 637

Duke qenë se muslimanët e hershëm nuk i kishin dhënë rëndësi të veçantë kësaj shkence, për një kohë të gjatë, ato nuk ishin regjistruar. Prandaj na mungojnë shumë data dhe të dhëna të sakta rreth disa ndryshimeve që kanë ndodhur gjatë historisë. Nuk kemi dilema rreth ndryshimeve sepse ato kishin ndodhur, por ajo që na brengos janë datat. Muslimanët nga modestia e madhe dhe nga frika se mos po i mashtron kjo botë, kishin menduar se të regjistruarit nuk ishin të ndonjë rëndësie të veçantë. Shumë vonë e kanë mësuar se e paskëshin pasur gabim dhe, kështu sot, kemi mungesë të madhe se çfarë ka ndodhur dhe kur ka ndodhur në realitet. Prandaj edhe shumë historianë dhe analistë jomuslimanë, abuzojnë shpeshherë me të vërtetat historike. Personalisht mendoj se faji nuk duhet shikuar tek kundërshtarët, por tek vetja jonë. Kjo neglizhencë e tyre ka shkaktuar dëm të madh, sepse janë bërë shkaktarë të ndryshimeve të fakteve historike.

Pra, muslimanëve iu mungojnë ngjarjet e sakta në mënyrë kronologjike. Historianët, si: Taberiu, Ibni Kethiri, Etheriu etj., janë shumë të vonshëm, krahasuar me ngjarjet e theksuara. Për këtë arsye, shumë informacione që ekzistojnë mund të jenë edhe të shtrembëruara. Taberiu p.sh. në librin e tij, kur sjell faktet historike, nuk i ka regjistruar saktë se në çfarë date kanë ndodhur. Ajo çfarë ka bërë ai është vetëm përshkrimi i ngjarjeve. Në shumë raste ai ka qenë i vetëdijshëm se në mesin e shumë tregimeve të përshkruara prej tij, kishte edhe të pavërteta, por për hir të tregimit dhe përhapjes së lajmit, ai i ka përshkruar për t'iu treguar besimtarëve se ka shumë prej atyre që kanë intriguar ndaj muslimanëve. Dijetarët e vonshëm, ato dhe shumë përshkrime të tjera të pasakta, i quajtën israiliatë (përshkrime izraelite).

Për të mos u zgjatur më, në këtë analizë, them se sikur të mos e kisha pranë vetes Atllasin Historik të dr. Husein Muenis, nuk do të kisha mundësi të vazhdoja me historinë islame. Nëse do të vazhdoja, nuk do të quhej më histori analitike, por një analizë e bazuar në përshkrime jo të argumentuara. Nëse do të kundërshtohesha nga të tjerët do ta pranoja kundërshtimin e tyre edhe pse jam i vetëdijshëm se edhe ata do të ishin bazuar në hamendësime. Ndërsa dr. Huseini, hulumtimet e tij i ka bazuar ndër shumë historianë arabë dhe joarabë. Ai është mbështetur më shumë në historinë e britanikut Tjufons dhe me të ka arritur të përcaktojë datat më të përafërta. Kjo kronologji e paraqitur prej tij do të na ndihmojë të njihemi më mirë me sukseset e muslimanëve të hershëm. Nuk shtrohet pyetja nëse muslimanët e kanë falsifikuar historinë e botës. Thënë të vërtetën, këto beteja dhe ngjarje ishin realitet, sepse kishin ndodhur. Ndryshe si mund të shpjegohet largimi ose tërheqja e ushtrisë bizantine ose asaj perse nga istikamet e tyre? Por, ajo që ishte dhe mbetet brengosëse për ne është forma dhe mënyra se si kanë ndodhur ngjarjet... ■

Fetarësia e Barack Obamës – m

Emine A. VEZAJ

"Askush s'mund ta kuptojë njerëzimin pa kuptuar së pari fenë e tij, sepse feja përfshin jetën e njeriut prej kohës më të lashtë". **Ninuan Suart**

Të gjithë ata që kanë përcjellë telenovelën e udhëtimit të Barack Obamës, ashtu sikurse edhe unë, kam përshtypjen se qenë dëshmitarë të liberalizmit amerikan në përzgjedhjen e një udhëheqësi nga radhët e amerikanëve me anamnezë afriko – amerikane, por gjithsesi, me këtë përzgjedhje, i dëshmuan botës demokratike se Amerika ka potencial dhe i mirëpret të gjithë ata që punojnë për mirëqenie të gjithëmbarshme. Piter Robinson, si ish-shkrues i fjalimeve në Shtëpinë e Bardhë, ardhjen dhe inaugurimin e presidentit të parë afrikano – amerikan, e cilësoi në të njëjtën kohë edhe historik, për shkak se vuri në pah mirësinë e demokracisë amerikane...

Ndalesa e parë e çiftit Obama para mbërritjes në Shtëpinë e Bardhë ishte kisha Saint Johns, e cila quhet ndryshe edhe kisha e presidentëve pasi ndalesa atje është traditë para inaugurimit. Fetarësia e Barack Obamës do të vërehej edhe në ditën e parë të punës së tij në Shtëpinë e Bardhë. Para se të fillonte punën, Obama mori pjesë në një meshë në të cilën ishin të ishin të pranishëm besimtarë katolikë, protestantë dhe disa prijës – liderë shpirtërorë myslimanë. Me këtë rast, Obama mori edhe një herë bekimin e famullitarit të Shtëpisë së Bardhë, i cili e bekoi për punën e tij në vazhdimësi.

Siç e kemi të njohur, Amerika dhe shumica e vendeve në botë janë në një sistem laik (sekular) ndërsa betimi në Librin e shenjtë është pjesë e Kushtetutës së Shteteve të Bashkuara. Në anën tjetër, e çuditshme është se edhe pse ky laicizëm i Amerikës nuk është transparent edhe aq sa duhet në institucionet përkatëse, dukshëm vërehet një fetarësi e amerikanëve. Përderisa në dollarin amerikan është mbishkrimi "In God we trust" – (Ne besojmë në Zot) dhe derisa betimi i presidentëve pararendës dhe i presidentit të sapo inauguruar bëhet në Bibël (e përdorur nga Abraham Lincolni në inaugurimin e tij në vitin 1861) atëherë çfarë do të thotë kjo? Mos ka ndonjë histori sekrete ky betim?! Sipas historianit Marwin Kranz: "Prania e Biblës gjatë betimit nuk është e domosdoshme, por një traditë e trashëguar që nga Xhorxh Washingtoni, të cilën e kanë ndjekur edhe shumë presidentë". Cilado qoftë arsyeja e betimit, mjafton të kuptojmë të gjithë se edhe superfuqitë më të mëdha kthimin e kanë të Burimi Hyjnor.

Rrjedhimisht, gjatë leximit të librit të Barack Obamës "Guxim për të shpresuar" është edhe një kapitull i librit i emërtuar "Feja". Përshtypja ime nga kjo pjesë e librit është shkëputja e një realiteti amerikan, të cilin e jetësova edhe unë për tre javë në disa qendra të Amerikës. Në vijim tekstualisht do të doja të informoj edhe lexuesin se opinioni i Barack Obamës ishte po ai që unë kisha nxjerrë në trejavëshin tim atje. E favorshme të përmendet është paraqitja dhe mënyra e aderimit që bëjnë intelektualët amerikanë në një parti. Gjithnjë sipas Obamës: "Ndërkohë, dallimi më i madh që bëjnë amerikanët e bardhë, kur vjen puna për regjistrimin në parti, nuk është ai gjinor – midis grave dhe burrave – as ai midis atyre që jetojnë në shtetet e kuqe (e kuqja nënkupton animin nga republikanët) dhe atyre që jetojnë në shtetet blu (bluja nënkupton animin nga demokratët), por midis atyre që shkojnë në kishë rregullisht dhe atyre që nuk shkojnë". Duke shkuar më tutje në këtë përshkrim, Obama vë në dukje edhe këtë aventurë të amerikanëve "Duket se çdo ditë amerikanët kryejnë punët e tyre të zakonshme – çojnë e marrin fëmijët në shkolla, shkojnë në zyra e punesa të



nodel edhe për liderët shqiptar



ndryshme, i hipin avionit për të shkuar në një takim biznesi, bëjnë pazar në hipermarkete, mundohen të mbajnë dietë – por mendojnë se diçka iu mungon. Ata po arrijnë në përfundim se pasuria e tyre, gjithë sa kanë, argëtimi, bizneset gjigante, nuk mjaftojnë. Ata duan të ndiejnë se e kanë një qëllim në jetë, diçka që t'i shpëtojë nga vetmia kronike, apo që t'i lartësojë e shkëpusë nga stërmundimi i zakonshëm. Ata kanë nevojë të sigurohen se dikush kujdeset për ta, i dëgjon ata – se ata nuk janë të destinuar të ecin në një rrugë të gjatë që të çon drejt hiçit".

A mund të kemi edhe ne një Obama shqiptar?!

Tani, natyrshëm më duhet të shtroj një këso pyetje: a mund të kemi edhe ne shqiptarët një Obama shqiptar i cili do ta ruante tablonë e identitetit të tij? Mbase asgjë nuk është e pabesueshme. Të gjithë ata që janë pjesë e politikës janë pjesë e planetit tokë, asnjëri prej tyre nuk na ka befasuar dhe nuk presim që të na befasojë me ndonjë karakteristik ose veçori mbinjerëzore. Dhe duke qenë se të gjithë liderët tanë burojnë dhe ushqehen me realitetin shqiptar, ata natyrshëm edhe mbartin në vete realitetit pozitiv dhe negativ të kësaj shoqërie.

Sa do të donim që edhe ne shqiptarët të shihnim ndonjëherë liderët tanë institucionalë teksa i shtrijnë duart e bashkimit dhe urimit në ndonjë festë fetare në ndonjë objekt fetar (përjashtimisht institucioneve zyrtare), p.sh xhamitë, pasi pashmangshëm deshën apo nuk deshën ata, "mbulohen aksidentalisht" me një identitet islam. Të nisur nga historia e shumëpërfolur, e presidentit të ndjerë të Kosovës Ibrahim Rugova dhe identitetit të tij, jemi të detyruar në një farë forme që të bëjmë publike edhe një herë simpatinë e tij për krishterimin. Pa mos harruar asnjëherë edhe dishepujt e tij, duke përfshirë këtu edhe homologët e të ndjerit, të cilët edhe më tutje vazhdojnë të ushqejnë urrejtje dhe antipati për identitetin e tyre islam.

Asnjëherë nuk kemi bërë tifozllëk për Barack Obamën për ta futur në radhët e myslimanëve, megjithëse ka një bagazh të dhënash për një identitet gjysmë mysliman e gjysmë katolik, por ne çdoherë dimë të përkrahim njerëzit e punës dhe të vlerave të larta. Të jesh lider do të thotë të kesh përgjegjësi edhe për të tjerët. Barack Obama, hyri në histori tani edhe ndoshta për një fjalim më të butë karshi botës islame – kishte kohë që bota islame nuk kishte dëgjuar nga një lider amerikan fjalime të tilla, mbase kanë një përjetim të hidhur me pararendësin e tij, Xhorxh Bushin! Pas vizitës dy ditore që Obama i bëri Evropës, në ndalesën e tij në Turqi, fjalimi e tij në mes të tjerash theksonte se ai: "Nuk dëshiron që marrëdhëniet e Shteteve të Bashkuara me botën myslimane të definohen nga lufta kundër Alkaidas" dhe se "Shtetet e Bashkuara nuk janë në luftë me Islamin". Çështë e vërteta Obama e ka cilësuar Turqinë si urë lidhëse mes Perëndimit dhe myslimanëve. "Ne jo vetëm që do të përmirësojmë marrëdhëniet tona, por do të krijojmë strategji për të ndërtuar urën, që mund të lidhë botën myslimane me perëndimin, që mund të na bëjë më të begatë dhe më të sigurt" – ka shtuar Obama. Krenarinë e identitetit të tij presidenti Obama nuk e fshehu as në vizitën e tij që bëri në Irak, duke e cilësuar vetveten si njëri që në familjen e tij ka edhe myslimanë, gjë që në një farë forme tregon edhe liberalizmin amerikan. Ai nuk hezitoi ta thoshte edhe këtë "Mendoj se njerëzit u nxitën të zgjedhin dikë si unë, që ka jetuar një pjesë të kohës përtej oqeanit, që ka myslimanë në familjen e tij, pasi besojnë se mund të ndërtojnë ura me pjesët e tjera të botës" – ka përfunduar Obama në fjalimin e tij drejtuar popullit arab.

Edhe liderët tanë do të duhej të ndërgjegjësoheshin se mozaiku i trashëgimisë sonë kulturore dhe identiteti ynë islam është shenjë e forcës e jo e dobësisë. Nuk kemi as dyshimin më të vogël se përkatësia tri fetare, përpos se e bën më të pasur dhe më të përbërë, mund ta bëjë edhe më të plagosshëm identitetin tonë kombëtar shqiptar, posaçërisht nëse ndonjëra prej këtyre feve do të favorizohej në mënyrë të veçantë prej institucioneve politike e shtetërore, siç bëhet kohë pas kohe sot. Të dhënat të cilat dëshmojnë se shqiptarët i takojnë qytetërimit islam, e që lehtësisht vërehet në dëshmitë dhe të dhënat historike, etnografike, kulturore, gjuhësore etj, mënyra e jetës së pjesës më të madhe të qytetarëve shqiptarë, arkitektura e qyteteve dhe fshatrave, objektet e kultit, veshjet popullore, këngët dhe vallet, kuzhina, ceremonitë rreth lindjes dhe martesës, ritualet e varrimit, dëshmojnë, për më tepër, se qytetërimi islam është më i shtrirë në jetën e shqiptarëve se sa ai katolik. Të mëtosh se feja islame, si fe e shumicës, është pengesë për integrimin e Kosovës, Shqipërisë e Turqisë në Bashkimin Evropian do të thotë të bëhesh propagandist fetar a politik fetar, që nuk e flet të vërtetën dhe nuk i kontribuon bashkëjetesës dhe harmonisë fetare. Ne nuk mohojmë se jemi një vend me myslimanë e krishterë dhe të gjithë së bashku kontribuojmë për një mirëqenie të gjithëmbarshme, por edhe kërkojmë nga liderët tanë që përgjegjësinë tonë ndaj vendit tonë ta shpërblejnë së paku dy herë në vit, me shkuarjen në xhami për ndonjë festë (Bajram ose Ramazan) ose në ndonjë kult tjetër ku ata ndihen më komod me përkatësinë dhe identitetin e tyre fetar. ■

"Letër rekomandim"

Lajmi – ndikimi, interpretimi dhe keqinterpretimi i tij

Driton MORINA

Me të vërtetë jeta i përngjan një cirku zbavitës, prej të cilit, përkundër kohëzgjatjes së tij, shikuesi mban mend vetëm insertet më interesante të tij. Sado që mund të zgjasë jeta, shtegtari i saj mban mend vetëm kujtimet më interesante të saj, qofshin ato kujtime të mira apo jo. Jemi dëshmitarë se në kohën moderne lajmi është faktori më i rëndësishëm i jetës. Nëse ai është i mirë, ai do t'i japë jetës një kuptim në vete dhe do ta gjallërojë shpirtin e njeriut; mirëpo nëse është i keq, atëherë njeriut do t'i ngryset qielli në pikë të ditës dhe do t'i fillojnë shqetësimet dhe brengosjet, pavarësisht se ndoshta ajo që ka dëgjuar nuk është fare e vërtetë.

Prandaj, këtë shkrim do të dëshiroja ta emërtoja 'letër rekomandim' për të gjithë ata që parapëlqejnë të besojnë në gjithçka që dëgjojnë, që t'i verifikojnë të dhënat para se jeta t'u mbushet me shqetësime dhe brenga. Edhe Kur'ani famëlartë porosit që lajmi të verifikohet, para se ta ketë ndikimin e tij negativ dhe të keqinterpretohet: "O ju që keni besuar, nëse ndonjë i pandërgjegjshëm u sjell ndonjë lajm, atëherë shqyrtojeni atë mirë, ashtu që të mos e goditni ndonjë popull pa e ditur realitetin, e pastaj të pendoheni për atë që keni bërë." (El Huxhurat, 6). Ndaj, në kohën bashkëkohore, lajmi është gjëja më e rëndësishme por edhe më e rrezikshme me të cilin përballet njeriu.

Në vijim ky artikull do të mundohet që shkurtazi të japë një pasqyrë se si lajmi mund të ketë ndikim të keq apo edhe mund të keqinterpretohet. Ajeti i sipërcituar na dha vetëm një pasqyrë rreth asaj se si duhet të kemi kujdes ndaj lajmit dhe se si duhet ta verifikojmë atë, para se të veprojmë sipas tij dhe ta dëmtojmë ndonjë popull, grup apo individ të caktuar. Madje nëse shikojmë komentimet e këtij ajeti dhe historikun e ngjarjes gjatë kohës së Muhamedit a.s., shohim se personi i cili përshkruhet si i pandërgjegjshëm këtu, në fakt ishte një sahab - bashkëkohës i Muhamedit a.s. - i cili nuk kishte për qëllim t'iu bënte shantazh muslimanëve, por ai solli një lajm të paverifikuar për shkak të frikës. Megjithatë, Kur'ani famëlartë i qorton muslimanët që të mos bien viktimë e lajmit të paverifikuar.

Shembuj të tjerë kemi edhe nga jeta jonë bashkëkohore, ngase jeta është mësuesi më i mirë i njeriut. Trazirat e marsit 2004 do të ishin mësimi më i mirë për ne. Televizioni publik, RTK, ishte ai që në atë kohë dha një lajm të ngutshëm lidhur me rastin e mbytjes së disa fëmijëve në pjesën veriore të vendit, gjë që shkaktoi revoltën mbarë popullore në vend. Të tjerët, duke u orvatur ta keqinterpretonin atë lajm, u munduan ta dëmtojnë imazhin e tërë vendit tonë. Ose lajmërimi përmes medieve i rasteve të vetëvrasjeve para trenit në Holandë, pa dashje kishte çuar drejt rritjes së numrit të vetëvrasjeve; si dhe mospublikimi i mëtutjeshëm i tyre ndikoi në zvogëlimin e depresionit dhe rasteve të vetëvrasjes. Së këtejmi, historia është pothuajse përplot me raste të lajmeve të pandërgjegjshme, nga të pandërgjegjshmit dhe të papërgjegjshmit. Madje në kohën, në të cilën po jetojmë është shtuar numri i të papërgjegjshmëve dhe të pandërgjegjshmëve, qofshin ata individë, grupe të organizuara, media apo edhe institute. Disa bëjnë shantazhe për interesa personale, materiale, karrieriste dhe private, ndërsa disa të tjerë bëjnë shantazh për t'i çuar në vend interesat e qarqeve të caktuara dhe e politikave të tyre.

Kështu, kur njeriu dëgjon ndonjë lajm është obligim njerëzor, moral dhe fetar i tij/saj që pikësëpari ta verifikojë atë e pastaj nëse është i dobishëm të veprojë sipas tij, përndryshe t'i shmanget atij lajmi. Prandaj, meqë jetojmë në një jetë si në cirk, jemi të obliguar që së paku t'i mbajmë mend mundësisht vetëm insertet e mira të tij, edhe pse ato inserte janë mjaft pak. Andaj, o ti që jeton në kohën bashkëkohore, mysliman/e qofsh apo jo, këndellu! ■

(Autori është magjistër i shkencave krahasuese të religjionit)

Dardan HOTI

Presim apo bëjmë?

Këto janë tri fjalë dhe dy kuptime. Dy kuptime skajshmërisht pa kompromis. Nëse këto dy kuptime ia veshim njëkohësisht një grupi individësh, arrijnë e arrijnë në një koncept pa destinim. Realiteti ynë kërkon shpjegime konkrete, prandaj ky epitetizëm i njëtrajtshëm nuk zë vend se s'bën. Të hyjmë edhe më thellë në shpirtin e ideologjisë së njeriut, si kuptim dhe njerëzve si gjithëpërfshirje.

Njerëzit, gjithnjë si aspekt fizik, janë fuqi që në shumë raste mund të vendosin për pikat influente (përfshirë këtu edhe rastin tonë), ndërsa njeriu si kuptim ideologjik dhe shpirtëror, është ai që planifikon rrugët dhe të bëmat e njerëzve, nëse nuk i cenohet dinjiteti i tij (pjesërisht rasti ynë). Rasti ynë si popull apo shoqëri me një kuptim komplet dialektik dhe i pakompozuar me nuanca të shumëllojshme, ka rënë në influencën, më tepër të rastit të parapërmendur (njerëzve). Si të tillë, ne, për fat të zi, i nënshtrohemi ligjit të pritjes dhe jo të të bëmave dhe kjo vetëm për një arsye. Lidhjet shumë komplekse dhe të padestinuara, na çojnë ne në një humbëtirë që zoti e di ku do të na përfundojë.

Duhet të jemi në gjendje ta pranojmë se si të tillë që jemi dhe rrugën e tillë që kemi nisur, do t'i paguajmë haraç kohës dhe atë vetëm për një arsye. Arsye kjo që nxjerr në pah, dilema dhe konkluzione të shkakut të pashkak, nëse na lejon e vërteta të themi kështu.

Shkaku kryesor i kësaj humbje kohore dhe hapësinore është (mendoj) që, rrallëherë i ndjekin parimet e vëna në bazë të së vërtetës dhe me rregulla të përbashkëta të realitetit demokratik ndërshoqëror. Me pak fjalë të themi, është për të ardhur keq gjendja jonë raciofizike.

Kur konceptohemi në të bëmat dhe ngecjet, realizojmë dëshirën dhe qëllimin për të nxjerrë në dritë gjendjen aktuale. Kjo gjendje, më tepër stagnim se sa ecje para, është rezultat i bindjeve personale që shërbehen vetvetiu si dëshmi për ndëshkim dhe dënim për tërë shoqërinë tonë. Gabim është edhe mbështetja në histori, ndërsa pohim vërtetësie është kthimi me trup dhe mendje në realitetin dhe jetën bashkëkohore.

Qëllimi i kësaj ideje, pohimi dhe gjykimi, nuk është vetëm kritika drejtuar subjekteve përgjegjëse, por edhe apeli jokushtetues drejtuar syrit nikoqir të realitetit (shoqërisë). Shtrati i së vërtetës është pranimi i realitetit dhe jo i ideve fiktive që lëshohen si virus në mendjet e masës së gjerë, të pafajshëm për gjendjen e krijuar.

Le të merren njerëzit më shumë me veten sepse njeriu nuk ka kohë të merret me të gjithë një për një. Të pastrohet ambienti nga mbeturinat e sistemit "një-si" të hedhura prej kohësh nga grupe të papërgjegjshëm individësh, nga individë që nuk duan asgjë tjetër përveç vetes. ■

Kopjimi - mani e shumë studentëve të UP-së

Kjo lloj dukurie negative dhe jo e dobishme është bërë një lloj manie për shumë studentë të cilët nuk çajnë kokën për këtë dukuri, por përkundrazi ndihen krenarë që e bëjnë një gjë të tillë dhe që ajo u jep rezultat. Por, shtrohet pyetja çfarë rezultati është ky dhe ku dërgon ky rezultat?

Halil ASLLANI

Mashtrimi, ose siç njihet më mirë në mesin e studentëve me termin kopjimi, do të thotë sjellje e pandershme në mënyrë që të arrish diçka që dëshiron. Kjo do të thotë, me një fjali të thjeshtë, se studentët shfrytëzojnë pandershmërinë e tyre dhe kalojnë provimet shumë lehtë. Kjo lloj dukurie negative dhe jo e dobishme është bërë një lloj manie për shumë studentë të cilët nuk çajnë kokën për këtë dukuri, por përkundrazi ndihen krenarë që e bëjnë një gjë të tillë dhe që ajo u jep rezultat. Por, shtrohet pyetja çfarë rezultati është ky dhe ku dërgon ky rezultat?

Përgjegjësia bie së pari mbi vetë studentët

Pse ndodh një gjë e tillë? Kush është përgjegjës? Kush duhet fajësuar? Janë disa pyetje të thjeshta të cilave mund t'iu përgjigjet çdo njeri me mendje të shëndoshë. Këtë përgjigje e dinë edhe vetë aktorët që e luajnë këtë rol. Sipas mendimit tim një gjë e tillë ndodh sepse mungon nderi i cili nënkupton shumëçka, mungon ndërgjegjja, vetëdija e shëndoshë, arsyeja dhe motivi për të cilin këta 'studentë' studiojnë, kultura e mësimnxënies, vizioni për të ardhmen dhe qëllimi apo produkti final.

Padyshim se faji dhe përgjegjësia bie së pari mbi vetë studentët të cilët e bëjnë një gjë të tillë në mungesë të fakteve të lartpërmendura. Ky është një fakt i cili po ekziston në UP, fakt i cili nëse ka një qasje të tillë siç e ka tani, vetëm sa do ta forcojë dhe rrënjëzojë më shumë një dukuri, që në këtë rast nuk sjell dobi. Në të kundërtën, një institucion që të vetmin qëllim ka arsimimin apo pajisjen me dije, do të shndërrohet në një vatër që reflekton nivel të ulët të dijes, që do të ketë pasoja për gjithë shoqërinë ku jetojmë. Pra, kjo prodhon një varg që formon një lloj zinxhiri që ka lidhje të drejtpërdrejtë me jetën e qytetarëve dhe thjesht nxjerr kuadro me aftësi të mangëta dhe kështu do të kontribuojë në moskryerjen e punëve në fushat përkatëse.



Edhe profesorët kanë pjesën e tyre të fajit

Në anën tjetër, edhe profesorët bartin një pjesë të fajit. Ka disa profesorë që e lejojnë hapur një gjë të tillë dhe thjesht nuk iu pengon, përkundrazi iu lehtëson punën. Ka edhe profesorë të tillë të cilët janë të mërzitur me numrin e madh të studentëve që iu nënshtrohen provimeve të njëjta disa herë me radhë dhe kështu mbyllin sytë dhe i kalojnë këta studentë, gjë që për mendimin tim është tepër e gabuar.

Është mirë që të theksohet se krahas zhvillimeve teknologjike janë zhvilluar edhe metoda apo teknika të reja të kopjimit. Nganjëherë mjafton një mbushje telefonike prej 5 eurosh që të kalosh një provim. Përparësi në përdorimin e kësaj metode kanë gjinia femërore për shkak të flokëve të gjata. Ato vendosin dëgjuesen e vogël në vesh dhe dëgjojnë përgjigjet nga largësia, që jep rezultat dhe studenti apo studentja kalon provimin. Mjafton të shkosh dhe të pyesësh punonjësit në dyqanet fotokopjuese që të tregojnë më për së afërmi disa nga metodat për zvogëlimin e madhësisë së shkronjave dhe për punën e shumtë që kanë ata para afateve të provimeve. Ka edhe raste kur në një sallë të vetme i nënshtrohen provimit dhjetëra studentë dhe ku prezent është vetëm një profesor, i cili e ka të vështire të kontrollojë në mënyrë efektive një gjendje të tillë.

Në anën tjetër ka profesorë dhe studentë që kryejnë punën e tyre në mënyrë shumë të ndershme dhe efektivë, por mjafton edhe kjo gjendje dhe faktet e lartpërmendura që të zgjojnë një shqetësim serioz.

Mashtrimi është i pranishëm kudo në botë, në shtëpi, në shkollë, në biznes etj., dhe kështu paraqet një problem të madh për shoqërinë. Pandershmëria si faktor kryesor po luan rol të madh në shoqërinë e sotme. Thjesht duhet që të ngrihet vetëdija dhe ndërgjegjja si tek profesorët, ashtu edhe tek studentët, që ta kuptojnë se kjo dukuri e shëmtuar nuk i dërgon askund tjetër përveçse në humbje. Studentët duhet ta ngulisin në kokat e tyre fjalën 'studioj' e cila do të thotë të marrësh njohuri të reja në një fushë të dijes, duke lexuar libra e duke shfrytëzuar botime e materiale të tjera, nën drejtimin e një mësuesi apo në mënyrë të pavarur. ■

Kur'ani vlerësohet si një mrekulli e formës sublime që përshtatet në mënyrë absolute me një përmbajtje sublime dhe që shkakton një efekt sublim. Kjo mrekulli estetike apo letrare e Kur'anit u pranua nga të gjithë muslimanët si dëshmi për autorësinë e tij hyjnore

Kur'ani si let

Mimoza SINANI

Kur'ani është një ilustrim perfekt i sublimes në formë dhe përmbajtje, që shkakton efekt sublim.

Vetë forma është e zbrazët. Megjithatë, forma ka një tendencë që ta rrisë bukurinë nëse asaj i bashkohen ide që janë vetë të bukura. Sa më fisnike përmbajtja, aq më e madhe forma; sa më vulgare përmbajtja, aq më e dobët forma. Në Arabinë paraislame, vlerat e fisnikërisë – trimëria, elokuenca, mikpritja, besnikëria dhe prejardhja – ndihmuan që të krijoheshin format më të bukura të poezisë. Por këto forma u përdorën gjithashtu për të shprehur vlerat romantike të tribalizmit dhe etnocentrizmimit, vlerat hedoniste të verës dhe kënaqësisë seksuale, apo vlerat cinike të përkohshmërisë dhe papërgjegjshmërisë. Këto forma poetike Kur'ani i dënoi si prostitucion të formës së bukur. (26:224- 227)

Nga ana tjetër, vetë përmbajtja është inerte. Pa formën e mirë, përmbajtja e humbet fuqinë e saj tërheqëse. Megjithëse vlera e ideve të mira nuk është kurrë zero, forma mund ta zvogëlojë atë aq sa për t'i bërë ato "të vdekura", "të rëna në vesh të shurdhër", "të çakorduara me situatën në të cilën ato ndodhin." Kur vishet me formë të mirë dhe të përshtatshme, përmbajtja shkëlqen me të gjithë madhështinë e saj të brendshme. Në të vërtetë, forma e mirë vepron në mënyrë misterioze mbi përmbajtjen duke e ngritur forcën e saj tërheqëse.

Si rrjedhim, relacioni midis formës dhe përmbajtjes nuk është statik, por dinamik. Kur përmbajtjes i jepet forma, asnjëra nuk mbetet po ajo. Rezultati është gjithmonë një efekt më i madh, më i thellë, më prekës dhe më i qëndrueshëm. Efekti është rezultat i veprimit të kombinuar të formës me përmbajtjen. Idetë e mëdha që shprehen saktësisht në formë të bukur kanë fuqi madhështore. Arsyeja për këtë lartësim të bukurisë qëndron në faktin se ajo është një anë e transcendencës së Zotit.

Nga kjo rrjedh se efekti sublim është rezultat i përmbajtjes sublime të lidhur me formën sublime.

Si rrjedhim, ne mund të konkludojmë se sublimja nuk është kurrë sublime vetëm në formë, as vetëm në përmbajtje, as vetëm në efekt. Ajo është në të tria njëkohësisht. Forma sublime pa përmbajtjen sublime, apo përmbajtja sublime pa formën sublime, shkaktojnë pak apo as-



pak efekt, sigurisht jo efektin që ka sublimja.

Natyra e sublimitetit letrar

Kur'ani vlerësohet si një mrekulli e formës sublime që përshtatet në mënyrë absolute me një përmbajtje sublime dhe që shkakton një efekt sublim. Kjo mrekulli estetike apo letrare e Kur'anit u pranua nga të gjithë muslimanët si dëshmi për autorësinë e tij hyjnore.

Me qëllim që të pranohej dhe të vlerësohej si një mesazh nga Qielli, njerëzit të cilëve iu adresohej Kur'ani duhej të ishin në një nivel të tillë të zhvillimit letrar saqë ta perceptonin se ai nuk ishte vepër njerëzore.

Kur'ani e sfidoi krahasimin e ndonjë pjesë të tij për nga bukuria letrare.

Pa këtë fuqi sfiduese s'ka dyshim se Kur'ani nuk do të mund të kishte ushtruar fuqinë e tij të jashtëzakonshme, të mrekullueshme, magjepsëse, prekëse dhe mallëngjyese. Dhe pa këtë fuqi, arabët nuk do ta kishin pranuar atë si hyjnor. Rasti i pejgamberisë së Muhammedit është unik sepse ai e mbështeti vërtetësinë e pohimit të tij, vetë hyjninë e burimit të tij, në fillin e bukurisë letrare.

Në të vërtetë, Kur'ani i theu të gjitha normat e përsosmërisë letrare që arabët kishin njohur. Çdo ajet i tij përshtatej dhe i përmbushte normat e njohura letrare – dhe megjithatë i tejkalonte ato përtej masës. Arabët i kishin nocionet e idealeve letrare dhe ata kishin dëshmuar aktualizime pak a shumë perfekte të këtyre normave. Aktualizimi i Kur'anit e tejkaloi çdo gjë që ishte njohur ndonjëherë. Kjo ishte arsyeja se përse ata e vlerësuan atë të mbinatyrshëm, apo një sfidë për t'u krahasuar me diçka që nuk mund të krahasohet kurrë. Kur'ani i çarmatosi plotësisht kundërshtarët e vet. Ata e pranuan origjinën e tij hyjnore dhe iu nënshtruan urdhëresave të tij.

Sublimiteti i efektit

Arabët kishin mendim të lartë për përsosurinë e tyre letrare. Kur'ani e dërrmoi krenarinë e tyre. Poezitë e gjenive më të frymëzuar letrarë u zbehën përpara Kur'anit madhështor. Natyrisht, ai vendosi ndalesë të përkohshme në produktivitetin e tyre letrar. Disa poetë u betuan se nuk do të kompozonin më kurrë poezi.

Mbi të gjitha, asnjë libër nuk ka qenë ndonjëherë shkak i ndryshimit të tillë të thellë religjioz, intelektual, kulturor, moral, social, ekonomik dhe politik, në jetën e miliona njerëzve, apo të njerëzve aq të ndryshëm etnikisht, siç është Kur'ani.

Arabishtja kur'anore u bë standard dhe normë e gjuhës arabe, sa i përket fjalorit, sintaksës, gramatikës dhe elokuencës së saj. Çdokush e shikonte atë si kriterin themelor të kompozicionit dhe përsosmërisë letrare.

Shprehjet dhe figurat e të folurit të saj, krahasimet dhe metaforat e saj, idiomat dhe artefaktet e saj, u bënë pjesë e të folurit të përditshëm dhe ato u për-

tërsi sublime

dorën si xhevahire dhe zbukurime me të cilat stolisej çdo vepër letrare.

Kur'ani ka qenë ideali absolut letrar i pasfiduar. Përpara kohës së kolonializmit, pothuaj të gjitha veprat e krijuara prej muslimanëve reflektonin karakteristikat tradicionale të Kur'anit. Këtu u përfshinë: formimi delikat i fjalëve më të mira së bashku për të përshtatur një domethënie të caktuar; ekuilibrimi apo pranëvënia e fjalëve simetrike, frazave apo domethënieve; përsëritja apo shprehja e një forme, modaliteti, apo teme një numër herësh, secila e ndryshme nga të tjerat por megjithatë që e fokusojnë vëmendjen mbi të njëjtën temë; vazhdimi jozhvillimor, pra vijimi i temave, pjesëve apo kapitujve, pa ndërlidhje organike, por me fraza apo tema standarde, që hapin dhe mbyllin secilin pasazh dhe që gjenerojnë shpejtësi në drejtim të vijimit të pafundmë; shkurtësia, përpikëria, dhe thjeshtësia, apo përdorimi i numrit më të paktë të fjalëve për të përmbledhur domethëniet më të mëdha; vendosja e secilës fjalë në vendin e saj përkatës; ndryshimi i papritur i kohës, formës së fjalimit, apo domethënies, në një tjetër kundërvënëse me të, si një mënyrë për përforcimin e të dyjave; përçimi i domethënies abstrakte nëpërmjet impresioneve që u jepen shqisave, duke e bërë kështu munguesen prezente, iluzoren reale dhe abstrakten konkrete; qartësia e shprehjes, apo mungesa e kriptizmave [të panjohurave], e simboleve dhe e domethënieve të fshehta; dhe së fundi, bukuria e shprehjes, përshtatshmëria e saj me ngjarjen, apo përzgjedhja e shprehjeve dhe stileve që i përshtaten lexuesit/dëgjuesit, si edhe temës në diskutim.

Respektimi i të gjitha këtyre kritereve, për shkak se ato rridhnin nga Kur'ani dhe ilustrimi i tyre ideal synohej universalisht prej të gjithë muslimanëve.

Sublimiteti i përmbajtjes

Sublimiteti i mesazhit të Kur'anit shprehet në shumë aspekte:

Kur'ani e pohon mendimin e shëndoshë dhe arsyeshmërinë si qëndrimin ideal të mendjes njerëzore. Ai mëson çlirimin nga kontradikta, inkoherenca, ambiguiteti, nga paradoksi, miti dhe çdo lloj obskurantizmi.

Kur'ani nuk i paracakton prioritet as revelimit, as arsyes, por deklaron barasvlerën e tyre, duke i shpjeguar të gjitha mospërputhjet midis tyre ose si një mungesë në të kuptuarit e revelimit, ose si një gabim në proceset e arsyes.

Qëndrimi kur'anor është, si rrjedhim, optimist në lidhje me aftësinë e njeriut për dije. E vërteta, mendon ai, është e njohshme; e pavërteta nuk është kurrë përfundimtare dhe mund të kapërcehet gjithmonë me njohje më të mirë. Islami, aftësinë për të njohur të vërtetën, e pohon për të gjithë njerëzit dhe e afirmon atë si bazë të universalizmit islamik.

Ai mohon çdo kategorizim të njerëzve, që bën diskriminim midis tyre në lindje për sa i përket aftësisë së tyre, apo për sa i përket lidhjes së tyre me Zotin, Krijuesin e tyre.


Islami e identifikoi veten me dijen. Ai e bëri dijen kushtin e tij si edhe qëllimin e tij. Ai e barazoi kërkimin e dijes me adhurimin dhe derdhi lavdërimet e tij më të pakursyera mbi ata që angazhohen për kultivimin e saj, duke i bërë ata të shenjtë dhe miq të Zotit dhe duke e ngritur bojën e tyre mbi gjakun e martirëve. Megjithatë, dija islame nuk është një njohuri upanishadike, të cilën njeriu e fiton nga një mësues guru. Ajo nuk është as një shkreptimë e pavullnetshme në ndërgjegjen e një pasuesi që i nënshtrohet një eksperience mistike. Dija islame është perceptim racional – empirik dhe intuitiv – i çdo sfere të realitetit. Ajo është dije kritike e njeriut dhe e historisë, e tokës dhe e qiellit. Dija është e pafundme për shkak se e vërteta është e pafundme.

Islami nuk ka përkrahur një status të një "të parapëlqyeri", "të zgjedhuri", as për muslimanët, as për ndokënd tjetër. Ai e urren çdo lloj të partikularizmit, tribalizmit, nacionalizmit, racizmit apo etnocentrizmit dhe mëson se asnjë karakteristikë e lindur nuk fiton ndonjë prioritet për askënd. Çdo njeri duhet dhe do të marrë ekzaktësisht atë që ai e meriton.

Kur'ani e fton njerëzimin që ta pranojë mesazhin e tij në mënyrë racionale, në mënyrë kritike dhe në liri. Ai i urdhëron muslimanët që në misionin e tyre të theksojnë vendet e pajtimit dhe t'i forcojnë ato, "për të thirrur në rrugën e Zotit me urtësi dhe këshillë të mirë" (Kur'an 16:125) dhe për të mos e detyruar kurrë, askënd, në çështjen e fesë (Kur'an 2:256).

Kur'ani e deklaron ummetin një vëllazëri universale, brenda së cilës mund të veprojnë në të njëjtën kohë një pluralitet sistemesh ligjore dhe kulturore. Mesazhi kur'anor nuk e ndan realitetin material në të shenjtë dhe profan, jetën njerëzore në religjioze dhe shekullare. Relevenca e mesazhit të Kur'anit, si edhe ajo e sheriatit, nuk është një libër i mbyllur. Ai është gjithnjë i hapur ndaj realiteteve të reja. ■

(Vazhdon në numrin tjetër)



Vështrim kritik


Esencat diskursive

Dihet se diskursi universal i poezisë, jeton gjithnjë duke shënjuar kuptime. Nga kjo figurat e tekstit ndërlidhen, çdoherë në sintetizim të idesë/tematikës. Mbi këtë parim mundësohet edhe analizimi i kodit tematik, gjithnjë me qëllim të identifikimit të vetë strukturës poetike



Flamur MALOKU

Libri poetik *Lule ajri* e Hasije Selishtës - Kryeziut, formulohet duke krijuar një sistem të *ligjërimit/figurimit*. Ligjërimi në tekst bëhet ligjërim i shtresuar në variante, që njëherësh bëhet shenjë e identifikimit për *tekstin-poezinë*, gjithnjë duke e përforcuar figurën e tekstit, e cila bëhet shenjë themelore e kuptimësisë. Figurat formësohen në diskursin e tekstit, gjithnjë në funksion të semantikës. Poezia sa vjen e bëhet më e hapur si tërësi estetike në lexim. Shenjat kuptimore të shtresuara në formë të *diskursit/poezisë*, gjatë leximit e interpretimit bëhen shenja universale. Këtu, bota personale bëhet botë universale. Dihet se diskursi universal i poezisë, jeton gjithnjë duke shënjuar kuptime. Nga kjo figurat e tekstit ndërlidhen, çdoherë në sintetizim të *idesë/tematikës*. Mbi këtë parim mundësohet edhe analizimi i kodit tematik, gjithnjë me qëllim të identifikimit të vetë strukturës poetike. Struktura e tekstit analizohet përmes esencave shënjuese të cilat reflektohen në poezi. Esencat shënjuese artikulohen në tërësinë e shkrimit fiksional, çdoherë duke njohur e rinjohur *relacionet/komunikimet*, e shumta *diskurseve/tematike*. Largësitë horizontale nuk maten më, pritja zgjatet për t'u bërë pikë loti në kohën e pikëllimit e të figurimit. Autorja shtrihet në këtë diskurs me vuajtje, për ta bërë jetën emocion. Metafora i përshtatet emocionit. Pra, të gjitha shenjat shpirtërore thellohen në variante të strukturimit, për të dalë çdoherë nga një heshtje empirike. Shkrimi empirik kryqëzohet në tematikën e përgjithshme të tekstit. Mënyra e paraqitjes shpirtërore theksohet e manifestohet në metafizikën e përhershme, ndërsa atributet personale argumentohen. Pra, figura-metafora bëhet e brishtë dhe del vazhdimisht në gjendje të theksuar e të trazuar subjektive. Trazimet lindin e shtohen në kohë, për t'u bërë edhe shtrat i vetmisë. Në këtë rrëfimin të përhershëm jetësor, monotonia personale bëhet mit që shënjon pikëllimin, që shpallet e argumentohet në heshtjen e madhe. Monotonia e heshtjes ndrydhet në vete, e përhershmja shpirtërore e trupore dergjet nga dhembja. Meta-theksimet e heshtjes riciklohen nëpër diskursin e figurshëm, duke dhënë një jetë tani me plotë dhembje. Duke promovuar mitin e dhembjes, e të pikëllimit të vetëkrijuar nga koha, reprezentimi i unit në poezi strukturohet e shumëfishohet në jetën për jetën e dhembjes subjektive. Në të shumtën e poezive koha bëhet fajtore e dëshpërimit. Tani jeta në kohë bëhet fjalosje. Fjalosjet e njerëzve ngadalë bëhen mure të vetmisë, të cilat ngjallin të poetja urrejtjen. Mirëpo, fjalosjet sikur kanë marrë rrugë të pakthim, pra rrugët bëhen esencë e përgjithshme, çdoherë mbi reflektimin e tragjikes jetësore. Muret e vetmisë bëhen figurë jete, pothuajse në tërë tekstin poetik. Vetmia bëhet motivim, tani në fiksionin e shkrimit-tekstit. Subjekti ka një shpresë shpëtimi mbi vetminë e rëndë mbi jetën e rëndë.



Zbrazëti e vetmi

Variantet e shumta personale shtresojnë *tema/mitema*, të cilat në poezinë e Hasije Selishtës- Kryeziut artikulohen nga një gjendje shpirtërore me përplot emocione. Gjendja shpirtërore-subjektive portretizohet përgjatë realizimit të shkrimit fiksional. Individualja bëhet e *ndjeshme/emocionalizuese* dhe në poezi paraqitet me një dhembje e dëshpërim. Pra, jepet dhembja e dëshpërimi karshi kohës e situatës. Koha dhe situatat e përjetuara në shpirtin e subjektit bëhen *zbrazëti/vetmi*. Kjo edhe e rrit më shumë dramatiken e tekstit. Ballafaqimi me situatën, pa dyshim, në strukturën e poezive preket e shqyrtohet dhe ngadalë shndërrohet në përjetim të rëndë. Përjetimet e figuruara marrin gjithnjë dimension të theksuar konotimi. Konotimi i tekstit bëhet përfaqësim e theksim i *Botës-Jetës/Ekzistencës*. Lufta personale dhe ballafaqimi për një ekzistencë jetësore bëhet preokupim shpirtëror e fizik. Mbi këtë ide, subjekti ndërton e rindërton vuajtjen e madhe. Jo rastësisht ligjërimi identifikohet e figurohet me mollën e rënë para kohe: ***Nën degë molla e rënë/ Para kohe/ E papjekur po kalbet.*** Këto mendime të shprehura në tekst, japin atë që quhet vuajtje e brendshme individuale, që del ashtu në heshtje personale, përballë vështirësive jetësore të të qenit femër. Zbrazëtia e krijuar shpirtërore dhe pamundësia e veprimit e bën poeten të ligështuar dhe të ndjeshme. Pra, mungon forca e veprimit. Mbi këtë mungesë të veprimit, lindin në diskurs edhe kontrastet ideore, të cilat në përgjithësinë e sistemit ndërtojnë figurën, duke u bërë para së gjithash

edhe shprehje e një revolte subjektive. Kontrastet e shumta në strukturën e tekstit venerohen dukshëm dhe dalin kushtimisht nga rrafshi i pamundësisë. Edhe pse pamundësitë janë të shumta në jetë, e përgjatë jetës, shprehja personale-subjektive gjithmonë rri larg deklarimeve. *Figura/tematika* e poezive nuk i pranon deklarimet.


Shenja-variante

Duke i parë të gjitha thyerjet shpirtërore në jetë dhe pamundësitë e veprimit për shkak të të qenit femër, poezitë në esencë nuk e japin asnjëherë dorëzimin personal karshi jetës. Vuajtja njihet si shenjë personale, e cila gjatë shkrimit bëhet e prekshme, sugjeruese e identifikuese për *(Tjetrin)*. Kjo bëhet edhe status i kodit llojor, përgjatë *kategorizimit/shkrimit*. Hapësirat shtresore dhe thyerjet konvenciale funksionojnë përherë në të mirë të *diskursit/tematikës*. Kërkimi i vazhdueshëm i shtresave të përvojës autentike, në të gjithë poezinë, bëhet *themelor/përcaktues*. Komunikimi i shprehur sa vjen e përforcohet. Mbi këtë, autentikja nis e hapet në diskurs të përhershëm. I gjithë pasqyrimi i vuajtjes e trishtimit, në kohë përjetimi, formohet në shenja e variante të relativizuara. Pra, jeta relativizohet në rikthim nga figura, në variante të shumta. Në këtë mundësi të shprehjes, skema thyhet dhe jeta bëhet *figurë/shkrim*. Duke qenë kështu, vargu i poezisë nuk mbingarkohet në kuptimësi përgjatë një bote fiksionale. E gjithë kjo e bën poezinë e Hasije Selishtës-Kryeziut të jetë më pranë lexuesit të dashuruar me diskursin e poezisë. ■



Lajme

Adem Demaçi zgjidhet kryetar i LSHK-së



Adem Demaçi është zgjedhur kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës, në kuvendin e fundit zgjedhor, të mbajtur ditë më parë. Po ashtu është zgjedhur edhe kryesia e re LSHK-së me gjithsej 9 anëtarë.

Punimet e këtij Kuvendit i ka karakterizuar një atmosferë e tensionuar me kundërshtime të vazhdueshme mes një pjese të anëtarëve të kryesisë së kaluar me kryetarin e deritanishëm, ku nuk kanë munguar edhe fjalët fyese dhe largimet nga Kuvendi të disa anëtarëve të pranishëm të LSHK-së. Diskutimet më të ashpra kanë qenë mes ish-kryetarit Kadrush Radogoshi dhe Adem Gashit, të cilët janë shprehur me një fjalor shumë të ashpër mes vete. Në raportin e tij të punës së LSHK-së për dy vjetëve e kaluar, Kadrush Radogoshi ka akuzuar direkt Adem Gashin, i cili sipas tij që nga zgjedhja në postin e drejtorit i është nënshtruar një sabotimi dhe shantazhi nga vetë Gashi. Sipas tij, gjatë këtyre dy vjetëve, kryesia e LSHK-së ka funksionuar e hendikepuar për shkak të, siç është shprehur Radogoshi, sabotimit që ka bërë një pjesë e anëtarëve të kryesisë. Ai ka akuzuar Gashin se i ka imponuar LSHK një status të paaprovuar në Kuvend, me të cilin e ka regjistruar LSHK-së si OJQ. Radogoshi ka adresuar edhe një numër akuzash të tjera në adresë të Gashit, duke përfshirë edhe mosmarrëveshjet rreth shitjes së Hotel “Unionit”, ku LSHK-ja ka pronë të sajën.

Ndërkaq, nuk është marrë parasysh propozimi i anëtarit të kryesisë Adem Gashit, për të shtyrë Kuvendin pasi që, siç është shprehur, ai ky kuvend është i paligjshëm dhe si i tillën nuk mund të mbahet pasi që, siç ka thënë Gashi, ka një pjesë të vogël të anëtarëve prezent të LSHK-së në këtë takim.

Pas shumë debateve, Radogoshi ka propozuar Adem Demaçin për kryetar, propozim i cili është marrë me shumë rezerva nga një pjesë e anëtarëve të LSHK-së, pasi që sipas tyre, Demaçi ka punë të tjera për të bërë, por duke mos e kundërshtuar propozimin.

Në fjalën e tij, Adem Demaçi, pasi konfirmoi se pranon të jetë në krye të LSHK-së, nuk ka lënë pa drejtuar akuza ndaj ish-kryetarëve të mëparshëm dhe anëtarëve të kryesisë së LSHK-së, që sipas Demaçit, e vodhën dhe e sollën në një gjendje çfarë është sot. Ai ka thënë se do të kërkojë dhe do të punojë që LSHK-ja të bëhet një organizatë publike buxhetore. Po ashtu, ai ka kërkuar nga anëtarët e LSHK-së që të bashkëpunojnë në kthimin e dinjitetit të shkrimtarëve tanë. ■

Nderohen Vehap Shita dhe Myshyrefe Lozana

Dita Botërore e Teatrit është shënuar me aktivitet të shumta dhe me ndarje çmimesh të rëndësishme në Prishtinë. Teatri Kombëtar i Kosovës ka zgjedhur këtë ditë të rëndësishme për të ndarë çmimin vjetor të teatrit, për të publikuar fituesit e konkursit të dramës “Katerina Josipi”, si dhe për të promovuar numrin e tretë të revistës për teatër “Loja”. Çmimi vjetor për teatër i është ndarë kritikut Vehap Shita dhe aktores Myshyrefe Lozana. Ndërsa, fjalimi i shpërndarë nga TTK-ja është shkruar nga Augusto Boal. “Nuk janë spektakle vetëm dasmat e funeralet, por edhe ritualet e përditshme që i njohim, aq sa nuk jemi të vetëdijshëm për këtë. Nuk janë teatër vetëm solemnitetet, por edhe kafeja e mëngjesit dhe urimi për ditën e mirë, vardisja si me turp dhe vërshimi i pasioneve, seanca e Kuvendit ose takimi diplomatik – gjithçka është teatër”- ka shkruar Augusto Boal. ■

Përgatiti: Esat VATOVCI


Rrjeti i kuptimit

Në roman kërkohet gjithmonë rrjeti i komunikimit të kohëve të ndryshme, për të kuptuar se ky roman ka në brendësinë e tij fatin si koncept universal



Fitim VELIU

Romani i Milazim Krasniqit "Fijet e shpirtit" u botua për herë të parë në vitin 1998 dhe u ribotua përsëri në vitin 2007, me plotësime dhe ndryshime, por gjithmonë duke e ruajtur esencën fillestare të materies dhe idesë. Vendosa të shkruaj për romanin e Milazim Krasniqit "Fijet e shpirtit" për disa arsye: arsyeja e parë është se ky roman shtreson ngjarje dhe personazhe të cilat lidhen me idenë e autorit, pra romani ka intenca ideografike për shkrimin dhe autobiografike për vetën e tij. Ideja e subjektit të romanit është thurur nëpërmjet Besnikut, i cili përfaqëson jo vetëm fatin personal, por edhe atë kolektiv. Dhe një arsye tjetër është se ky roman komunikon me kohën diakronike dhe sinkronike, pra bëhet një lidhje asociative që për lexuesin dhe kritiken tonë është gjithmonë aktual dhe i pashtershëm, sa i përket rrjetit të kuptimit të tekstit me kohën sinkronike në nivelin e ideve autobiografike dhe ideografike. *Siç thotë kritiku letrar Flamur Maloku: idetë biografike jepen si mundësi e ndërtimit të sistemit të kujtimeve, si rend i strukturimit të tyre.* E po ashtu, ky roman e ngacmon kritikun për t'u marrë me të për faktin se subjekti e thur gjithë romanin përmes poetikës së dokumentit historik. Kur flasim për një fakt të tillë, mendoj për intencionalitetin e autorit të romanit, i cili arrin të argumentojë faktin se fati i rëndë i kolektivitetit të tij nuk është pasojë e njerëzve dhe pushteteve aktuale të kohës, por i devijimeve historike të paraardhësve tanë, pra devijimi nga gjeneza e ilirëve. Devijimet kanë ndodhur duke përvetësuar forma dhe mënyra të të jetuarit nga pushtuesit e ndryshëm historik. Pra, në këtë roman duhet të kërkohet gjithmonë rrjeti i komunikimit të kohëve të ndryshme për të kuptuar se ky roman ka në brendësinë e tij fatin si koncept universal. Universalitetin e bën tema e madhe nacionale e atdheut, pra dashuria e narratorit për të rrëfyer fatin e kolektivitetit, gjithmonë duke e identifikuar vetveten përmes shkrimit, pra fatin personal nëpër përthyerjet e dhunës së pushtetit ndaj tij dhe të tjerëve. Romani shtreson fate të ndryshme siç janë: fati i njeriut, atdheut dhe kombit. E gjithë kjo trajtohet nga autori duke ju referuar kohës diakronike, e cila ka prodhuar situatat e vështira më vonë. Romani "Fijet e shpirtit" thur në brendësinë e tij fatin e një personazhi që shënjohet në Besnikun, por fati i tij është fat edhe i kolektivitetit, pra subjekti përmes këtij personazhi subjektiv dëshiron ta paraqesë fatin objektiv të një populli të tërë. Brenda romanit autori shtreson në totalitet format e dhunës së egër, demaskimet që u bëhen gazetarëve gjoja se janë terroristë, demaskimet e ndryshme të njerëzve në shërbim të pushtuesit, të cilat shënjojnë situata të rënda nëpër përthyerjet më intime.



Besniku dhe simbolika e tij

Personazhi i brendësisë së romanit "Fijet e shpirtit", Besniku, është vetëm një kuadër brenda romanit për ta kuptuar lidhjen unazore të të gjitha ngjarjeve, për shkak të ngjarjeve të shtresuara në roman. Besniku është një person intelektual, në të cilin përthyhet situata e rëndë jetësore. Besniku simbolizon fortësinë e individit përballë dhunës së pushtetit dhe paluhatshmërinë e tij. Kjo jepet krejt si detyrë morale për të mbrojtur të drejtën nacionale të vendit të tij. Besniku vihet nën hetime për shkak të funksionit ideologjik që ka për bashkimin e shqiptarëve. Shërbimet e fshehta po e ndiqnin Besnikun. Kjo bëhet e ditur nga shoku i tij Lami, në një kafene të qytetit. Arrestimi i tij bëhet në një kohë kur vëmendja e opinionit është në Shqipëri, pikërisht në tragjedinë e vitit 1997. Arrestimi i tij është thirrje për bashkëpunim në dëm të atdheut. Të gjitha përjetimet e Besnikut në burg, edhe pse janë të rënda, nuk e largojnë nga ideja politike, ideologjike e bashkimit të shqiptarëve. Besniku, për këtë fatin e tij dhe të kolektivitetit, fajëson paraardhësit dhe gabimin e tyre historik, e sipas tij ky faj mund të përmirësohet me besim të drejtë, sepse besimin e tij të drejtë tanimë Besniku e përjeton si pastrim, forcim dhe identifikim me të vërtetën absolute. Edhe përkundër torturave të shumta në burg, Besniku nuk u luhat asnjëherë nga qëndrimi i tij. Kjo për shkak të besimit të tij të drejtë dhe fitores së sigurt. Edhe pse Besnikun e mbysin në burg, kjo nuk i lë të qeta shërbimet e fshehta. Autori arrin të bëhet artist i vërtetë kur arrin të paraqesë situatën kur kufomën e Besnikut e shëtisin nëpër qytet për t'i futur tmerrin popullatës së gjerë. Kjo është dhuna psikologjike e pushtuesit. Besniku me përfundimin e tij tragjik shënjon paluhatshmërinë e tij karshi kodit nacional, *ku siç thotë kritiku Flamur Maloku fundi i Besnikut shënjon fortësinë individuale gjatë sprovimit mes jetës dhe vdekjes.* Pra, romani "fijet e shpirtit" është përplot mesazhe dhe ide, të cilat është vështirë të hetohen pa një mendim dhe meditim të thellë, pra idetë nuk janë deklarative në tekstin e dhënë, por ato funksionojnë brenda strukturës narrative. Romani "Fijet e shpirtit" i Milazim Krasniqit dëshmon kulturën e shkrimit dhe veçantinë e rrëfimit artistik. Andaj leximi i romanit kërkon një lexim të kujdesshëm, një *'close reading'* siç thonë amerikanët, kjo për faktin e kuptimit të çdo detaji, sepse po nuk u kuptua çdo detaj i këtij romani nuk mund të kapet ngjarja esenciale. ■

Poezi

Natë e vrarë me heshtje

Ibrahim KADRIU



Frymëmarrje në shtjellë

As në gjunjë
as nën gjunjë
nuk kërkoj strehim
mundimi im i ardhur

Kur s'ka dashuri
Urrejtja jote s'më duhet
e shpall të pa qenë
frymëmarrjen time në shtjellë

Mes durimit dhe shpresës
të këtyre ditëve që mezi e tejkalojnë natën
tash kur kërkoj azil
për faqet e historisë
të prehur në pritje
të gjetjes së vetvetes

Marrëzia

Marrëzia në maratonë
cakut s'i bëhet vonë
në lagjen time të bëjë konak
pastaj shtrihet gjerë e gjatë
marrëzia
kapërcen rrugët sheshet
pa trokitur në derë
futet në ballë te oxhakut
në odë ulet
Erazmon duke 1ënë pas dere
e pa ftuar
marrëzia mikpritjes
ia dhuron marrëzinë
pikërisht në lagjen time
në përmendore shndërrohet

Atdheu

Nëse shpërngulesh nga unë
s'ma ha macja përsheshin
dhe s'di kujt tjetër mund t'i fal aq kohë
dhe s'di të arrij me askund
atëherë kur
(ruana Zot)
nuk do te kemi kujt
t'i them mirëmëngjesi
Të lus prandaj të qëndrosh gatitu
para syve e zemrës
të më qëndrosh
ashtu siç je
me plagë
Pa ty si pa diellin
akulli zë në prit zemrën
se ç'ndodh më tutje me të
një Zot e di

Natë e vrarë me heshtje

Në natën e vrarë nga heshtja
pa mëshirë shkele në ëndrrën time
Të gjitha hyrje-daljet nën dry
të vetmuar më kishe pre
ku më gjete të më mbaje në ethe

Në pamundësi t'i bëhesha hapit tënd hije
çfarë të nxjerr tash nga mbetje ime
me gjunjë thyer e krahë në erë
veç klithmës dridhjes e djersës
ushqim lëkure
e rrugëve të prera me të larta mure

E zakonshmja domethënë ankthi
Ç'ju desh tash të më ketë pronë të veten
kur edhe pa të isha i mjaftuar
në ankthet e ankthеve që ma zunë
pragun e pa kapërcyer

Udhëtoj e mbetem në vetvete

Ditë e net në një rrëfim
më shpien në pikëllim
udhëtoj e mbetem në vetvete

A mund të arrihet ku arrin syri
zemër e plagosur historie

Majat e malit s'ma duan hapin
Prej se dekadat në arrati ma kthyen shpinën

Kohë e tkurrur mezi më gjen strehë
të gjitha kalatë në fazën e ndërtimit

Udhëtoj e mbetem në vetvete fillikat
asgjë e dikurshme nuk është më afër

Hipertensioni – vrasës i



Artan N. BEJTA

Tensioni arterial (TA) paraqet presionin që ushtron gjaku në muret e enëve të gjakut. Ky tension varet në radhë të parë nga volumi i gjakut dhe nga rezistencat e arterieve, arterioleve, venave dhe kapilarëve që kundërshtojnë fluksin e gjakut. Ndërkaq, hipertensioni arterial paraqet ngritjen e këtij presioni në enët e gjakut.

Në varësi se cila është etiologjia e hipertensionit, ai klasifikohet në dy grupe të mëdha: 1. Hipertensioni arterial esencial, i cili edhe pas shumë ekzaminimesh nuk mund ta kuptojmë se kush e shkakton dhe 2. Hipertensioni arterial sekondar të cilit i dihet shkaktari, që mund të jetë nga më të ndryshmit si p.sh. sëmundjet e veshkave, problemet me gjëndrën tiroide, diabeti (sëmundja e sheqerit), sëmundjet e gjëndrave mbiveshkore etj.

Shenjat e sëmundjes

Shumë nga ata të cilët vuajnë nga një hipertension i lehtë nuk e dinë atë sepse kalon pa shenja karakteristike, ndërsa kur tensioni i gjakut është i lartë atëherë përcillet me disa shenja karakteristike siç janë: dhimbje koke (gumëzhitje veshësh), marramendje, dhimbje dhe ndjenjë rëndese në gjoks, pagjumësi, urinim i shpeshtë, etje e madhe, dobësi muskulore dhe humbje ekuilibri, ndjesi të fikëtit.

Faktorët që rrezikojnë shfaqjen e hipertensionit

Mosha - luan një rol të rëndësishëm në shfaqjen e hipertensionit. Nga tensioni vuan gati 12-20% e popullatës dhe me rritjen e moshës rritet dhe përqindja e të prekurve. Por më të predispozuar për t'u prekur nga kjo sëmundje është mosha mbi 45-50 vjeç për burrat dhe 50-55 vjeç për gratë. Te gratë kjo lidhet me hyrjen në periudhën e menopauzës dhe çrregullimet hormonale karakteristike të kësaj periudhe, ndërsa te burrat me çrregullimet që pësojnë enët e gjakut, përdorimin e kripës, duhanit, alkoolit. Enët e gjakut humbasin elasticitetin, ngushtohen dhe nisin problemet me tensionin e gjakut.

Faktori trashëgues - Kohëve të fundit po vihet re se hipertensioni po shfaqet edhe tek moshat e reja dhe për këtë si faktor kryesor fajësohet trashëgimia, pastaj stili i jetesës, aktiviteti i ulët fizik dhe regjimi ushqimor me kalori të tepërta.

Stresi - po ashtu ndikon në shfaqjen e hipertensionit. Në gjendjen e stresit krijohet një dominante në sistemin nervor, e cila shton prodhimin e një hormoni me emrin aldosteron në veshka, i cili shkakton ngushtimin e enëve të gjakut dhe shfaqjen e hipertensionit.

Ndryshimi stinor - Periudha e dimrit, për shkak të të ftohtit, por edhe të luhatjeve të theksuara të temperaturave është një faktor shumë i rëndësishëm për të sëmurët me hipertension, pasi që të ftohtit ngushton enët e gjakut dhe në këtë mënyrë rrit tensionin. Prandaj këtyre pacientëve u rekomandohet të jenë korrekt në marrjen e barnave dhe të kenë kujdes me menynë ushqyese dhe stilin e jetës. Të sëmurët me hipertension duhet të eliminojnë daljet në ditët shumë të ftohta. Ata duhet të dalin vetëm gjatë orëve të ngrohta dhe të vishen mirë.


Menopauza - është po ashtu një nga shkaktarët e hipertensionit tek femrat. Kjo periudhë lidhet me çrregullimet në prodhimin e hormoneve, sidomos estrogjenit që ndihmon në mbrojtjen e enëve të gjakut nga arterosklerozat. Kur këto hormone janë në nivele të ulëta, nis formimi i arterosklerozave e për pasojë edhe paraqitja e hipertensionit.

Pirja e duhanit - shton rrezikun për shfaqjen e hipertensionit arterial. Nikotina që përmban duhani çon në ngushtim të enëve të gjakut dhe sjell rritjen e presionit të gjakut.

Ekuilibri midis kaliumit dhe natriumit - luan një rol kyç në hipertension. Nga kërkimet e shkencëtarit Dahl mësohet se fajtori kryesor në shkaktimin e hipertensionit është kripa. Mjekët e dinë tashmë ndjeshmërinë e veçantë që kanë disa pacientë me hipertension. Tek këta pacientë, nëse ndërpritet sasia e madhe e kripës që ata marrin në ushqime, edhe hipertensioni zhduket. Sasia e këshilluar e kripës është 800 miligram në ditë. Të sëmurët me hipertension duhet të respektojnë raportin e kaliumit me natriumin për të arritur rezultate pozitive. Raporti duhet të jetë i tillë që sasia e kaliumit të jetë tri herë më e lartë se sasia e natriumit. Raporti i kaliumit me kripën duhet të jetë 3 me 1. Ky raport quhet nga shkencëtarët faktori K.

Obeziteti -si një faktor rreziku është i lidhur ngushtë me hipertensionin, sepse obeziteti e vështirëson punën e zemrës për të furnizuar indet me gjak. Kontrolli i peshës është një faktor i rëndësishëm në parandalimin dhe trajtimin e presionit të lartë të gjakut. Humbja e peshës ndihmon në uljen e presionit të gjakut dhe e përmirëson efektivitetin e barnave që përdoren për kurimin e presionit të gjakut.

Përdorimi i kofeinës -mund të shkaktojë rrahje të shpeshta të zemrës dhe një rritje të përkohshme të tensionit arterial. Kërkime për përdorimin kronik të kofeinës nuk kanë gjetur ndonjë lidhje midis përdorimit të kafesë dhe vlerave të tensionit arterial. Efekti favorizues i duhanit në arteriosklerozë është dokumentuar tek vdekjet për kardiopati



heshtur

ishke-mike dhe vaskulopati cerebrale tek duhanpirësit e mëdhenj.

Si ta mbajmë tensionin në vlera normale

Humbisni kilogramët e tepërt - Mungesa e peshës është një hap tepër i rëndësishëm në normalizimin e hipertensionit. Të mirat e mungesës së mbipeshës janë të shumta. Përveç se ajo ndikon në uljen e tensionit të lartë arterial, vepron edhe në rënien e nivelit të kolesterolit, etj. Gjithashtu, ndihmon në rregullimin e nivelit të sheqerit në gjak në rast diabeti. Mos harroni se kombinimi i tensionit të lartë, i kolesterolit në rritje dhe i diabetit, përbën një faktor tepër rëndues për funksionimin normal të sistemit kardiologjik.

Shëtisni - Specialistët ju këshillojnë të sëmurëve me tension të lartë që të ecin të paktën 2-3 herë në javë për 45 minuta (është kjo koha që nevojitet mesatarisht për të përshkuar një distancë prej 4 kilometrash). Përkundrazi, ata ndalojnë ushtrimet që kanë të bëjnë me peshë pasi në këtë mënyrë rritet shumë presioni arterial dhe vonon që të vijë në nivele fiziologjike.

Ndërprisni duhanin – Ndalimi i duhanit, pavarësisht nga efektet mbi tensionin arterial, zvogëlon rrezikun kardiovaskular tek pacientët me hipertension. Numri i madh i të sëmurëve me hipertension tek duhanpirësit sugjeron një rol të rëndësishëm të duhanit tek kjo sëmundje.

Kontrolloni stresin - Megjithëse kjo këshillë është e vështirë që të zbatohet, pasi stresi është i pranishëm në jetën tonë të përditshme, e vërteta është se nëse dëshironi ta përballoni me sukses hipertensionin duhet të kontrolloni stresin. Me fjalë të tjera, stresi funksionon sikurse duhani, duke çuar në rritjen e tensionit të gjakut.

Me çka të ushqehet ai që vuan nga hipertensioni?

- Peshqit (si sardelet, salmoni etj.) përmbajnë tre përbërje yndyrore të cilat është vërtetuar se ndihmojnë në uljen e tensionit të gjakut. Natyrisht që efekti i këtyre përbërjeve tek ju varet nga shpeshtësia e konsumimit të peshkut. Mirë është që të preferoni të hani peshk dy herë në javë dhe të kufizoni konsumin e mishit të viçit; derrit, pulës etj.

- Frutat dhe zarzavatet kanë në përbërjen e tyre lëndë të cilat ndihmojnë në ruajtjen e kapilarëve në gjendje sa më të mirë. Në saje të lëndëve të vlefshme që përmbajnë frutat dhe zarzavatet, kapilarët qëndrojnë hapur duke lehtësuar qarkullimin sa më normal të gjakut. Specialistët propozojnë që vaktet tuaja të kenë në përbërjen e tyre fruta, zarzavate dhe pak yndyrë mishi.

Pasojat e mosmjekimit të tensionit të lartë të gjakut

Tensioni i pa mjekuar i lartë i gjakut për një kohë të gjatë shkakton dëmtime të mëdha e sidomos në këto zemër, tru, veshkë, sy, etj.

Zemra vuan për shkak se përherë duhet ta lëvizë gjakun me më shumë mund dhe energji. Prandaj trashet muskuli i zemrës dhe zhvillohet hipertrofia e barkushes së majtë të zemrës. Muskuli i trashur i zemrës është më pak i furnizuar me gjak, kështu që më shpesh paraqitet edhe sëmundja koronare (angina pectoris), ndërsa shpesh ndodh edhe infarkti.

Truri vuan në mënyrë më dramatike. Enët e dëmtuara të gjakut, nën tensionin e ngritur, pëlcasin dhe arrihet gjakderdhja në tru. Kjo shpesh ka si pasojë invaliditetin - pamundësinë e të folurit, lëvizjes së duarve apo këmbeve (paralizën).

Veshkat vuajnë sepse kanë qarkullim të madh të gjakut, meqë duhet ta pastrojnë atë nga materiet e dëmshme. Të sëmurit me hipertension dhe veshka të dëmtuara shpesh përfundojnë në dializë apo presin transplantimin e veshkës.

Sytë shkatërrohen sepse enët e gjakut në prapavijën e syrit janë shumë të ndjeshme. Gjakderdhja sjell deri te humbja e shikimit në pjesë të syrit. Humbet mprehtësia e shikimit, por edhe zvogëlohet fusha e të parit.

Aorta (arteria më e madhe në trup) në rastin kur i ka muret e ndryshuara në mënyrë aterosklerotike, nën ndikimin e tensionit të lartë të gjakut mund të pëlcasë. Kjo gjendje përfundon rregullisht me vdekje, përkundër tentimeve për operacion të shpejtë. ■

20 këshilla për të m

1 Pini shumë ujë

Trupit tuaj i nevojitet sasi e madhe uji, kështu që mbusheni atë me ujë. Uji nuk është vetëm mënyrë për nxjerrë toksina. Nëse keni më tepër ujë në trup, në përgjithësi, do të ndiheni më i shëndetshëm dhe më i përshtatshëm. Kjo vetvetiu do t'u dekurajonte prej ndonjë tendence të ushqimit të tepërt. Gjëja më e mirë për ujin është se nuk ka fare kalori!

2. Filloni ditën me një gotë ujë

Sapo të zgjoheni, pini me shpejtësi një gotë ujë të freskët. Është mënyrë e mrekullueshme që të filloni ditën e t'iu nevojitet më pak sasi uji për të pirë pas shujtës së mëngjesit. Një gotë ujë liron të gjitha lëngjet tuaja tretëse (digjestive) dhe bën një lloj lubrifikimi të brendësisë së trupit tuaj. Gjatë mëngjesit mund të pini një filxhan çaj, por pasi të keni pirë një gotë ujë.

3. Pini një gotë ujë para se të filloni ushqimin

Në mënyrë të natyrshme ujit i nevojitet hapësirë, kështu që do të ndiheni i ngopur pa pasur nevojë që të mbushni veten me ushqim.

4. Pini një tjetër gotë me ujë gjatë ushqimit

Përsëri kjo është një mënyrë për të ndierë veten të ngopur, kështu që aktualisht të ngriheni nga tavolina e ushqimit, por duke u ndierë i ngopur njëlloj. Në vend që ta pini ujin me një gllënjkë (një fyt), duhet ta pini ngadalë pas çdo përtypje (kafshate). Kjo do t'i ndihmojë ushqimit që të zërë vend më shpejt dhe kështu do të ndiheni i ngopur më shpejt.

5. Qëndroni larg pijeve të ëmbla, veçanërisht të gazuarave

Ej – gjithë ato kola dhe pije të gazuara janë të ëmbëlsuara me sheqer e sheqeri nënkupton kalori. Sa më shumë që të shkëputeni nga këto pije të gazuara, më mirë për ju. Plus, sodat (pijet e gazuara) përmbajnë acid fosforik, të cilat e kullojnë kalciumin prej eshtrave tuaja dhe kontribuojnë në humbjen e kockave.

6. Përfshini në dietën tuaj gjëra që kanë më tepër ujë, si domatet dhe shalqiri

Këto gjëra përmbajnë 90 deri 95 % ujë, kështu që nuk humbni asgjë duke u ushqyer me to. Do t'u ngopin pa ua shtuar kilogramët.

7. Hani fruta të freskëta në vend që të pini lëngje frutash


Lëngu zakonisht është i ëmbëlsuar, kurse frutat kanë sheqer natyral. Ju po flisni shumë për fijet indore që trupi ka nevojë dhe frutat janë një burim i mrekullueshëm i vitaminave. (Një gotë lëng zakonisht ka 120 kalori!)

8. Lëng i freskët frutash

Nëse dëshironi lëng frutash atëherë zgjidhni lëngun e freskët të frutave, në vend të atyre që kanë shije e ngjyra artificiale. Ose edhe më mirë, provoni që të bëni vetë lëng frutash, duke u kujdesur kështu që ai të mos ëmbëlsohet shumë dhe të ketë shumë kalori.

9. Zgjidh fruta të freskëta në vend të frutave të përpunuara

Frutat e përpunuara dhe të konservuara nuk kanë shumë fije, sikurse frutat e freskëta dhe zakonisht janë të ëmbël- suara.



10. Shtoni konsumin e fibrave

Siç theksuam më sipër, trupi ka nevojë shumë për fibra (fije indore). Kështu që mundohuni të përfshini në dietat tuaja sa më tepër fruta dhe perime që mundeni.

11. Konsumoni perime si "i çmendur"

Perimet janë basti më i mirë kur është në pyetje humbja e kilogramëve. Natyra ka një mori të hatashme zgjedhjesh të perimeve. Perimet gjethe jeshile janë më të mirat. Provoni të fusni një sallatë në dietën tuaj gjithmonë.

12. Ushqehuni në mënyrë inteligjente

Ndryshimi mes njeriut dhe kafshës është se ne udhëhiqemi nga inteligjenca, ndërsa kafshët nga instinkti. Thjesht, mos hani sepse iu duket që keni nevojë. Pyesni veten tuaj nëse trupi juaj vërtet ka nevojë për të.

13. Kujdes se çfarë hani

Mbani një sy vigjilent në çdo gjë që fusni brenda. Ndonjëherë zbukurimet e ushqimit mund të jenë më të pasura se sa vetë ushqimi. Ushqimet shoqëruese (përcjellëse) janë shumë të pasura, gjithashtu. Mbani mend se të ngrënit është gjëja më e lehtë në botë pa e kuptuar se ajo ka qenë dashur të mos hahet. Kujtesën zgjedhëse duhet ta keni me vete kur hani...

14. Kontrolloni atë dhëmb të ëmbël

Përkujtoni që gjërat që janë të ëmbla përgjithësisht nënkuptojnë më shumë kalori. Është e natyrshme që kemi dëshirë për gjëra të ëmbla, veçanërisht për çokollata dhe ëmbëlsira të tjera. Merrini këto gjëra me takt. Çdoherë kur konsumoni diçka të ëmbël, kuptojeni se ajo gjë do të shtojë diçka tek ju.

15. Ndreqeni orarin e ushqimit dhe përmbajuni

Provoni të hani ushqimin në kohë të caktuara të ditës. Këto kohë ushqimi mund t'i ndani nga një orë e gjysmë brenda ditës, e kjo nuk do të bëjë gjë tjetër pos të ndikojë në mënyrën e ushqimit. Rezultati do të jetë ose humbja e oreksit e të ushqyerit ose humbja e ndjesisë së urisë, rezultate këto që do t'iu bënin ta mbushnit veten tuaj me ushqim më tepër se sa është e nevojshme, kështu që herën tjetër të hani më pak e kështu më radhë kjo gjë të vazhdojë, derisa të zvogëloni ushqimin sa të keni mundësi.

16. Hani vetëm kur jeni i uritur

Shumë njerëz kanë tendencën e të ngrënit kurdo që shohin ushqim. Ne për-

mbajtur dietë

dorim p.sh. ndenjjet si një justifikim për ta ngopur veten. Duhet të kuptojmë që efekti i një jave të tërë diete mund të humbasë vetëm nga ushqimi i një dite ndenjje. Kurdo që iu ofrohet ushqim mos e mbaroni atë, por hajeni çikë-çikë duke pasur në mend kështu mënyrën e të ngrënit, e në të njëjtën kohë mund të ruani dietën tuaj.

17. Ndërpritni ngrënien e mezeve të lehta

Mos hani meze të lehta (ushqim me vlerë të vogël) në mes shujtave (p.sh. drekë, darkë). Kjo vlen sidomos për ata të cilët udhëtojnë shumë. Ata mendojnë se koha e vetme që mund të hanë një kafshatë ushqimi janë mezet e lehta dhe ushqimi me vlerë të pakët. Problemi kryesor, me shumicën e mezeve të lehta dhe ushqimit me vlerë të pakët, është se zakonisht këto lloj ushqime nuk janë të mbushura (kanë zbrazëti përbrenda) dhe përmbajnë yndyrë dhe kalori. Vetëm mendoni për patatet e skuqura franceze, joshëse, por tmerrësisht të yndyrshme.

18. Ushqehuni me perime mes shujtave nëse mundeni

Mund të keni dhembje urie mes shujtave, por është një gjë që ju mund ta kontrolloni shumë mirë. Ose edhe më mirë, provoni të përtypni karota. Ato janë një mënyrë e mrekullueshme për të plotësuar dëshirën për ushqim dhe janë të mira për sytë dhe dhëmbët tuaj.


19. Përdoreni me takt çajin dhe kafenë

Çaji dhe kafeja janë të padëmshme vetvetiu. Ndikojnë në trashje atëherë kur i vendosni krem dhe sheqer. A e dini se të pirit e një filxhani çaj apo kafe që ka krem dhe së paku dy kube sheqer është më keq se sa të ngrënit e një pjese të tortës me çokollatë?

20. Provoni me çaj/kafe të zezë

Çaji apo kafeja e zezë (dhe çaji i gjelbër dhe i bardhë) aktualisht mund të jenë të mira për ju. Personalisht do të dëshiroja t'iu rekomandoja më mirë çajin se sa kafenë. Kafeina në kafe nuk është e mirë sepse është një alkaloid dhe mund të ndikojë në funksionet e tjera të trupit tuaj, siç është metabolizmi. ■

Përgatiti:
Osman D. GASHI





KF "Paqja Studentore", pjesë e Futsall ligës rajonale të Prishtinës

Ylber QORRI

Organizata "Paqja Studentore" ka formuar edhe klubin e saj në futboll të vogël, i cili do të zhvillojë gara në kuadër të Futsall ligës rajonale të Prishtinës. Liga rajonale në Futsall është themeluar më 16 mars 2009 dhe përbëhet prej gjashtë klubeve.

Klubi "Paqja Studentore" për fillim i ka 10 lojtarë, të cilët janë zgjedhur kryesisht nga radhët e studentëve, ndërsa trajner i këtij klubi është futbollisti Bedri Mangjolli.

"Formimin e klubit futbollistik "Paqja Studentore" e shoh si një rast të mirë për të kontribuar në sportin vendor dhe si një formë të mirë për t'iu përkujtuar studentëve të Universitetit të Prishtinës rëndësinë e marrjes me aktivitete sportive" – ka thënë trajneri Mangjolli me rastin e themelimit të klubit, duke shprehur shpresën se me efikasitetin e lojtarëve ky klub do të jetë ndër klubet më të mira në kuadër të kësaj lige.

Egon Pukaj, Mergim Lushtaku, Hasan Ferizi, Bujar Salihu (portier), Ramiz Mangjolli, Agon Sylaj, Behar Salihu, Fitim Shabani, Irfan Shabani dhe Sami Dobra, janë lojtarët të cilët do ta bartin fanellën e KF "Paqja Studentore" në këtë edicion të garave.

Ndeshjen e parë klubi "Paqja Studentore" e ka zhvilluar me klubin "Prishtina 038", ndërsa në përballje me klubin e RTV-21, "Paqja Studentore" fitoi me rezultat të thellë 8 me 2. "Fitorja që shënuam ndaj RTV21 është një shtytje dhe një motivim për ne që të vazhdojmë të bëjmë një lojë cilësore dhe të jemi shembull në kuadër të Futsall ligës. Besoj dhe shpresoj që me angazhimin dhe me punën e vazhdueshme të lojtarëve tanë të vazhdojmë edhe me shumë fitore të tjera" – u shpreh pas ndeshjes trajneri Mangjolli.

Klubi "Paqja Studentore" udhëhiqet nga bordi mbikëqyrës i organizatës "Paqja Studentore". Menaxher i klubit është Gëzim Qerimi, përfaqësues zyrtar i klubit Arbër Zeka, ndihmëstrajner Liridon Veliu, ndërsa Artan Bahtiri është mjek i klubit. ■

Përfaqësuesja ideale e Kosovës në futboll

Viti 2008 ishte ndër më të suksesshmit në karrierë për futbollistët nga Kosova. Nga Arian Beqaj në portë, e deri te Besart Berisha në sulm, ky formacion do të ishte ideal edhe për përfaqësuesen tonë, të cilën ende nuk e kemi dhe shpresojmë që në një të ardhme shumë të afërt të pranohemi në instancat më të larta ndërkombëtare të futbollit dhe futbollistët tanë të na përfaqësojnë denjësisht



Alban BILALLI

Federata e Futbollit të Kosovës po mundohet "me mish e me shpirt" që të pranohet me të drejta të plota në kompeticionet ndërkombëtare si në FIFA dhe në UEFA. Mirëpo situata nuk është aq e thjeshtë, siç u mendua kur u shpall pavarësia e Kosovës më 17 shkurt të vitit të kaluar. Pengesë për pranimin e Kosovës në këto organizma paraqet politika, sepse Kosova ende nuk është anëtare e OKB-s. Mirëpo futbollistët nga Kosova nuk qëndrojnë duarkryq. Ata po luajnë në skuadrat e tyre dhe po e përfaqësojnë denjësisht futbollin e Kosovës nëpër botë dhe me shpresë që një ditë edhe ata do të kenë rastin që të luajnë për Kosovën, atdheun e tyre.

Viti 2008 ishte ndër më të suksesshmit në karrierë për futbollistët nga Kosova. Nga Beqaj në portë, e deri te Berisha në sulm, ky formacion do të ishte ideal edhe për përfaqësuesen tonë, të cilën ende nuk e kemi dhe shpresojmë që në një të ardhme shumë të shpejtë të pranohemi në instancat më të larta ndërkombëtare të futbollit dhe atëherë futbollistët tanë të na përfaqësojnë denjësisht. Duke u bazuar në rezultatet individuale të futbollistëve kosovarë nëpër ekipet e tyre, ky do të ishte formacioni i mundshëm i kombëtares së Kosovës në futboll.

Gardiani i portës



Arian Beqaj është lindur në Prizren, më 25 gusht 1975. Viti 2008 për Arian Beqaj ka shënuar kulmin e karrierës së tij. Portieri nga Prizreni me ekipin e Anorthosisit (Qipro) ka shkëlqyer në kampionatin qipriot, duke fituar të gjitha trofetë. Përveç kësaj, ata kanë hyrë në historinë e shtetit, duke u bërë ekipi i parë që siguroi pjesëmarrjen në fazën e grupeve të Ligës së Kampionëve. Pa dyshim se Beqaj ishte hero, pasi me pritjet e tij ia siguroi Anorthosisit suksesin më të madh në arenën ndërkombëtare. Mirëpo, prizrenasi ka shkëlqyer edhe në portën e kombëtares shqiptare. Nga katër ndeshje, sa ka zhvilluar për kuqezinjtë në kuadër të kualifikimeve për Botërorin 2010, Beqaj ka pësuar vetëm dy gola. Paraqitjet e shkëlqyeshme të tij nuk kanë kaluar pa u vërejtur nga skautët, pasi klubi më i suksesshëm grek, Olympiacos, tashmë ka shprehur interesim ta transferojë portierin nga Kosova në Athinë, për sezonin e ardhshëm.

Mbrojtësit



Armend Dallku është lindur në Vushtrri, më 16 qershor 1983. Ai luan në mbrojtje për FC Vorsla Poltova, në premier ligën e Ukrainës dhe kombëtaren shqiptare të futbollit. Para se të transferohej në Poltava, Armend Dallku ishte lojtar i FK Kosova (Vushtrri) dhe KF Prishtina, e më pas tek KS Elbasani në Shqipëri. Armend Dallku është mbrojtës i pazëvendësueshëm tek ekipi ukrainas Vorskla. Po ashtu, ai është pjesë e pandashme e mbrojtjes së kombëtares shqiptare në futboll. Luan në krahun e djathtë të mbrojtjes, por shpesh herë inkuadrohet edhe si qendërmbrojtës.



Debatik Curri është i lindur në Prishtinë, më 28 dhjetor 1983. Ai luan si mbrojtës për FC Vorskla Poltova, në premier ligën e Ukrainës dhe kombëtaren shqiptare të futbollit. Para se të transferohej në Poltava, Debatik Curri ishte pjesëtar i KF Prishtina. Dy mbrojtësit kosovarë, Armend Dallku e Debatik Curri pa dyshim se janë të pazëvendësueshëm tek ekipi ukrainas, Vorskla. Dyshja e kombëtares shqiptare këtë sezon shkëlqeu në kampionatin ukrainas, duke e drejtuar ekipin e Vorsklas drejt kreut të tabelës. Si asnjëherë më parë, ekipi nga qyteti i Poltavës pjesën e parë të këtij sezoni e ka përfunduar në vendin e pestë me 37 pikë të tubuara. Mirëpo, Dallku dhe Curri tashmë janë bërë pjesë e rëndësishme edhe e kombëtares së Shqipërisë. Ish-futbollistët e KF Prishtinës, në kampanjën për eliminatoret e "Botërorit 2010" kanë pasur paraqitje të shkëlqyeshme. Pas paraqitjeve të shkëlqyeshme, për dyshen shqiptare nga Kosova kanë shfaqur interesim shumë skuadra evropiane.



Beg Ferati është lindur më 10 nëntor 1986. I gjatë 186 centimetra, Ferati dalëngadalë po bën emër në futbollin evropian. Ky sezon për mbrojtësin nga Kosova, me nënshtetësi zvicerane, ka qenë i suksesshëm. Ai me Baselin u shpall kampion i Zvicrës, derisa ka arritur të debutojë edhe në Ligën e Kampionëve. 22-vjeçari është edhe anëtar i rregullt i përfaqësueses U-21 të Zvicrës.



Mërgim Mavraj është lindur më 9 qershor 1986. Luan në krahun e majtë të mbrojtjes. Më 10 maj ka debutuar në Bundesligën e Gjermanisë me skuadrën e Buhumit. Kurse për Gjermaninë për grupmoshat U-21 ka debutuar në shkurt 2007 kundër Italisë. Në këtë sezon, ai zhvilloi shumë lojëra të mira. Për këtë arsye, trajneri Buhumit Marcel Koller e vlerëson shumë lart mbrojtësin nga Kosova dhe e konsideron në të ardhmen e afërt shtyllë të mbrojtjes së skuadrës gjermane, Bohum.



Mesfushorët


Lorik Cana është i lindur në Prishtinë, më 27 korrik 1983. Është mesfushor i pazëvendë-




sueshëm në ekipin francez Olimpik Marsej dhe në kombëtaren shqiptare. Kapiteni i Marseilles, Lorik Cana, pa dyshim se është njëri ndër futbollistët më të mirë shqiptarë. Prishtinasi tashmë është shndërruar në një lider tek ekipi nga Velodrome, e gjithashtu edhe në kombëtaren shqiptare. Ky sipas të gjitha gjasave, do të jetë edhe sezoni i fundit i Canës në Marseille, pasi në adresë të tij kanë ardhur oferta nga klube të mëdha evropiane. Të interesuar për shërbimet e Lorik Canës janë Real Madridi, Arsenali, Evertoni dhe Interi.



Valon Behrami është lindur në Mitrovicë, më 19 prill 1985. Behrami është mesfushor i djathtë, por mund të luajë pa problem edhe në pozita të tjera. Pas Lazios, formë të mirë po vazhdon të tregojë edhe te West Ham Unitedi, ekip tek i cili u transferua gjatë afatit kalimtar të verës. Brenda një periudhe të shkurtër ka arritur të shndërrohet në një futbollist kyç të ekipit nga Londra. Ende pa kaluar gjashtë muaj nga transferimi i tij në West Ham, disa ekipe italiane tashmë kanë shprehur interesim që mitrovicasin ta rikthejnë në Serie A. Sipas mediave italiane, gjigantët italianë, Juventus, Milan dhe Roma janë të interesuara që ish-anëtarin e Lazios ta transferojnë në radhët e tyre.



Anel Raskaj është lindur në Prizren, më 19 gusht 1989. Prizrenasi Anel Raskaj ka qenë i pazëvendësueshëm në mesfushën e ekipit suedez, Halmstad. Nga 30 ndeshje sa janë zhvilluar në kampionatin suedez, 19-vjeçari ka bërë 27 paraqitje për ekipin e tij, prej tyre 24 si titullar. Kosovari me pasaportë suedeze vlerësohet si një talent me të ardhme të ndritur, derisa nga ekspertët e futbollit në shtetin skandinav, ai krahasohet me ish-yllin e Francës, Zinedine Zidane.



Emir Bajrami është lindur më 7 mars 1988. Vetëm për një pikë nuk ka arritur që me Elfsborgun të shpallet Kampion i Suedisë. Emir Bajrami ka luajtur rol të rëndësishëm në mesfushën e Elfsborgut. Ai ka bërë 28 paraqitje në kampionatin suedez, prej tyre 26 si titullar. 21-vjeçari ka realizuar 6 gola dhe po aq herë ka asistuar në golat e bashkëlojtarëve të tij. Përveç paraqitjeve që ka pasur në kupën e UEFA- s, Bajrami ka qenë edhe anëtar i rregullt i përfaqësueses U-21 të Suedisë duke realizuar 4 gola.

Sulmuesit



Shefki Kuqi është lindur më 10 nëntor 1976 në Vushtrri. Ai luan si sulmues për Crystal Palace të kategorisë së dytë të futbollit në Angli, që njihet me emrin Coca-Cola Championship. Kuqi në fillim pati probleme me trajnerin Neil Wornock dhe kryesinë e klubit për shkak të pagës së lartë dhe flitej se ai do të largohej gjatë afatit të janarit, por me lojërat e treguara ka ndryshuar mendjen e trajnerit, kryesisë së klubit, madje edhe të vetë tifozëve të cilët në fillim nuk e donin. Tani, ai jo vetëm që është në planet e skuadrës për sezonin e ardhshëm, por ka zgjuar interesimin e shumë skuadrave të tjera.



Besart Berisha është i lindur më 29 korrik 1985, në Prishtinë. Në bazë të performancës që ka treguar në këtë sezon e meriton të jetë në tandemë me Kuçin në repartin e sulmit të kombëtares së Kosovës në futboll. Berisha është futbollist që mund të luajë si sulmues klasik por edhe i tërhequr, madje ai ka aftësi të luajë edhe si mesfushor ofensiv. Ish-lojtari i Hamburgut është i pazëvendësueshëm tek ekipi AC Horsens (Danimarkë). Në këtë klub u transferua në afatin e janarit 2009. Ka shënuar tre gola, si dhe ka asistuar në disa gola që kanë shënuar bashkëlojtarët e tij. Po ashtu, Berisha është lojtar edhe i kombëtares së Shqipërisë.

Rezervat

Samir Ujkani (Palermo), Ahmed Januzi (Vorskla), Agon Mehmeti (Malmo), Përparim Hetemaj (AEK), Kristian Nushi (Aarau), Shkëlzen Gashi (Belinzona), Adrian Nikçi (Zurich), Shkodran Metaj (Groningen), Faton Toski (E.Frankfurt), Albert Bunjaku (RW Erfurt), Fatos Beqiraj (Buduçnost). ■

Autor: ENDRITI	KËNGËTARJA JONË NË FOTO 1	FOLTORET	GURRË, BURIM (sh.shq.)	MARKË E TELEFONAVE MOBIL	RAFINERIA E KROACISË	TAKSA QË I PAGUHET SHTETIT		ARKË E VOGËL KU RUHEN SENDE TË NDRYSHME ME VLERË (shq.)	VENDI I PAVARUR	1				
LËNDË E FORTË PLASTIKE							KORÇA, SHKODRA / TRAJNERI ITALIAN ROBERTO							
PIJE FRESKUESE E ATHËT (sh.shq.)														
I PËRZJEVE														
NAFAKA					MËRI, ZILI / QËLLUAR RASTËSISHT NË NJË NDODHI									
ANITA TAKE			MJET LUFTE (shq.) / KËNGËTARJA SHQIPTARE ANILA					INDIA / FLORI						
BASHKËT-INGËLLORE		SHKRONJA E 18-të / PIKA MË E LARTË NË KUPËN E QIELLIT		KËNGËTARJA BARAKU					POROSI QË LË NJERIU ME FJALËT E FUNDIT PARA VDEKJES	NDESHJET	“R” në mes të dy “O”	VARGJE TË PËRPUTHURA	I LARTË (krah.)	PËREMËR VETOR
NJË KONTINENT				SUEDIA / EMINE (perkdh.)		ARTI I TË FOLURIT / OPEN TRANSLATION ENGINE								
	TRANSMETON / BANOR I ARABISË							HUMANISTI BIÇIKEMI (shq.)						
BANORI I VIETNAMIT TË VJETËR								ENDE / ALESANDRO NESTA						QESËNDISJA
NISE SËRISH							MIRË DE (bised.) / KËNGËTARJA JONË NË FOTO 2				SHKRIMTARI ... ALIU / AKTORJA ISMAILI			
BABAI				URANIUM / ZANORE		E MALLKOVA (krah.) / ANKIMET						AUTOTARGA E TIRANËS / SHALQI		
BELGJIKA, ISLANDA			GOJOR					NGJYRA E LËKURËS SË FYTYRËS / VEPËR SHKENCORE A MËSIMORE (sh.pashq.)					ZANORE / OMANI, NAIROBI	
2					AZOT, SULFUR, LITËR				MJET PËR TË DREJTUAR KAMIONIN / NATRIUM, INTENSITET					
					EMËR MASHKULLI MYSLIMAN					KËNGËTARE E NJOHUR SHQIPTARE / GJENERALI YNË VESELI				
					QYTET NË SHQIPËRI								BASHKËT-INGËLLORE / LEGJENDË	
					SHTET NË AZI (shq.)						PËREMËR PRONOR / AGIM SOPI			
									LAKESË / SHKRONJA E 16-të					
					FORTESË / TANTAL			DRU PYLLI I LARTË				TITAN		

Hapësirë për reklamim në revistë!

1/1	1/2	1/4
100€	50€	25€

Në vlerat e çmimeve nuk është përfshirë TVSH-ja



Pronar: Murat Fejziu, Rr. Gazmend Zajmi, nr. 81
Te Xhambazt, 10000 Prishtinë
Tel.: +377 (0)44 195 583

Studio për prodhimin e kuzhinave

KezzA



kkeza@hotmail.com
mob. +377 (0)44 141 909
tel & fax. +381 (0)38 243 863

Prodhimet tona mund të blihen me kredi përmes **Raiffeisen Bank**

Made in Kosova